

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7535 E hënë 21 Maj 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

Po afrojmë vera. Do të fillojmë të dëgjojmë këngë të reja: hite. Hitet do të transmetohen shpesh. Ne do t'i dëgjojmë dhe, ndonjëherë pa vetëdije, do t'u mësojmë fjalët. Disa ...

Vijon në faqen 20

Nga JULIAN ZYLA

Punë politikanësh



Opinion i Ditës

Nga SHABAN MURATI

Pse Shkupi dhe Athina këmbëngulin për emër sllav

Rezultati i bisedimeve të gjata natën e 16 majit dhe ditën e 17 majit midis kryeministrit maqedonas Zoran Zaev dhe kryeministrit grek Aleksis Cipras, që u takuan ...

Vijon në faqen 21



Arsyet, pritet të ndryshojë Kodi i Familjes

## Kartat e identitetit, veç 'mashkull ose femër' do të shkruhet edhe varianti nr.3: Tjetër

Zbardhet nisma ligjore, Shehu: E bëjnë për të larguar vëmendjen nga skandalet e qeverisë

Një nismë e fundit ligjore pritet të shkaktojë një debat të ri në opinionin publik që ka të bëjë me deklarinë e gjinisë në kartat e identitetit. Deputeti i Partisë Demokratike, Tritan Shehu reagoi dje në lidhje me projekt ligjin e ri që është propozuar në Kuvend, ku në një pjesë të tij thuhet se në dokumentet e identitetit nuk do ...

Në faqen 4

## DISPOZITAT E REJA NE LIGJIN GREK, KU MUND TE PENALIZOHEN SHQIPTARET

# BASHKIM FAMILJAR NE GREQI, EMIGRANTET QE PERFITOJNE

Ndërmjetësi Fatos Malaj: Si do të jepen lejet e jashtëzakonshme të qëndrimit dhe ndryshimet pozitive për ata që punojnë e jetojnë në vendin fqinj



INTERVISTA

(Në foto) Fatos Malaj

Në faqen 7

### FORMULARI TIP

Pronarët në Fier, ATP merr në shqyrtim 1030 dosje, lista e parë me përfituesit në qark

Në faqen 10-11

### PALOKA: RAMA E MBRON

"Xhafaj", PS: Në inskenimin e 'fakteve' të përfshirë dhe gjyqtarë të korruptuar

Në faqet 2-3

### VIJONJE KERKIMET

Zhdukja e Seterit te "Shpella e Pëllumbasit", i mbijetuari: E mori rrjedha, s'e shpëtova dot

Në faqen 5

### OPINION

Poeti që pranon të kryqëzohet...

Nga PANO HALLKO

Në faqen 12

Mjeku popullor: Ja mënyrat e përgatitjes në shtëpi për rigjeneruesin natyral

## Ylli Merja: Fuqitë e mrekullueshme të uthullës së hudhrës

Mungesa e kaliumit, gjashtë simptoma që s'duhet t'i injoroni

Nga VOLTIZA DURO

Uthulla e mollës njihet për efektet e saj të mrekullueshme në përmirësimin e qarkullimit të gjakut, lehtësimin në tretjen e ushqimit dhe jashtëqitjes, si dhe shkrirjen e yndyrave. Por nëse këtij produkti



natyral i shtojmë të tjerë përbërës kimike që gjenden në perime ose në fruta të tjerë, vlerat e produktit do të shumëfishohen. Bëhet fjalë që uthullës së mollës t'i shtojmë kripërat e squfurit që gjenden te hudhra, antibiotikët e tjerë që ...

Suplement

JETA E BULLGARES NE SHQIPERI



INTERVISTA

Janka Trifonova: Përthimi e jeta ime me Skënder Selimin, e lumtur që s'e braktisa

Në faqen 9

## SKANDALI "XHAFAJ" PROTESTA

Protesta, Balla nxjerr videon për Kryemadhin: Demokratë të ndershëm, mos u gënjeni

# PS: Gjiqtarë të korrumpuar, të përfshirë në inskenim ndaj Xhafajt

"Vetingu do t'i pastrojë nga sistemi i drejtësisë"

Kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla gjatë turit të llogaridhënies së qeverisë në Librazhd iu përgjigj akuzave të opozitës ndaj ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj. Sipas Ballës në këtë inskenim janë të përfshirë, jo vetëm politikanë të korrumpuar si Saliu, Monika, Luli, por janë të përfshirë edhe gjyqtarë të korrumpuar, të cilët vetingu do t'i pastrojë nga sistemi i drejtësisë. "Ne do të kishim marrë masa të ashpër ndaj kujtdo nëse një e njëmijta e kësaj historie me babalen do të ishte e vërtetë. Por gjithë ky inskenim shantazhi ndaj Fatmir Xhafajt si ministër vjen për shkak të luftës pa kompromis që ky i fundit i ka shpallur krimin të organizuar. Dhe në këtë inskenim janë të përfshirë, jo vetëm politikanë të korrumpuar si Saliu, Monika, Luli etj., por janë të përfshirë edhe gjyqtarë të korrumpuar, të cilët duke qenë se vetingu do t'i pastrojë nga sistemi i drejtësisë, u munduan të shantazhojnë ministrin, të shantazhojnë qeverinë, për të mos lejuar vijimin e aksionit "Forca e ligjit" dhe për të mos vijuar punën që kemi nisur", deklaroi Balla. Më herët kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla publikoi dje një video të kryetares së LSI-së Monika Kryemadhi. Në video shfaqet Monika Kryemadhi në një nga takimet elektorale të LSI-së, para se të bëhej aleate me kreun e PD-së Luzlim Basha, duke e quajtur kreun e PD-së "Luli i vogël", dhe duke e akuzuar se nënshtrihet nga kryeministri Edi Rama. Gjithashtu, Balla u bën thirrje demokratëve të ndershëm që të mos gënjen. "Demokratë të ndershëm, mos u gënjeni, shkruan Balla në postimin e tij në "Instagram". Të shtunën e ardhshme opozita do të protestojë para Kryeministrit kundër qeverisë. Dy ditë më parë kreu i grupit parlamentar, Taulant Balla, u është përgjigjur nga Librazhdi akuzave të opozitës për ministrin e Brendshëm,



Kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla

### DEKLARATA

"Gjithë ky inskenim shantazhi ndaj Fatmir Xhafajt si ministër vjen për shkak të luftës pa kompromis që ky i fundit i ka shpallur krimin të organizuar. Në këtë inskenim janë të përfshirë, jo vetëm politikanë të korrumpuar", -tha Balla.

### "Më mirë burgu me lekë, se sa pa lekë"

## Denoncimi, Berisha: "Xhafaj 2" iku të shpëtonte pasurinë

Ish-kryeministri Sali Berisha ngrre dyshime se Agron Xhafaj mund të ketë ikur në Itali për të shpëtuar pasurinë e tij. Pas mesazhit të një qytetari dixhital, i cili thotë se ka ikur në Itali për të mos i sekuestruar, shtëpitë, lokalet dhe ndërtime, Berisha shkruan se është më mirë të bësh burgun dhe të kesh lekë se sa burg dhe pa lekë. "Më mirë burgu me lekë se sa burgu pa lekë! Qytetari dixhital për vëllezërit mafiozë Xhafaj! Lexoni mesazhin e tij. "Doktor si je. Më shkon nder mend...mos ka ikur ky "Xhafaj 2" për mos t'i sekuestron shtëpitë, loka-



let, ndërtime që ky ka bërë me lekët e drogës...dhe me këtë rast po bëj ca vjet burg sa mos të më çojnë në 0 nga lekët këto të opozitës...? Mendim është ky. Se ky burgun do e bëjë që do e bëjë se s'ka ku shkon... kështu që më mirë me burg

dhe me lekë sesa me burg dhe pa lekë nga sekuestri...", thuhet në mesazhin dërguar Berishës. Po dje ish-kryeministri Berisha publikoi një reportazh të medias gjermane ZDF për plehrat në Shqipëri. Në reagimin e tij Berisha shkruan se ky është narkoregimi në Shqipëri që kundërmon Evropën. "Drogë, plehra/plehra, drogë. Rrjeti me i madh televiziv gjerman ZDF përshkruan mbytjen e vendit nga plehrat, si apokalis. Ndërkohë qeveritaret siçilistë vazhdojnë vjedhjen e taksave që paguajnë qytetarët për pastrimin dhe plehrat!", shkruan Berisha.

me babalen do të ishte e vërtetë. Por gjithë ky inskenim shantazhi ndaj Fatmir Xhafajt si ministër vjen për shkak të luftës pa kompromis që ky i fundit i ka shpallur krimin të organizuar. Dhe në këtë inskenim janë të përfshirë jo vetëm politikanë të korrumpuar si Saliu, Monika, Luli etj., por

janë të përfshirë edhe gjyqtarë të korrumpuar, të cilët duke qenë se vetingu do t'i pastrojë nga sistemi i drejtësisë, u munduan të shantazhojnë ministrin, të shantazhojnë qeverinë, për të mos lejuar vijimin e aksionit "Forca e ligjit" për të mos vijuar punën që kemi nisur", -tha z.Balla.



Një nga protestat e opozitës

## Manjani: Papërgjegjshmëria e Ramës e ka emrin Bale

Ish-ministri i Drejtësisë, Ylli Manjani, ironizon kryeministrin Rama lidhur me shfaqësimet që përdor së fundmi pas publikimit të video-përgjimit të Agron Xhafajt. Manjani shkruan se papërgjegjshmëria e Ramës e ka emrin Bale. "Vite më parë çuni i BALEs i hapi digën e liqenit artificial dhe përmbiti Tiranën. Sot BABALJA i hapi digën e liqenit të rrenave që ka krijuar me trafikun e drogës dhe përmbiti Shqipërinë. Nga bashkia në qeveri është gjithnjë një BALE për t'u fajësuar. Sa të jetë BALJA nëpër këmbë, ai s'ka faj", -tha z.Manjani.



## Ngjela: Opozita kërkon armatosjen e popullit kundër ministrit Xhafaj

Avokati Spartak Ngjela, komentoi dje protestën e thirrur nga opozita për datën 26 maj. Në një postim në Facebook, Ngjela shkruan se Saliu dhe Basha kanë kërkuar armatosjen e popullit kundër Ministrit të Brendshëm. Avokati tregon arsytet sipas tij pse do dështojë lëvizja antiamerikane dhe anti-Perëndim e 26 majit. "Saliu dhe Basha kërkuar armatosjen e popullsisë në 26 maj, kundër Ministrisë së Brendshme. Domethënë mendojnë për një grusht shteti. Po si do ta bëjnë, me persona që kanë armëmbajtje pa leje? Amerikanët qeshin, se e dinë mirë se çfarë është një grusht shteti. Kurse policinë ligjore e drejton sot në Shqipëri Fatmir Xhafaj dhe amerikanët. Po a ka mundësi të mundet ushtarakisht me forca civile një shtet i NATO-s, i cili drejtohet sot nga amerikanët?", -tha avokati Ngjela.





Valentina Madani

Demokratët ashpërsu an dje akuzat në adresë të kryeministrit Edi Rama lidhur me skandalin "Xhafaj". Për PD-në, kryeministri Rama po zbaton një skenar kriminal që synon mbylljen e hetimeve pa vënë para drejtësisë vëllain e ministrit të Brendshëm, që opozita e akuzon për trafik droge. Sipas nënkryetarit demokrat Edi Pakoka, pjesë e skenarit është mohimi i zërit të Agron Xhafajt në audio-përgjim. Ai shprehet se pjesa e dytë e këtij skenari është imponimi ndaj prokurorisë të pranohë si ekspertizë të zërit të Agron Xhafajt rezultatin e paracaktuar nga vetë Edi Rama. Paloka denoncoi mungesën e transparencës para shqiptarëve të dyshes Rama-Xhafaj, lidhur me ekspertizën e bërë par audio-përgjimin. PD ka bindjen e plotë se Fatmir Xhafaj e di që zëri në audio-përgjim është i vëllait të tij. "Që kur shqiptarët u njohën me skandalin Xhafaj, Edi Rama po zbaton një skenar kriminal që synon mbylljen e hetimeve pa vënë para drejtësisë vëllain e ministrit të Brendshëm për trafik droge. Pjesë kryesore e këtij skenari është mohimi i zërit të Agron Xhafajt, që i siguroi dëshmitarit X gjetjen dhe transportin e hashashit me garancinë se policia nën varësinë e vëllait të tij ministër i Brendshëm, do t'i hapte rrugën. Pjesa e dytë e këtij skenari është imponimi ndaj prokurorisë të pranohë si ekspertizë të zërit të Agron Xhafajt rezultatin e paracaktuar nga vetë Edi Rama. Prandaj Fatmir Xhafaj vazhdon të qëndrojë në detyrë: për të vazhduar manipulimin dhe shkatërrimin e provave, nëpërmjet kukullave të tij në prokurori Arta Marku dhe Donika Prela", theksoi z.Paloka. Ai akuzoi më tej se, "Edhe Edi Rama e di që Agron Xhafaj është koka e trafikëve në Vlorë, prandaj gënjeh për ekspertizën e zërit dhe nuk iu përgjigj gazetarëve për emrin e agjencisë. Për të mbajtur në këmbë pushtetin e tij të inkriminuar, Edi Rama është bërë pjesë e skenarit për të mbuluar veprat kriminale të Fatmir dhe Agron Xhafajt". Opozita ka thirrur të shtunën një protestë kombëtare kundër qeverisë dhe largimit të ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj, të cilin e akuzon për veprën penale të mbulimit të veprimtarisë kriminale të vëllait të tij Agron Xhafaj, të veprimtarisë krim-

Paloka thirrje shqiptarëve: Në protestë, t'i themi ndal shtetit të krimit

# Skandali "Xhafaj", PD: Rama skenar kriminal për mbylljen e hetimeve

"Audio-përgjimi, mashtrove për ekspertizën"



**AKUZA**  
Për PD-në, kryeministri Rama po zbaton një skenar kriminal që synon mbylljen e hetimeve pa vënë para drejtësisë vëllain e ministrit të Brendshëm, që opozita e akuzon për trafik droge. Sipas nënkryetarit demokrat Edi Pakoka, pjesë e skenarit është mohimi i zërit të Agron Xhafajt në audio-përgjim.

## Vasili-Ramës: Mister 'Portali' hidhet përpjetë kur flet dëshmitari X

Kreu i deputetëve të LSI-së, Petrit Vasili akuzoi dje kryeministrin Edi Rama se harxhon miliona për të bërë portale gjoja për ankesa e denoncime, por kur flet dëshmitari X ai hidhet përpjetë. Vasili shkruan se Dëshmitari X i bëri zero portalet e Kryeministrit të kapur nga fyti. "Jo pak, por miliona euro për portale, që medemek do mblidhnin ankesa, denoncime, dyshime, hamendje për korrupsionin dhe për çdo paudhësi, që bëhej në administratën shtetërore dhe që ky kryeministri nuk i kapte dot dhe nuk i shikonte dot këta të poshtër në administratën e tij e që ia shkonin medemek atij ujin nën rrogos. Me këto portale kryeministri i legendisur bënte spote komike ku ky zgjidhte hallin tak-fak si në përrallat e 1001 netëve. Bëheshin edhe shkarkime gjigande mediatike drejtorucësh liliputë e të parëndësishëm. Por kur dëshmitari X del e denoncon ca gjëra shumë të rënda për trafikun e drogës, ky kryeministri qejfli i portaleve hidhet përpjetë, nxihet e shan gjithë botën, shan edhe një gazetare se i bëri ca pyetje të vërteta, shan opozitën po se po, shan komentuesit në 'FB', i shan të gjithë, por nuk shan kurrë trafikantët. I mbron, i adhuron, i admiron trafikantët kryeministri, sepse qeveris me ta, shantazon me ta, trimërohet me ta, sakrifikon Shqipërinë për ta. Neveri për portalet e kryeministritucit të kapur për fyti. Janë komedi që na vodhi miliona euro. Dëshmitari X i bëri zero portalet dhe kryeministrin portal", deklaroi z.Vasili.

### DEKLARATA

**SKENARI**  
"Pjesë kryesore e skenarit është mohimi i zërit të Agron Xhafajt, që i siguroi dëshmitarit X gjetjen dhe transportin e hashashit me garancinë se policia nën varësinë e vëllait ministër",



**IMPONIMI**  
Pjesa e dytë e këtij skenari sipas PD është imponimi ndaj prokurorisë të pranohë si ekspertizë të zërit të Agron Xhafajt rezultatin e paracaktuar nga vetë Edi Rama.



**PROVAT**  
"Fatmir Xhafaj vazhdon të qëndrojë në detyrë: për të vazhduar manipulimin dhe shkatërrimin e provave, nëpërmjet kukullave të tij në prokurori, Arta Marku dhe Donika Prela".



### Thirret në prokurori gazetari i përgjimit

## Olldashit do t'i kërkohet materiali bruto i audio-regjistrimit mes Veliut dhe Agron Xhafajt

Gazetari Jetmir Oll dashi do të jetë dëshmitari i radhës që do të pyetet nga prokurori i Krimeve të Rënda, në vijim të hetimeve për audio-përgjimin me dëshmitarin X. Sipas T'ch çështja e kallëzimit të tremë, e bashkuar tashmë në një të vetme me atë të trafikut të narkotikëve, do të dërgojë, gjithashtu, pranë akuzës edhe deputetët Ervin Salianji, Enkelejd Allibeaj dhe Gazmend Bardhi. Të tre ata në pozicionin e personave që kanë të dhëna të vlefshme, duhet të paraqiten në Prokurorinë Krimeve të Rënda, të hënë në orën 10:00. Me gjithë këtë, rrëfimi më i rëndësishëm pas dëshmitarit X, është ai i gazetarit Jetmir Oll dashi, i cili deklaroi një ditë më parë itinerarin e ndjekur



gjatë një investigimi, sipas tij mbi çështjet e trafikut në Vlorë. Por atij nuk do t'i kërkohen vetëm shpjegimet se si e takoi Albert Veliun, apo edhe si do të sigurohej hashashi. Gazetari, sipas një burimi të sigurt, do t'i kërkohet materiali bruto i audio-regjistrimit mes dëshmitarit X dhe Agron Xhafajt. Pas këtij momenti shpe-

guan të njëjtat burime të besueshme, prokurorët do të vendosin se ku do të zhvillohet ekspertiza e materialit audio, për të cilin po vlerësohen dy mundësi. Në pari, prokurorët do t'i drejtohen për ekspertizë policisë shkencore në Tiranë, për të krahasuar tonalitetet e zërit të Agron Xhafajt, të regjistruara nga prokurorët e Tiranës, përpara se ai t'u vetëdorëzohej italianëve me zërin që shfaqet në përgjim. E njëjta gjë do të ndodhë edhe në rastin e dëshmitarit Albert Veliu. Vetëm pas këtij momenti dhe nëse materiali bruto u dorëzohet hetuesve, prokuroria do të kërkojë edhe ndihmën e partnerëve ndërkombëtarë ashtu sikurse është vepruar edhe më parë.

inale të mosveprimit të ligjit antimafia, të falsifikimit të dokumenteve zyrtare dhe korrupsionit të zyrtarit të lartë në detyrë. Nisur nga kjo situatë, PD fton shqiptarët, të majtë dhe të djathtë që t'i bashkohen protestës së opozitës ditën e shtunë. Paloka u shpreh se përmes protestës duan t'i dërgojë një mesazh Europës se duan një qeveri të ndershme që të realizojë kushtet për hapjen e negociatave. "Ka ardhur koha që, të gjithë bashkë, t'i themi ndal pengmarrjes së shtetit nga

krimi! Partia Demokratike ka thirrur të shtunën tjetër më 26 maj një protestë kombëtare për të bashkuar shqiptarët në një zë: Fatmir Xhafaj ik! Shqiptarët nuk mund të pranojnë më të qeverisen nga krimi! Shqiptarët nuk kanë më kohë për të humbur, duke parë sesi qeveria e tyre refuzohet nga Europa për shkak të lidhjeve me krimin e organizuar, një herë me Saimir Tahirin dhe tani me Fatmir Xhafajn. Ju ftoj të gjithëve, të shtunën në orën 11.00, pa dallime partiake të bashko-

hemi në protestën kombëtare, për t'i dhënë mesazhin Europës se shqiptarët europianë refuzojnë një qeveri antieuropiane! Se duam një qeverisje të ndershme, e cila do të realizojë kushtet për hapjen e negociatave. Se duam luftën dhe jo mbrojtjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit. Se duam drejtësinë e barabartë për të gjithë dhe jo drejtësinë e kapur. Ju ftoj të gjithë në protestën kombëtare, të shtunën në 26 maj në orën 11.00", deklaroi nënkryetari i PD-së.

## NISMA LIGJORE DEBATI

Zbardhet nisma ligjore, Shehu: E bëjnë për të larguar vëmendjen nga skandalet e qeverisë

# Kartat, përveç 'mashkull ose femër' do të shkruhet një opsion i tretë

## Arsyet, pritet të ndryshojë Kodi i Familjes

Valentina Madani

Një nismë e fundit ligjore pritet të shkaktojë një debat të ri në opinionin publik që ka të bëjë me deklarinimin e gjinisë në kartat e identitetit. Deputeti i Partisë Demokratike, Tritan Shehu reagoi dje në lidhje me projektin ligjor dhe është propozuar në Kuvend, ku në një pjesë të tij thuhet se në dokumentet e identitetit nuk do përcaktohet gjinia. Sipas tij, askush nuk e shpjegon se si duhet emërtuar ky seks i ri, "tjetër". Shehu përmes një postimi në rrjetet sociale zbardhi dje këtë nismë, sipas të cilës në kartat e identitetit veç gjinisë mashkull ose femër, do të lihet edhe një opsion i tretë. Për Shehun, i cili reagon në një postim në "Facebook", kjo është një artificialitet për të hequr vëmendjen nga hallet e mëdha. Ai shpreh indignitetin e tij pasi kërkohen të goditen disa principe bazë e të shenja të shoqërisë, rritjes e edukimit të fëmijëve, identifikimit të njerëzve, themele këto të mbijetesës e zhvillimit njerëzor. "Rreth një nisme për një "tjetër", të krijuar artificialisht e qëllimisht nga "disa". Deklarohet se në Kuvend është dorëzuar një projektligj i ri për të vendosur në dokumentet e identitetit, përveç seksit "mashkull ose femër" edhe një rubrikë "tjetër" për seksin, pa përcaktim! Askush nuk e shpjegon se si duhet emërtuar ky seks i ri, "tjetër", shprehet z. Shehu. Ai bën të qartë se "në disa qenie biologjike ka dhe një "tjetër", quhet "hermafrodit", besoj se nuk bëhet fjalë për një term të tillë në propozim. Përndërsa natyra i kanë ndarë njerëzit në "meshkuj ose femra", mbi të cilën është mbështetur vetë ekzistenca e qenies njerëzore, familjes si bazë e shoqërisë në të gjithë gjerësinë e fjalës. Po kështu deklarohet se po përgatiten edhe një draft tjetër ligjor, që të ndryshojë Kodi i ynë i Familjes për dy qëllime: 1-Të pranohet martesë e familja nga kopje homoseksuale, ose nga kjo "tjetra" pa emër! 2-Të realizohen adoptime



Deputeti i Partisë Demokratike, Tritan Shehu

### DEKLARATA

"Askush nuk e shpjegon se si duhet emërtuar ky seks i ri, "tjetër". Po kështu deklarohet se po përgatiten edhe një draft tjetër ligjor, që të ndryshojë Kodi i ynë i Familjes për dy qëllime: 1-Të pranohet martesë e familja nga kopje homoseksuale, ose nga kjo "tjetra" pa emër! 2-Të realizohen adoptime të fëmijëve nga kopje gay ose nga "tjetra", përsëri pa emër", -tha z. Shehu.

## Meta përshëndet Olimpiadën Mbarëkombëtare të Matematikës

Presidenti Ilir Meta përshëndeti dje Olimpiadën Mbarëkombëtare të Matematikës. Fituesja e olimpiadës me 99 pikë është vajza nga Berati, Johana Bendaj klase e 9-t. " Duke i dhuruar dhe një buqetë me lule duke simbolizuar 100 pikë të arritura në këtë olimpiadë, Presidenti u shpreh që ndodh rrallë për të marrë 99 pikë. Kjo është një kënaqësi e madhe dhe një duartrokitje për të gjithë mësueset e fëmijët e Beratit. Urime të gjithëve dhe jam shumë i kënaqur që fëmijët që kanë ardhur nga trevat shqiptare kanë qenë mysafirë të bashkëmoshatarët e tyre beratas, sepse kjo do të thotë matematikë, por edhe miqësi", shprehet z. Meta. Po dje Presidenti i Republikës, Ilir Meta mori pjesë



### PJESËMARRJA

Presidenti i Republikës, Ilir Meta mori pjesë dje në nisjen e maratonës së 6 në Berat. "Maratona është disiplina sportive që kërkon forcë, rezistencë, durim, besim dhe vizion për të arritur një finish të suksesshëm"-shprehet z. Meta.

Tritan Shehu shpreh shqetësimin se "kërkohet të goditen disa principe bazë e të shenja të shoqërisë, rritjes e edukimit të fëmijëve, identifikimit të njerëzve, themele këto të mbijetesës e zhvillimit njerëzor". Deputeti i PD-së ngre dyshime dhe shtron py-

etjen: A mendoni se kjo "zhurmë e re" nxitet të krijojë pikërisht tashmë për të larguar vëmendjen nga problemet e mëdha, që ka sot vendi e kjo Rilindje? Dhe për ta mbyllur, këtij statusi nuk po i bashkëngjis foto, për disa arsye..."



### LLOGARIDHËNIA

Qeveria do të zhvendoset të hënën dhe të martën në Gjirokastrë, për të kryer dy procese: llogaridhënien publike dhe mbledhjen e qeverisë në këtë qark. Të hënën veç inspektiveve në Libohovë do të ketë dëgjësje me minoritetet në Deriçan për ndryshimet ligjore në këtë kategori. Në 16:00 do të ketë mbledhje qeverie në Gjirokastrë, e më pas një takim llogaridhënës me banorët e këtij qyteti në Pallatin e Sportit.



## I veshur sportiv e me bashkëshorten, ambasadori Donald Lu viziton kopshtin zoologjik

Kopshti Zoologjik i kryeqytetit pret çdo ditë vizitorë të mjeshtër të tij. Por këtë herë 'ZooPark' pati dje një vizitor edhe më të veçantë, ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri, Donald Lu dhe bashkëshorten e tij. Çifti amerikan së bashku me një grup nxënësish të huaj që banojnë në Tiranë, vizituan ambientet e ndryshme të kopshtit zoologjik. Me fletëpalosjet në duar ku jepen dhe informacione të shumta për 'ZooPark' ambasadori Lu, bashkëshortja e tij dhe grupi i të rinjve kanë vizituar kafshët që janë në kopshtin zoologjik, por dhe mjedis të tjera të hapësirës tërësisht të gjelbëruar të kopshtit zoologjik. Ambasadori amerikan ka ndjekur me kureshtje edhe lojërat apo eksperimentet në natyrë të të rinjve. "ZooPark" çdo javë pret vizita, orë mësimi, praktika e aktivitete. Së bashku me 'GrwnLineAlbania' i japim hapësirë edhe takimeve me nxënës të huaj me banim në Tiranë, shpjegojmë kureshtet, dëgjojmë e bashkëbisedojmë për projektet", sqaron Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, e cila kujdeset për t'i dhënë 'ZooPark' një pamje dhe një mjedis mikpritës për çdo vizitor. Ndërkohë që në këtë park ka nisur puna për përfundimin e murit rrethues si pjesë e projektit për rikualifikimin e kopshtit zoologjik.



Palombarët e RENEAS gjatë kërkimeve në lumin Erzen



Palombarët e RENEAS dhe policia e Farkës në aksion për gjetjen e të riut, i pranishëm dhe i vëllai

Ina Allkanjari

TIRANË

# U zhduk te "Shpella e Pëllumbasit", vijojnë kërkimet për gjetjen e Xhorxho Seferit

*Flet i mbijetuari: E mori rrjedha e lumit, s'e shpëtova dot*

Dy turistë shqiptarë ranë mesditën e së shunës në vendin e njohur si "Shpella e Pëllumbasit" në Tiranë, ndërsa njëri prej tyre vijon të jetë i zhdukur. Bëhet fjalë për 20-vjeçarin Xhorxho Seferi, i cili besohet të jetë marrë nga rrjedha e ujit në kanion. Palombarët e RENEAS vijojnë kërkimet për gjetjen e të riut në grykën e Skuranës në lumin Erzen. Ndërkohë Fabio Dukagjini, 21-vjeçari, i cili fatmirësisht u nxor prej andej pa pasoja për jetën, ka dëshmuar rreth ngjarjes në polici. Në gjendje të tronditur mësohet se i riu ka treguar se nuk ka mundur ta shpëtojë shokun e tij Xhorxho Seferi, pasi e mori rrjedha e lumit.

**NGJARJA**

Mesditën e së shtunës konkretisht rreth orës 12:15, te "Shpella e Pëllumbasit", në Tiranë kanë rënë nga lartësia shtetasit Xhorxho Seferi dhe Fabio Dukagjini. Dy të rinjtë ishin pjesë e një grupi turistësh shqiptarë. Vetëm 4 orë pas rënies së dy të rinjve, falë ndërhyrjes së forcave të policisë dhe atyre zjarrfikëse u bë e mundur nxjerrja nga gryka e kanionit e 21-vjeçarit Dukagjini. Fatmirësisht i riu ndodhet në gjendje të mirë shëndetësore. Nga rrëzimi ka pësuar dëmtime të lehta, dhe menjëherë është dërguar për kontroll në spital. "Më datë 19.05.2018, rreth orës 12:15, te "Shpella e Pëllumbasit", kanë rënë nga lartësia shtetasit Xh. S., dhe F. D. (pjesë të një grupi turistësh shqiptar). Shtetasit Xh. S., dyshohet të jetë marrë nga rrjedha e ujit, ndërsa shtetasit F. D., ka mbetur në një grykë kanioni dhe ndodhet në gjendje të mirë shëndetësore. Shërbimet e policisë dhe zjarrfikëses po punojnë për nxjerrjen e shtetasit F. D. nga gryka e kanionit dhe për gjetjen dhe nxjerrjen nga ujë të shtetasit Xh. S.", thuhet në njoftimin e policisë. Nga pamjet e publikuara dallohet terreni i vështirë ku ranë të rinjtë, si dhe operacioni i shpëtimit të Fabios. Ndërkohë prej orës 08:00 të ditës së djeshme, palombarët e RENEAS kanë rinisur kërkimet për gjetjen e trupit të 20-



Xhorxho Seferi



Fabio Dukagjini

**"Shpella e zezë", ekspedita kthehet në tragjedi**

**Rrëshqiti në lumin Erzen dhe humbi jetën, si u zhduk 18-vjeçari në 2014**

Shpella e Pëllumbasit e Shjohur edhe si Shpella e Zezë konsiderohet si një vend arkeologjik në Shqipëri, afër fshatit Pëllumbas. Grupe të shumta turistësh vizitojnë shpesh këtë shpellë, e cila ndodhet në një zonë malore dhe rruga për mbërritjen drejt saj është e thepisur dhe e vështirë. Por përpos bukurisë natyrore, shënohen raste tragjike, ku të rinjtë gjatë eksplorimit kanë hasur vështirësi për shkak të terrenit të vështirë. Kujtojmë rastin e dy adoleshentëve, të cilët ishin pjesë e një grupi të rinjsh që do vizitonin shpellën e Pëllumbasit. Ata u përfshinë në një aksident mesditën e 30 marsit të vitit 2014. Njëri prej tyre, pikërisht 18-vjeçari Erjon Alizoti, është rrëmbyer nga rrjedha e lumit dhe trupi i



pajetë i të riut është gjendur 10 ditë më vonë nga palombarët dhe forcat RENEAS në një guvë rreth 20 metra larg vendit ku ai u rrëzua. I riu bashkë me grupin mbi 50 veta ishin organizuar në rrjetin social "Facebook" nga "Rrjeti i Vullnetarëve Shqiptarë". Erjoni u rrëzua bashkë me një djalë tjetër, Daniel Spahiu, i cili fatmirësisht arriti të shpëtohej nga pjesëtarët e tjerë të grupit. Në kërkimet për gjetjen e Erjonit u përfshinë edhe familjarë, miq, shokë dhe vetë per-

soni që ka qenë dëshmitari kryesor, i cili prej tri ditësh ka qenë së bashku me policinë, të cilët i ka orientuar rreth kërkimeve duke kërkuar edhe vetë për të gjetur trupin e pajetë të shokut të tij. Një prej organizatorëve të ekskursionit, Ilija Gërdupi, i cili pas ngjarjes dha dëshminë e tij në polici, rrëfeu për itinerarin dhe momentin kur u vu rreth mungesa e Erjonit. Grupi ishte nisur prej mëngjesit të 30 marsit nga Kruga e Elbasanit me dy autobusë deri në Komunën e Bërzhitës. Më tej të rinjtë kanë ecur në këmbë drejt "Shpellës së Pëllumbasit", por Erjoni bashkë me disa të rinj të tjerë, pavarësisht se sipas organizatorëve u tha që terreni ishte i vështirë, morën rrugën për të vizituar kanionet e Erzenit, aty ku u gjet edhe trupi i pajetë i të riut.

**KËRKIMET**

Prej orës 08:00 të ditës së djeshme, palombarët e RENEAS kanë rinisur kërkimet për gjetjen e trupit të 20-vjeçarit, i cili dyshohet se është mbytur në lumin Erzen. Kërkimet nga palombarët kanë vijuar në gjatësinë e lumit, deri në grykën e Skuranës, në një terren shumë të vështirë.

vjeçarit, i cili dyshohet se është mbytur në lumin Erzen. Kërkimet nga palombarët kanë vijuar në gjatësinë e lumit, deri në grykën e Skuranës, në një terren shumë të vështirë. Është devijuar një pjesë e lumit me qëllim uljen e nivelit, pasi rrjedha është shumë e fuqishme dhe terreni është shumë shkëmbor dhe shumë i thepisur. Krahas kërkimeve nga palombarët e RENEAS, një grup punonjësish policie të stacionit të policisë Farkë, kanë vijuar krehjen e shtratit të lumit nga të dyja anët. Gjatë kërkimeve nga palombarët e RENEAS, ka qenë i pranishëm edhe vëllai i shtetasit që dyshohet i mbytur. Deri në këto momente nuk është bërë e mundur gjetja e trupit të 20-vjeçarit, ndërsa kërkimet po vijojnë. Sakaq Fabio Dukagjini, shoku i Xhorxho Seferit që humbi mesditën e së shunës, është marrë ditën e djeshme nga policia në pyetje, ndërsa është shprehur se nuk ka mundur ta shpëtojë Xhorxon. "U hodh në lum për t'u larë, dhe e mori rrjedha, nuk e shpëtova dot", mësohet të ketë dëshmuar 21-vjeçari, Fabio Dukagjini.

**SHKURT**

**Gjendet i vdekur në makinë 75-vjeçari, policia: S'ka shenja dhune**

Një 75-vjeçar është gjetur i vdekur gjatë ditës së shtunë në kryeqytet. Bëhet me dije se viktima është Hasan Meta, i cili punonte si farmacist. Ai është gjetur i vdekur brenda makinës së tij tip "Benz" në parkimin e një pallati në rrugën "Janos Hunyadi". Në trupin e viktimës nuk janë konstatuar shenja dhune dhe paraprakisht dyshohet se vdekja ka ardhur për shkak natyral. Materialet në referuan në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

**Aksidenti në autostradë, tri mjete përplasen në seri, plagoset drejtuesja**

Dy automjete janë përfshirë pasditën e djeshme në një aksident në autostradën Durrës-Tiranë. Sipas të dhënave zyrtare rreth orës 16:40, në autostradën Durrës-Tiranë, janë përplasur 3 mjete. Konkretisht mjete me targë AA 011 ED, me drejtues shtetasin Xh. Y., mjete me targë AA 827 RC, me drejtuese shtetasen E. D. dhe mjete me targë AA 868 DZ, me drejtues shtetasen R. K. Si pasojë e përplasjes të 3 makinave ka mbetur e dëmtuar lehtë drejtuesja e mjetit me targë AA 868 DZ, shtetasja R. K., e cila është dërguar në spital për ndihmë mjekësore. Shërbimet e policisë shkuan menjëherë në vendngjarje dhe po kryejnë veprimet e mëtejshme hetimore dhe procedurale.

**MALI I ZI-** Me mijëra refugjatë nga Lindja e Mesme dhe Afrika Veriore po provojnë fatin për të arritur në vende më të pasura europiane, për këtë shkak mësohet se Mali i Zi po planifikon të ndërtojë një gardh me tela në kufi me Shqipërinë. Bëhet me dije se kjo masë do të merret vetëm në rast të një fluksi të madh të refugjatëve. Mësohet se Mali i Zi, ka vënë re një rritje të numrit të refugjatëve të jashtëligjshëm që kalojnë për në vendet e Bashkimit Europian nëpërmjet një shtegu që shkon nga Greqia përmes Shqipërisë, Malit të Zi dhe Bosnjës në anëtarë të BE-së, Kroaci. Shefi i Departamentit për kufirin shtetëror, Vojislav Dragović,

## Shumë vende sigurojnë kufijtë e tyre me pengesa fizike

Mali i Zi planifikon të ndërtojë gardh me tela në kufi me Shqipërinë, shkak fluksi i refugjatëve

### REFUGJATËT

Shefi i Departamentit për kufirin shtetëror, Vojislav Dragović, bëri të ditur se po konsideron ndërtimin e një gardhi me tela me gjemba në kufirin me Shqipërinë për të frenuar rrjedhën. Ai tha se autoritetet shqiptare shpesh kishin refuzuar të pranin emigrantët që janë kthyer nga Mali i Zi nën marrëveshjen dypalëshe të ripranimit.

bëri të ditur se po konsideron ndërtimin e një gardhi me tela me gjemba në kufirin me Shqipërinë për të frenuar rrjedhën. "Në rastin e një fluksi më të madh të emigrantëve, ne mund të

ngremë një gardh me tela në kufirin me Shqipërinë", tha për televizionin shtetëror Dragovic. Ai tha se autoritetet shqiptare shpesh kishin refuzuar të pranin emigrantët që janë kthyer nga

Mali i Zi nën marrëveshjen dypalëshe të ripranimit. Bosnja tashmë ka nisur të përballot me mijëra refugjatë që janë ngjuar në këtë vend, pasi një shteg përmes Turqisë, Greqisë, Maqedo-



Foto ilustruese

nisë dhe Serbisë u mbyll në vitin 2016, kur Turqia u pajtua të frenojë rrjedhën e refugjatëve në këmbim të ndihmës së BE-së. Nga ana tjetër, shumë vende në itinerarin e migrantëve kanë siguruar

kufijtë e tyre me pengesa fizike. Hungaria ka vendosur gardh në kufijtë me Serbinë dhe Kroacinë gjatë krizës që shpërtheu në vitin 2015, kur më shumë se 1 milion emigrantë hynë në Europë.

Shkatërrohet grupi kriminal i trafikantëve, u kapën me 400 milionë euro drogë

# 1.8 tonë kokainë në Gjermani, vihet në lëvizje prokuroria shqiptare

Krimet e Rënda nisin verifikim pasurisë për 13 të arrestuarit

Pas një hetimi 1-vjeçar autoritetet gjermane shkatërruan grupin kriminal të trafikantëve të kokainës, mes të cilëve ranë në pranga 13 shqiptarë. Njëpërmjet disa operacione policore u bë e mundur bllokimi i një sasive prej 1.8 tonë kokainë në Gjermani. Mësohet se droga trafikohej nga Ekuadori përmes ngarkesave me banane. Ndërsa autoritetet gjermane janë duke vazhduar hetimet për të dokumentuar dhe provuar rolin e secilit në grupin kriminal të përfshirë në trafikimin e drogës së fortë hetimi për këtë rast nuk ka lënë pa prekur edhe territorin shqiptar. Pas shkëmbimit të informacionit në kuadër të marrëdhënies së ndihmës juridike me palën gjermane, hetuesit e Krimeve të Rënda kanë nisur veprimet për verifikimin e pasurisë së shqiptarëve të arrestuar në Gjermani. Bëhet fjalë për identifikimin e pasurisë të tyre në Shqipëri dhe më tej kalimin në filtrat e ligjit an-



Prokuroria e Krimeve të Rënda

### SHQIPTARËT E ARRESTUAR

1. ORNEO MARGJEKA
2. EMILJAN HYSENAJ
3. DASHAMIR NDOJ
4. DARIO LAME
5. ERVIN LLUSHA
6. IZMIR LAMI
7. DOLAN KOCANI
8. AGIM ZEKA
9. MARJAN TOLA
10. MEVLAN BECA
11. GRANIT BAJRAMI
12. ARTAN MEHMETI
13. BLERIM CAKRAJ

tiamafia, nëse ato janë siguruar në burime të ligjshme. Ndërkohë policia gjermane e konsideroi sukses operacionin e arrestimit të tyre, duke sqaruar se u godit një rrjet i madh të trafikut ndërkombëtar të drogës që drejtohej nga shqiptarët. Thuajse e njëjta skemë e përdorur edhe nga shoqëria "Arbi Garden" për sasinë prej 613 kg kokainë të futur në portin e Durrësit në maj, dyshohet nga autoritetet gjermane të ketë funksionuar për futjen në këtë vend të drogës me vlerë tregu mbi 400 milionë euro.

## Banasa të dëmtuara dhe panik, pasojat që la tërmeti në Vlorë

**VLORE-** Një sërë tërmetesh kanë terrorizuar banorët e qarkut të Vlorës gjatë ditës së shtunë. Lëkundjet kanë shkaktuar panik te banorët pasi në pak orë janë regjistruar shumë tërmete, një intensitet sizmik ky i pazakontë. Por përveç panikut që ka shkaktuar te banorët, tërmeti ka shkaktuar edhe dëme në disa fshatra të Vlorës. Fatmirësisht nuk pati asnjë person të lënduar. Mësohet se lëkundjet e tërmetit kanë shkaktuar dëme në zonën e Selenicës. Shumë shtëpi kanë pësuar krizje të mureve apo rënie të çatave. Në fshatin Vermik 10 banesa janë shembur, në

fshatin Bashaj 5 shtëpi me dëme të mëdha, sikurse pesë shtëpi në Matogjin. Pesë familje nga këto janë evakuuar nga autoritetet vendore pasi shtëpitë janë bërë të pabanueshme. Banorët kanë frikë nga lëkundjet e tjera. Rreth 15 familje kanë kaluar natën jashtë, në qiell të hapur për shkak të lëkundjeve të shumta, të cilat mund të përsëriten. Ndërkohë paratiden e ditës së djeshme ka shkruar për inspektim dhe prefekti i Vlorës, Flamur Mamaqi. Rreth orës 18:15 të ditës së shtunë, sipas Qendrës Mesdhetare të Sizmologjisë, një tërmet me magnitudë 4.5 ballë goditi jugun



e Shqipërisë. Epiqendra ka qenë 23 kilometra në jug-lindje të qytetit të Vlorës, në një thellësi vetëm dy kilometra, ndërsa tronditja është ndjerë në disa fshatra. Tërmeti i fortë u pasua gjatë natës edhe me lëkundjet e tjera me intensitet më të vogël. Lëkundjet janë ndjerë edhe në Gjirokastrë, Tepelenë, Sarandë dhe zonat përreth. Lëkundjet e tërmetit janë ndjerë prej pasdites së ditës së shtunë dhe deri në orët e para të mëngjesit të djeshëm.

## Arrestohet familja shqiptare në Itali, mediat fqinje: U shisnin drogë minoreneve

**ITALI-** Policia italiane ka vënë në pranga një familje shqiptare pasi akuzohen për shpërndarje të lëndëve narkotike. Mësohet se vitet e fundit nënë e bir konkretisht Adelina Lisi 40 vjeç dhe Hasan Lisi 23-vjeç kishin përhapur aktivitetin e tyre ilegal në Lucca, duke u shitur drogë të miturave. Në biznesin e tyre, ata kishin përfshirë edhe dhëndrin rumun, Daniel Valentin Ungureanu 28 vjeç, i cili, gjithashtu, u arrestua. Mediat italiane raportojnë se familja shqiptare trafikonte droga të llojit kokainë, marijuanë dhe hashash. Gjatë operacion-



it të autoriteteve italiane, u sekuestruan 2 kg marijuanë, 1 kg hashash dhe 15 gram kokainë. Hetimi ndaj familjes shqiptare kishte nisur më 27 korrik të vitit të kaluar, dhe që prej asaj periudhe ata ishin mbajtur nën përgjim. Gjithashtu, bëhet me dije se brenda 2 viteve, kjo familje kishte blerë dy shtë-

pi, një sipërfaqe toke dhe një makinë. Pronat e tyre u sekuestruan nga policia italiane, vlera e të cilave shkon në 200 mijë euro. Sipas mediave fqinje, familja shqiptare kishte zëvendësuar në këtë aktivitet një familje marokene (babain dhe dy fëmijët), të cilët u arrestuan në qershor 2016 për shitje droge.

# EMIGRANTËT NË GREQI NDRYSHIMET NË LIGJ

Ndërmjetësi ndërkulturor: Kategoritë që do të përfitojnë nga bashkimi familjar

Voltiza Duro

Për muajt gusht të këtij viti, emigrantët shqiptarë që jetojnë në Greqi nuk do të mund të marrin më lejen e qëndrimit për arsye të jashtëzakonshme me së paku tri vite qëndrimi në këtë shtet. Dispozitat e reja në ligjin e emigracionit, të miratuar nga komisioni parlamentar grek, parashikojnë që kjo leje tashmë të merret vetëm pas 7 vitesh jetese pa ndërprerje në tokën greke. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", Fatos Malaj, ndërmjetësi ndërkulturor në Ministrinë e Emigracionit dhe drejtues i organizatës së emigrantëve "Arogi - Përkrahja" tregon se ligji i ri sjell shumë ndryshime për emigrantët, si negative edhe pozitive. Më tej ai thekson se u shfuqizua dispozita që u jepte mundësinë atyre që kishin pasur në të kaluarën qoftë dhe një leje të vetme qëndrimi, të aplikonin për leje për arsye të jashtëzakonshme, mjafton që të mos kishin munguar nga Greqia për një periudhë më shumë se dyvjeçare. Por Malaj bën me dije se ndër ndryshimet pozitive në ligj, përfshihet njëjtësimi i institucionit të martesës me bashkëjetesën e vërtetuar; si dhe mundësia e bashkimit familjar.

**Pak kohë më parë organizata për mbrojtjen e emigrantëve shqiptarë në Greqi paraqiti disa propozime për ndryshime në ligjin e emigracionit. A u pranuan kërkesat tuaja nga komisioni parlamentar?**

Organizata "Arogi - Përkrahja" paraqiti gjatë një seance në komisionin përkatës parlamentar vërejtjet dhe sugjerimet e veta, disa prej të cilave janë pranuar nga ligjvënësit. Ne u pozicionuam në ndryshimet e bëra në ligjin për emigracionin, që u votuan së fundmi nga parlamenti grek. Unë si drejtues i Arogjit, gjykoj se ligji i ri sjell shumë ndryshime për emigrantët, ndryshime sa pozitive, aq edhe negative.

**Cilat janë disa nga pikat negative që u ndryshuan në këtë ligj e që do të prekin emigrantët shqiptarë në shtetin helen?**

Si një pikë shumë negative konsiderohet shfuqizimi i këtyre dispozitave: Parashikimet e nenit 19 të ligjit 4251/2014, që u lejonte gjithë atyre që kishin hyrë në Greqi para të paktën tre vjetësh, të aplikonin për leje qëndrimi për arsye të jashtëzakonshme; pra tashmë nuk do të lejohen më. Gjithashtu, u shfuqizua dispozita që u jepte mundësinë atyre që kishin pasur në të kaluarën qoftë dhe një leje të vetme qëndrimi, të aplikonin për leje për arsye të jashtëzakonshme, mjafton që të mos kishin munguar nga Greqia për një periudhë më shumë se dyvjeçare.

**Me ndryshimet e bëra, cilat janë kriteret që duhen**

# Dispozitat e reja në ligjin grek, ku do të penalizohen shqiptarët

Fatos Malaj: Ja si do të jepen lejet e jashtëzakonshme



Fatos Malaj

## HYRJA NË FUQI

Dispozitat e reja do të hyjnë në fuqi tre muaj pas publikimit të ligjit në Fletoren Zyrtare, domethënë pas 15 gushtit 2018. Organizata Arogi pret edhe daljen e qarkoreve shpjeguese me të cilat do të specifikohen më mirë gjithë dispozitat e ligjit të ri.

**plotësuar për marrjen e lejes së jashtëzakonshme?**

Leja e qëndrimit për arsye të jashtëzakonshme që do të jepet tashmë e tutje, do të jetë për ata që dëshmojnë se kanë krijuar lidhje me Greqinë dhe jetojnë këtu të paktën për shtatë vjet pa ndërprerje. Të interesuarit mund ta vërtetojnë qëndrimin e tyre ose me dokumente private, ose shtetërore; mjaft që këto dokumente të kenë data të sakta. Organizata e emigrantëve "Arogi" me propozimet që i paraqiti parlamentit, influencoi që të sanksionohen përfundimisht në ligj edhe dokumentet private, pasi projektligji parashikonte vetëm dokumentet e dhëna nga institucionet shtetërore.

**Për sa kohë do të jetë e vlefshme leja e jashtëzakonshme dhe sa duhet të paguajë emigrantët shqiptarë për ta marrë?**

Ligji ka edhe disa elemente pozitive. Është pranuar shtimi i vlefshmërisë së lejes së qëndrimit për arsye të jashtëzakonshme, e cila do të ketë kohëzgjatje tre vjet dhe paravolo do të kushtojë 300 euro, ndërkaq deri tani kjo leje qëndrimi kishte vlefshmëri dy vjeçare dhe kushtonte jo 300 euro. Cilat janë disa nga ndry-

**shimet pozitive të bëra në ligjin e emigracionit?**

Të ndryshimet pozitive përfshihen edhe njëjtësimi i institucionit të martesës me bashkëjetesën e vërtetuar; si dhe përfshirja në mundësinë e bashkimit familjar.

**Si mund të bëhet bashkimi familjar në Greqi, kush mund ta përfitojë?**

Bashkimi familjar mund të realizohet si pjesëtar i familjes së shtetasit grek/ shtetasit evropian përveç bashkëjetuesit edhe i fëmijëve dhe prindërve të një kategorie tjetër, që referohet në ligj si "çdo pjesëtar tjetër i familjes së qytetarit grek apo i bashkëshortit/ bashkëjetuesit tjetër, pavarësisht nënshtrësisë, përderisa ky person ka përkujdesjen e qytetarit grek apo të bashkëshortit/ bashkëjetuesit. Në mundësinë e bashkimit familjar të treta përveç bashkëshortit/ es dhe fëmijëve të mitur apo fëmijëve deri 21 vjeç, edhe të afërmit e bashkëshortit/ es, domethënë prindërit e tyre shtetas të vendeve të treta për të cilët do të mund tashmë të aplikohet për bashkim familjar; në varësi të kriterëve që do të vendosë ligji. Sa u përket aplikimeve që faktikisht janë

bërë, ligji përcakton se ato do të shqyrtohen me kriteret e ligjit të mëparshëm. Edhe ky ishte një propozim i organizatës "Arogi", që, gjithashtu, u paraqiti gjatë seancës në komisionin parlamen-

**Kur do të hyjnë në fuqi dispozitat e reja?**

Sic përcaktohet në ligj, dispozitat e reja do të hyjnë në fuqi tre muaj pas publikimit të ligjit në

Fletoren Zyrtare, domethënë pas 15 gushtit 2018. Organizata Arogi pret edhe daljen e qarkoreve shpjeguese me të cilat do të specifikohen më mirë gjithë dispozitat e ligjit të ri.

## NDRYSHIMET NË LIGJ

### Dispozitat që shfuqizohen:

► Parashikimet e nenit 19 të ligjit 4251/2014, që u lejonte gjithë atyre që kishin hyrë në Greqi para të paktën tre vjetësh, të aplikonin për leje qëndrimi për arsye të jashtëzakonshme;

► Gjithashtu, shfuqizohet dispozita që u jepte mundësinë atyre që kishin pasur në të kaluarën qoftë dhe një leje të vetme qëndrimi, të aplikonin për leje për arsye të jashtëzakonshme, mjafton që të mos kishin munguar nga Greqia për një periudhë më shumë se dyvjeçare;

► Leja e qëndrimit për arsye të jashtëzakonshme që do të jepet tani e tutje, do të jetë për ata që dëshmojnë se kanë krijuar lidhje me Greqinë dhe jetojnë këtu të paktën për shtatë vjet pa ndërprerje. Të interesuarit mund ta vërtetojnë qëndrimin e tyre ose me dokumente private, ose shtetërore; mjaft që këto dokumente të kenë data të sakta

### Ndryshimet pozitive:

► Shtimi i vlefshmërisë së lejes së qëndrimit për arsye të jashtëzakonshme, e cila do të ketë kohëzgjatje tre vjet dhe paravolo do të kushtojë 300 euro.

► Njëjtësimi i institucionit të martesës me bashkëjetesën e vërtetuar;

► Përfshirja në mundësinë e bashkimit familjar

**EPSA** SHOQËRIA PËRMBARUESE PRIVATE "E.P.S.A" SHPK NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT PER:

- Are** me nr.33/26, e ndodhur ne Karpen, Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.2099.vol.11, fq.202, me sip.2.000 m2, cmimi që do të shitet është **3.548.664** lekë.
- Are** dhe trull me nr.1/88, e ndodhur ne Qerret, Kavaje, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.3101, vol.9, fq.34, me sip.1.770 m2 cmimi që do të shitet është **8.793.590** lekë.
- Are** me nr.33/27, e ndodhur ne Karpen, Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.2099, vol.1, fq.203, me sip.4,050 m2 cmimi që do të shitet është **7.186.045** lekë.
- Are** me nr.70/9, e ndodhur ne Qerret, Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.3101, vol.2, fq.106, me sip.6.460 m2 cmimi që do të shitet është **4.584.875** lekë.
- Njësi** me nr.15/22+1-N1 e ndodhur ne Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.8551, nr.rregjistri hipotekor 14/69, vl.2011, datë 03.03.2011 me sip.116 m2 vlerësohet me vlerën e **9.056.191** lekë.
- Njësi** me nr.15/22+1-N2 e ndodhur ne Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.8551, nr.rregjistri hipotekor 14/70, vl.2011, datë 03.03.2011 me sip.91 m2 vlerësohet me vlerën e **7.104.426** lekë.
- Njësi** me nr.15/22+1-N3 e ndodhur ne Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.8551, nr.rregjistri hipotekor 15/71, vl.2011, datë 03.03.2011 me sip.95 m2 vlerësohet me vlerën e **7.416.708** lekë.
- Njësi** me nr.15/22+1-N4 e ndodhur ne Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.8551, nr.rregjistri hipotekor 15/72, vl.2011, datë 03.03.2011 me sip.211 m2 vlerësohet me vlerën e **16.472.899** lekë.
- Bodrum** me nr.15/22+1-B e ndodhur ne Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.8551, nr.rregjistri hipotekor 130/176, vl.2005-2007, datë 24.09.2007 me sip.609 m2 vlerësohet me vlerën e **13.261.358** lekë. Te gjitha pasuritë e sipërcituara jane hipotekuar në favor te **Banka Raiffeisen sha**. Prsh Casa Nostra.

Ankandi zhvillohet ne datë **11.06.2018** ora **16.00** në adresen Rr."I. Qemali", Pall."Fratri", K.6, Tirane. Per cdo informacion kontaktoni ne tel. 04 2262711 ose ne [www.epsa.al](http://www.epsa.al)

Kryebashkiaku Veliaj: I japim fund radhëve të gjata në sportele

Nis shërbimi e-kioska në Tiranë, ofron 47 shërbime

60%

SHËRBIMET MERREN NË E-KIOSKA.

"Në pak minuta, pa pagesë, shumicën e këtyre aplikimeve, si aplikimi për hapësirë publike, për licencë taksie, për akses në rrugë, për aktivitete politike, pra më shumë se 60% e shërbimeve që ofrohen në sportelin e bashkisë, fare mirë mund të aksesohen përmes e-kioskës", tha kryebashkiaku.



e-kioska

Prej ditës së djeshme, qytetarët e Tiranës dhe të zonave përreth nuk do të presin në radhë për të marrë një dokument e madje mund t'i tërheqin dhe në fundjavë. Njësoj si një bankomat, njësitë administrative të Tiranës ofrojnë shërbimin e-kioska, i cili të jep mundësinë që në pak minuta të tërheqësh një certifikatë, leje apo aplikosh për një kërkesë në Bashkinë e Tiranës. Kryebashkiaku Erlon Veliaj ishte në Njësinë Administrative 5 të Tiranës, për të përruruar shërbimin e ri të e-kioskave, që do të funksionojë pranë të gjitha

njësjive administrative. "Jam shumë i lumtur që fillojmë një projekt pilot si e-kioska. Ndonjëherë harrojmë se koha që kalojmë në radhë, po mblidhet, është baras me 9 ditë në vit. Pra, 9 ditë ia kushtojmë radhës për të marrë një dokument, që fare mirë mund të printohet nga

shtëpia, në faqen e internetit e-kioska.al, ose mund të printohet në kioskat e shërbimit të kompjuterizuara, pranë njësjive tona të qeverisjes vendore", theksoi Veliaj. E-kioska ofron shërbime 24 orë dhe në dy gjuhë: shqip dhe anglisht. Përmes kësaj teknologjie in-

ovative, qytetarët përfitojnë shpejtësi dhe përmirësim të dukshëm të cilësisë të shërbimeve ndaj qytetarit, si dhe lehtësim të procedurave dhe automatizim të shërbimeve. Veliaj u shpreh se tashmë qytetarët do të mund të marrin në këto njësi 47 nga 70 shërbime që

ofrohen nga Bashkia e Tiranës. "Në pak minuta, pa pagesë, shumicën e këtyre aplikimeve, si aplikimi për hapësirë publike, për licencë taksie, për akses në rrugë, për aktivitete politike, protesta, mitingje, koncerte, pra më shumë se 60% e shërbimeve që ofrohen në sportelin e

bashkisë, fare mirë mund të aksesohen përmes e-kioskës", tha kryebashkiaku. Ky shërbim funksionon duke u identifikuar përmes skanimit të letërnjoftimit nga pajisja përkatëse e më pas qytetari zgjedh shërbimin e dëshiruar dhe e-kioska printon dokumentin.

Statistikat, rreth 31 mijë persona pa kujdes prindëror. Dungaj: Më tepër lehtësira

Voltiza Duro

Mbi 200 jetimë kërkojnë strehim, punësim e arsimim

Muharemi: Zbatueshmëria e statusit është zero

Dje, në Ditën Komëtare të Fëmijëve Jetimë, Shoqata Kombëtare e Fëmijëve Jetimë në bashkëpunim me Kuvendin e Republikës së Shqipërisë organizuan pritjen e më shumë se 200 fëmijëve jetimë në një seancë plenare. Të pranishëm në këtë takim ishin edhe disa deputetë si dhe Avokati i Popullit, të cilët dëgjuan kërkesat e personave pa kujdes prindëror si dhe shqetësimet e tyre veçanërisht mbi strehimin dhe bursat shkollore. Ndërkohë, një grup të rinjsh jetime me përfaqësi të të riut Alfred Muharemi kishin planifikuar që të protestonin përpara Kryesisë së Kuvendit, por kjo protestë nuk u realizua. "Protesta që kishim planifikuar të realizonim sot (dje) nuk u bë pasi u ftuam nga Kryetari i Shoqatës së Jetimëve, Lulzim Resuli. Ky i fundit u shpreh se rruga më e mirë për të shfaqur kërkesat tona ishte duke u përfaqësuar në parlament. Në seancën plenare, të cilët e drejtuan vetë fëmijët jetime ju dha fjala Deputeteve të pranishëm të Republikës së Shqipërisë, ministres Ogerta Manastirliu, përfaqësuesve të Shoqatës Kombëtare të Jetimeve, si dhe përfaqësuesve të Kulteve fetare", tregon për "Gazeta Shqiptare" i riu i rritur në fshatin Sos, Alfred Muharemi.

KËRKESAT

Gjatë takimit të mbajtur, jetimët kërkuam ndryshim të ligjit për statusin e jetimit si dhe mbështetje financiare për këtë kategori. "Kërkesat tona, të cilat parashtruan ishin që kërkonim një ndryshim tërësor të ligjit për statusin e jetimit, e cila ka zero zbatueshmëri. Kërkuam që t'i jepet fund rekrutimit të



Dje jetimët në takimin me deputetët



PLLUMB DUNGAJ Kërkojnë strehim e punësim

Një tjetër i ri jetim, Pllumb Dungaj, tashmë baba i 4 fëmijëve tregon për "Gazeta Shqiptare" se deri në muajin korrik të këtij viti, do të bëhet hartimi i një drafti ku do të paraqiten të gjitha kërkesat e tyre për t'i ardhur në ndihmë kësaj kategorie. "Të ndryshohet statusi i jetimit, kërkojmë strehim, punësim dhe arsimim. Kërkojmë më tepër lehtësira, sepse prej 27 viteve gjithçka ka ngelur në letër", -thotë Dungaj.



mlitantëve në institucionet e përkujdesjes shtëpi fëmije, kërkuam një komisioner për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve jetimë pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, si dhe asistim dhe mbështetje në politika sociale dhe financiare të favorshme për fëmijët jetimë", thekson më tej Muharemi për "GSH". Ndërkohë ky i fundit bën me dije se arsimimi, punësimi dhe strehimi i garantuar kanë qenë tri kërkesa

të tjera të ngritura nga personat pa përkrahje prindërore. "Bëmë apel që ndaj kësaj kategorie, e cila prej 27 viteve ende nuk ka progres për përmirësimin

e kushteve sociale; të ngrihet grupi i punës me përfaqësi të të rinjve jetimë, të shoqërisë civile dhe të anëtarëve të komisionit të çështjeve sociale

për identifikimin e problemeve dhe përmirësimin e kushteve të jetimëve", shprehet i riu i fshatit SOS. Në këtë seancë, e cila zgjati rreth dy orë, jetimët morën

premtim se qeveria dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale do të jetë e angazhuar për integrimin e kësaj kategorie në vend.

31

MIJE JETIMË NË VEND

Në vendin tonë jetojnë aktualisht rreth 31 mijë individë jetimë të moshës 1-25 vjeç. Aktualisht në Fshatin SoS mbështeten 63 fëmijë që janë të shpërndarë në 13 shtëpi vila. Pasi fëmijët mbushin moshën 17-18 vjeçare, ata kalojnë në një ambient tjetër pasi SoS, Fshatrat e Fëmijëve ka krijuar 2 Komunitete Rinore me kapacitet deri në 15 fëmijë.

Shitje me Ankanë të dyle nga Studio Permbartore L.D.C. Përkrahimi i pasurive. 1. "Trazë Idetësor", me Nr. Pasurisë 84/5/1 ndodhur në ZK 1247, Vol. 9, faqe 143 me adresë në Borizani, Krujë. Regjistruar në Zyrën Vendore Regjistrimi Pasurive Palaqshme Krujë. Regjistruar në emër të Ramadan Selim SHIMA. Pasuria 84/5/1 e lloji Trazë me sipërfaqe 250 m2, 2 kate banese si dhe një kat / papallogj shose. Çmimi fillestar për shpërblim është porçaktuar të jetë 12,800,000 Leka. (dymbëdhjetë milion e lotëqind mijë) leka. Data e shpalljes 10.05.2018 Data e zhvillimit 31.05.2018 deri në orën 16.00 Ankandë zhvillohet në ambientet e zyrës Studio Permbartore L.D.C të ndodhur në adresën: Rruga "Mystylm Shyrt", Vila 8/1, Kati 1, Tiranë, e-mail letter.cansaj@yahoo.com.

SHOQËRIA PËRMBARTORE GJYQËSORE "3H" Sh.p.k Adresa: Rr. "Demokracia" Pk. 1, Kt. 1, Vore, Tiranë. Web: www.3h.al Email: sh@3h.com Tel/Fax: +35501 44532482 Njifton shpalljen e ankandë nga dt.17.05.2018 deri në dt. 25.05.2018 për: sende të luajtshme mjeti me targë AA 957 GX Nissan Altea 140, Vit prodhimi 2000, karburant-naftë, për skrap në pronesi të Subjektit "Harzi Co" me Nipt K82122503F Çmimi fillestar është 78,400.00 (shtatëdhjetë e tetemije e katerqind) Leka Ankandë zhvillohet në zyrën permbartore në datën 25.05.2018 dhe mbyllet me orarin zyrtar 16.00.



## INTERVISTA

# JANKA TRIFONOVA:

## Përkthimi e jeta ime me Skënder Selimin, e lumtur që nuk e braktisa më 1960

Fatmira Nikolli

Romani "Hotel Grand" i shkrimtarit të njohur kroat Renato Baretiç merr shtypje nga ndodhitë e gjysmës së parë të viteve 90 të shekullit të XX, kur ish-Jugosllavia fillon të shtyhet dhe "Hotel Grand", nga një "shtëpi e zakonshme", shndërrohet në një qendër prostitucioni. Autori vë në qendër një familje dhe fëmijë, që rritet në atë mje-dis, pranë nënës dhe babait, që tek merren më këtë "biznes" të fshehtë t'reken të ruajnë një imazh të rregullt.

Romani në fjalë i sjell në shqipë nga 83-vjeçarja Janka Trifonova-Selimi bëhet shkas për një bisedë me përkthyesen. Ajo thotë se "e kam përkthyer me kënaqësi, e në momente të veçanta e kam lënë dhe nuk e kam vazhduar, sepse jam emocionuar ose jam tronditur nga ngjarjet e tij".

Mandej, vetë jeta e Trifonovës, i ngjet një romani. Ishin vitet 1950 kur vajza e re bullgare shkoi për studime në Moskë. Që në vit të parë, u njoh me një shqiptar, Skënder Selimin. Të rinjtë, u dashuruan dhe vendosën të ndërtonin jetën në Shqipëri. Me t'u kthyer, Skënder Selimi vë në skenë baletet e para në Filharmoninë e Shtetit dhe Teatrin e Operës, si "Zarena e humbur", "Zhurale Fadata", "Laurenzia", "Sheherezada", "Anusha" etj. Njëherit, Janka punonte në Radio Tirana- në qytetin që u kthye në shtëpinë e saj të dytë të vetme, kur Shqipëria vendosi të izolohej nga bota.

Në intervistën e saj për "GSh" gjatë festivalit "Ditënetët e librit" (që u mbajt në Muzeun Kombëtar nga KlikEkspo Group 16-20 maj) 83-vjeçarja Janka Trifonova-Selimi rrëfen jetën me baletmaestron shqiptar deri kur ai u nda nga jeta, nisur që nga vendimi i vitit 1960, për të mos e braktisur atë.

Trifonova-Selimi, ka sjellë nën logon "Botime PO-ETEKA", katër shkrimtarë të njohur shqar të Ballkanit "Hotel Grand", të shkrimtarit kroat Renato Baretiç, "Roman natyral", të shkrimtarit bullgar Georgi Gospodinov, "Tespitet prej qelbari", të shkrimtarit nga Mali i Zi, Jovan Nikolaidis dhe "Fëmijët e Hansasit", të autorit Ognjen Spahiç. Rrëfimi i mëposhtëm, nis me përkthimin.

**-Cilën kohë të Shqipërisë ju kujton "Hotel Grandi", trazirat e 1997-ës?**

Më kujton disa trazirat, sepse sollën shumë të këqija. Libri sjell në vëmendje ndarjet e shteteve, ka shumë dhimbje- edhe pse ishte një kënaqësi e mëvetësisë së këtyre vendeve, kishte edhe

dhimbje për shkak të shpërndarjes nga diçka që e ke jetuar. Personazhi kryesor i romanit rritet në një hotel, ku ndodh diçka e rëndë- hoteli është edhe shtëpi. Ata e edukojnë fëmijën, por në hotelin-shtëpi ka krim, korrupsion, prostitucion. Fëmija njihet po aty me botën tjetër, atë që prindërit nuk ia kishin prezantuar. Sheh vetë gjithçka që ata ia kishin fshehur, një trupin e tij dhe bëhet dëshmitar në skena të rënda.

**-Pse e sollët në shqip "Romanin natyral"?**

Është një vepër postmoderniste, por edhe klasike. Kur historia personale e njeriut shkatërrohet, atij nuk i mbetet gjë tjetër veçse të bëhet mbledhës historik të huaja dhe të kthehet në pjesë të atyre historive. Një tekst shumë i thjeshtë... Një roman që nuk është e lehtë ta klasifikosh në asnjë kategori, një rrëfim i ëmbël dhe i pamëshirshëm, sa i errët, po aq dhe me humor, sic cilësohet nga botimi i tij në frëngjisht, është njëkohësisht "një kryevepër e vogël dhe e plot hijeshi rrëfimi dhe stiles, të cilat kanë ndikuar që libri të botohet në 17 gjuhë me një sukses të plotë.

**-Për të përkthyer "Fëmijët e Hansasit", çfarë ju ngacmoi?**

Përmes metaforës brilante komunizëm-lebër, në vepër të tij të mirënjohur; "Fëmijët e Hansasit", shkrimtari malazez Ognjen Spahiç, sjell me elegancë, por edhe pa mëshirë, pamjet e një bote që lexuesi i ka ndeshur me përmbysjen e regjimeve totalitare: frikën për ta thënë deri në fund të vërtetën, trishtimin, humorin dhe horrorin në kohë krizash. Është fundi i viteve 1980. Europa është gati të ndryshojë përgjithmonë. Ndodhitë zhvendosën në një cep të humbur të Rumanisë, ku dy burra presin që realiteti dhe fati i lebrozitet, që u ka rënë për pjesë, të ndryshojë. Romani, është një tjetër dhimbje e madhe, sepse ka të bëjë me izolimin. Izolimi ka horror e dhimbje, e dëshirë për të shpëtuar, e kur më në fund shpëton, del se je i vetëm, askush nuk të afrohet më.

**-A janë shqiptarët e sotëm?**

Nuk janë doemos shqiptarët e sotëm, sepse është kohë që jetuam brezi im. Por, nga ana tjetër, ne sot nuk

*Bullgarja që jeton prej 60 vitesh në Shqipëri rrëfen për bashkëshortin, koreografin e njohur*



Janka Trifonova-Selimi



Romanet e përkthyer nga Janka Trifonova

pranohemi. Kemi dalë nga izolimi, por kudo që shkojmë na shohin me sy tjetër, jemi ende brenda spitalit të lebrozëve.

**-Sot, 83 vjeçe, sa kujtimet keni lënë pas?**

83 vjeçe, doni të thoni që kam jetuar izolimin? Do thosha që kam jetuar kohën time. Më ka rënë për hisë, por e kam nisur me një ideal. Me besimin e madh në një ideal. E di se sot të rinjtë nuk besojnë më në asgjë, por ne aq besonim e aq ishim të frymëzuar nga ideali, aq ishim të lumtur. Nuk e di nëse mund të ketë një lumtur të tillë apo jo më, as sikundër nuk e di nëse mund të ketë një zhgënjim të tillë më. Sepse lumturia që e madhe, por po aq zhgënjimi. Po aq shumë qenë momentet që duhej të mbijetoje edhe pse ishe i zhgënjyer dhe duhej të ecje drejt, të ruaje veten. Unë që isha e huaj duhet të ruaja edhe me shumë emrin tim, pikërisht se isha e huaj. Rrugës, dëgjoja që shpesh herë të thoshin, "ajo, bullgarja".

**-E vuanit? Ju shihnin si**

**spiuje apo thjesht e vuanit ju?**

Jo, nuk më shihnin si spiuje. Unë kam pasur fat, kam punuar në Radio Tirana dhe atje kam shkuar mirë me kolektivin, edhe pse Albert Minga thoshte se "ne ju shihnim, por nuk ju afroshim". Nuk na afroshim vërtetë.

**-Kur keni ardhur në Shqipëri?**

Unë kam ardhur më 1958 dhe s'vijet bëj 60 vjet në Shqipëri.

**-Me bashkëshortin u njohët në Moskë. Kur erdhët në Shqipëri, 2 vite më pas, Shqipëria i prishi marrëdhëniet me Lindjen. E menduat ndonjë moment të iknit?**

Më 1961 kur ikën gratë ruse me të cilat unë kisha shumë miqësi, sepse i njihja që nga Moskja, një prej shoqeve të mia më tha: a do vish? Avioni po nisët dhe ka një vend bosh. Në asnjë rast nuk e mendova që të ikja.

**-Po bashkëshorti çfarë ju tha, të rrinit?**

Nuk ma tha asgjë. E vendosva vetë. Mund të them se

vite. Ne, që kur jemi takuar, kemi vendosur të jemi bashkë deri në fund, duke qenë e lumtur për çdo ditë që kam qenë pranë tij.

**-Kur vendosët të rrinit me të e jo të ktheheshit në Bullgari, a ju tha bashkëshorti që bëtë gabim? A ndjehej fajtor që qëndruat këtu për të?**

Ne kemi pasur lidhje të tillë, sa asnjëherë nuk e kemi vënë në dyshim nëse ai është fajtor, apo unë. Nuk mundesha të bëja atë fajtor, sepse ashtu mund të thuhet edhe se unë isha fajtorë për jetën e tij, sepse e çuan pesë vite në Kopluk.

**-Prej jush?**

Mua nuk më lëvizën, por lëvizën tim shoq. Unë punoja në radio dhe jepja mësim në një kurs për gjuhët e vogla siç quheshin atë kohë. Skënderi që e çuan në Kopluk, u përpoq të bënte çfarë mundet edhe atje. Bënte ekspedita në Malësinë e Madhe, krijoi një grup si ansambël dhe mbrojti disertacionin "Lirika koreografike".

**-Ju kërkonte ndihmë Selimi për punën e tij?**

Më kërkonte më shumë literaturë për temat që po trajtoje. Për çdo balet që vinte në skenë, unë kërkjoja bibliografinë për të mësuar më shumë mbi arkitekturën e epokës, historinë, kostumet, e jo vetëm. I ndante me mua idetë e konsultojhej. Por ai nuk kënaqej asnjëherë me atë që bënte.

**-Kur u rikthyet në Bullgari?**

Një herë pas 12 vitesh më 1972. Më pas më 1981 dhe pas 1990-ës. '90-ta ishte shumë e dhimbshme, sepse na u tha që mund të bëni kërkesë për pasaportë. Ikëm bashkë, unë me tim shoq dhe me djalin. Djali kishte lindur në Bullgari, por tani që do shkante atje, do të vizitohej, se ishte i sëmurë. Unë e humba atje djalin, e u ktheva pa të.

**-Kur keni filluar të përktheni?**

Kur ishim në radio përkthenim pjesë letrare si "Kështjella" e Kadarese. Kur kishte përjetore poetësh e shkrimtarësh, e drejtori Thanas Nano na jepte "vision" për përkthimet e leximit e ndryshme që duheshin bërë. Ndërsa, pas 1990-ës që krijuar një kënd në një revistë për letërsinë ballkanike dhe nisa të përktheja tragjike.

çasti më vendimtar ka qenë më 1961, kur shkova në Bullgari. Im shoq më bëri një telegram ku më thoshte: Nisu sa më parë, se kështu është puna. U thashë prindërve, që duhet të iki. Im atë më kërkoi të mendohesha duke më bërë me dije se "do bëhet njësoj si me Jugosllavinë, të do mbyllet kufijtë". Unë isha me djalin e vogël me vete. U mendova gjatë dhe i thashë: "Nuk kam të drejtë të lë djalin pa baba". Nuk vura veten në plan të parë, nuk mendova për veten. Thjesht nuk doja që djali im, të humbte të atin, siç e kishte humbur im shoq.

Kur arritëm në Tiranë, im shoq më tha se ma kishte nisur telegramin, pasi e dinte që do mbylleshin kufijtë.

**-Si e përjetuat ju Shqipërinë, si të vetmin fat tujajin?**

Ka qenë e vështirë vitet e para. Më 1962, 1963, 1964 kam vuarjtur jashtëzakonisht. Mendova se do mbetesh përgjithmonë jashtë dhe larg njerëzve të mi. U dobësua shumë dhe më mundonte mendimi se do mbetesh këtu, do vdisja këtu.

**-Kishit dilema?**

Po. Por më pas me kalimin e kohës, çdo gjë shqiptare mu bë e imja.

Im shoq ishte balet-maestro dhe bënte ekspedita, kthehej e më tregonte çfarë bënte. U mësova me çdo gjë.

**-Si ka qenë jeta tuaj me Skënder Selimin? Ai ishte i njohur e i vlerësuar, por si ishte në raport me ju?**

Unë jam e lumtur që kam qenë pranë tij. Nuk kam asnjë peng, asnjë peng për ato

Zbardhet formulari-tip për informim në lidhje me ecurinë e dosjes

# Pronarët në Fier, ATP merr në shqyrtim 1030 dosje

Rifreskohet lisa, procedurat për t'u njohur me ecurinë e shqyrtimit

Ornela Manjani

Agjencia e Trajtit të Pronave publikon listën me 1030 dosje ish-pronarësh që janë në proces shqyrtimi nga kjo agjenci. Kërkuetit janë në qarkun e Fierit dhe janë në pritje të vendimit të ATP-së. Në listën e përditësuar jepet numri i dosjes dhe data e aplikimit. Të gjithë ish-pronarët që kanë aplikuar për kthimin dhe kompensim pronë në Agjencinë e Trajtit të Pronave dhe nuk janë njohur ende me vendimin e agjencisë mund të kërkojnë informacion në lidhje me fazën në të cilën

ndodhet dosja. Agjencia e Trajtit të Pronave ka në dispozicionin të pronarëve formularin -tip, "Informacion në lidhje me ecurinë e dosjes", i cili duhet të plotësohet dhe të dorëzohet në agjenci për të njohur me fazën në cilën ndodhet shqyrtimi i saj. Agjencia e Trajtit të Pronave është e detyruar që brenda 15 ditëve nga momenti i dorëzimit të kërkesës të kthejë përgjigje pronarit në lidhje me ecurinë e dosjes.

**APLIKIMI**

Për t'u njohur me ecurinë e dosjes subjekti duhet të plotësojë dhe të paraqesë dorazi ose me postë pranë ATP-së dokumentacionin, kërkesën përkatëse me sh-

**DOKUMENTACIONI QË DUHET TË PARAQISNI**

- Formulari tip
- Fotokopje e kartës së identitetit
- Kopje vendimi nga ish KKP/AKKP (nëse ka)
- Dokumente të tjerë

krim për informim në lidhje me ecurinë e dosjes, fotokopje të kartës së identitetit, dëshmi trashëgimie dhe prokurë të posaçme. Në faqen zyrtare të ATP-së mësohet se subjekti plotëson kërkesën me shkrim për informim në lidhje me ecurinë e dosjes pranë Zyrës së Marrëdhënies me Publikun, në agjenci. Më pas

kërkesa i kalon zyrës së protokollit, e cila pasi e protokollon i dërgon të gjitha kërkesat e ardhura Drejtorit të Përgjithshëm. Kreu i AKKP-ës ia delegon kërkesat sektorit përkatës për ndjekje dhe zbatim. Më pas sektori përkatës përgatit informacionin e kërkuar dhe njofton subjektin. Në përfundim të shqyrtimit

subjekti paraqitet pranë zyrave të ATP-së për të tërhequr shkresën me kthimin të përgjigjes në lidhje me ecurinë e dosjes ose i dërgohet me postë sipas kërkesës. Aplikimi për kërkesën për informim mbi dosjen nuk ka kosto.

**FORMULARI**

Formulari i aplikimit për informacion në lidhje me ecurinë e dosjes është i ndarë në tre seksione. Aplikanti duhet të plotësojë gjeneralitet

dhe adresën dhe jetë i pajisur me mjet identifikimi në momentin e aplikimit. Në seksionin e dytë duhet të jetë përkthuar në mënyrë të saktë se në lidhje me çfarë kërkoh informacion pala e interesuar, në këtë rast pronari që ka aplikuar për kthim e kompensim prone. Dhe në seksionin e fundit janë të specifikuar pesë dokumentet që duhet të disponojë pronari në momentin e aplikimit.

**1030 DOSJE NË SHQYRTIM**

Nr	Date	Qarku	Statusi	Zona Kadastrale	329/1111	1/6/2010	Fier	Ne shqyrtim	3031	119	1/24/2013	Fier	Ne shqyrtim	8534
289	12/30/2008	Fier	Ne shqyrtim	2087	29	3/20/2016	Fier	Ne shqyrtim	8572	791	2/22/2013	Fier	Ne shqyrtim	qesarat
292	12/30/2008	Fier	Ne shqyrtim		75/993	6/4/2010	Fier	Ne shqyrtim	3979	170	3/21/2013	Fier	Ne shqyrtim	1451, 2968
295	12/30/2008	Fier	Ne shqyrtim	sheq	600	11/1/2010	Fier	Ne shqyrtim	103	1711	5/8/2013	Fier	Ne shqyrtim	Topoj
296	12/30/2008	fier	Ne shqyrtim		267	12/29/2010	Fier	Ne shqyrtim	1422	308	5/8/2013	Fier	Ne shqyrtim	???
298	12/30/2008	Fier	Ne shqyrtim	1614	10	1/12/2011	Fier	Ne shqyrtim	1707	333	6/3/2013	Fier	Ne shqyrtim	2869
299	12/30/2008	Fier	Ne shqyrtim	16 prill	9	1/12/2011	Fier	Ne shqyrtim	2271	334	6/10/2013	Fier	Ne shqyrtim	3172
300	12/30/2008	Fier	Ne shqyrtim	8533	8	1/12/2011	Fier	Ne shqyrtim		343	6/12/2013	Fier	Ne shqyrtim	3015
301	12/30/2008	Fier	Ne shqyrtim	2027	24	2/10/2011	Fier	Ne shqyrtim	8571	542	7/4/2013	Fier	Ne shqyrtim	3356
302	12/30/2008	fier	Ne shqyrtim	3000	262	3/30/2011	Fier	Ne shqyrtim	3358	543	7/8/2013	Fier	Ne shqyrtim	2891
303	12/30/2008	Fier	Ne shqyrtim	cerm e poshtme	273	4/5/2011	Fier	Ne shqyrtim	2022	548	7/9/2013	Fier	Ne shqyrtim	3816
306	12/30/2008	Fier	Ne shqyrtim	kute	293	4/18/2011	Fier	Ne shqyrtim	1857	550	7/10/2013	Fier	Ne shqyrtim	8572
307	12/30/2008	fier	Ne shqyrtim		313	5/3/2011	Fier	Ne shqyrtim	1984	2566	7/19/2013	Fier	Ne shqyrtim	
308	12/30/2008	Fier	Ne shqyrtim	Gryk	509	5/6/2011	Fier	Ne shqyrtim	8534	577	7/22/2013	Fier	Ne shqyrtim	2022
297	12/30/2008	Fier	Ne shqyrtim	??	18/17	5/11/2011	Fier	Ne shqyrtim	8541	611	8/16/2013	Fier	Ne shqyrtim	3105
298	12/30/2008	Fier	Ne shqyrtim	8571	527	5/27/2011	Fier	Ne shqyrtim	2297	639	9/11/2013	Fier	Ne shqyrtim	8571
290	12/30/2008	Fier	Ne shqyrtim	1451	591	7/4/2011	Fier	Ne shqyrtim	1984	716	10/3/2013	Fier	Ne shqyrtim	1918
291	12/30/2008	Fier	Ne shqyrtim	1451	600	7/5/2011	Fier	Ne shqyrtim	2532	734	11/5/2013	Fier	Ne shqyrtim	2117
294	12/30/2008	Fier	Ne shqyrtim	1027	296	7/19/2011	Fier	Ne shqyrtim	2087	737	11/11/2013	Fier	Ne shqyrtim	1090
309	12/31/2008	Fier	Ne shqyrtim	2087	43	3/20/2016	Fier	Ne shqyrtim	3508	740	11/14/2013	Fier	Ne shqyrtim	2289
310	12/31/2008	Fier	Ne shqyrtim	1422	633	9/6/2011	Fier	Ne shqyrtim	2787	759	12/16/2013	Fier	Ne shqyrtim	3172, 2890
311	12/31/2008	Fier	Ne shqyrtim	3980	785	9/13/2011	Fier	Ne shqyrtim		21	2/4/2014	Fier	Ne shqyrtim	
314	12/31/2008	Fier	Ne shqyrtim	frutor	769	9/13/2011	Fier	Ne shqyrtim	2527	25	2/6/2014	Fier	Ne shqyrtim	2384
315	12/31/2008	Fier	Ne shqyrtim	1926	813	9/13/2011	Fier	Ne shqyrtim	2326	209	7/16/2014	Fier	Ne shqyrtim	3850
316	12/31/2008	Fier	Ne shqyrtim	2160	1070	10/3/2011	Fier	Ne shqyrtim	8534	290	10/28/2014	Fier	Ne shqyrtim	Ballsh
317	12/31/2008	Fier	Ne shqyrtim	kerkutas	1332	10/5/2011	Fier	Ne shqyrtim	8572	293	10/30/2014	Fier	Ne shqyrtim	3805
318	12/31/2008	Fier	Ne shqyrtim	3538	1342	10/5/2011	Fier	Ne shqyrtim	1567	309	11/14/2014	Fier	Ne shqyrtim	2789
319	12/31/2008	Fier	Ne shqyrtim	1002	1480	10/18/2011	Fier	Ne shqyrtim	3361	3534	12/18/2014	Fier	Ne shqyrtim	2060
21	2/20/2016	Fier	Ne shqyrtim	1295	1485	10/24/2011	Fier	Ne shqyrtim	8572	88	3/12/2015	Fier	Ne shqyrtim	2270
22	3/20/2016	Fier	Ne shqyrtim	3547	1499	11/1/2011	Fier	Ne shqyrtim	1027	1626	3/30/2015	Fier	Ne shqyrtim	2288
320	12/31/2008	Fier	Ne shqyrtim	3015	1524	11/17/2011	Fier	Ne shqyrtim	8571	137	4/24/2015	Fier	Ne shqyrtim	8571
23	3/20/2016	Fier	Ne shqyrtim	1984	1527	11/22/2011	Fier	Ne shqyrtim	2890	147	4/30/2015	Fier	Ne shqyrtim	?
321/252	4/28/2009	Fier	Ne shqyrtim	8571	1528	11/23/2011	Fier	Ne shqyrtim	1758	158	6/16/2015	Fier	Ne shqyrtim	Mallakaster
24	3/20/2016	Fier	Ne shqyrtim	2060	1582	12/13/2011	Fier	Ne shqyrtim	2700	277	10/28/2015	Fier	Ne shqyrtim	Loni Dhamo
322	5/4/2009	Fier	Ne shqyrtim		1584	12/13/2011	Fier	Ne shqyrtim	8571	90/161	6/18/2018	Fier	Ne shqyrtim	2497
324	6/9/2009	Fier	Ne shqyrtim	1813	268	12/29/2011	Fier	Ne shqyrtim		48	6/24/1905	Fier	Ne shqyrtim	2087, 1984, 2663, 1750
329/99	6/23/2009	Fier	Ne shqyrtim	8571	1607	12/29/2011	Fier	Ne shqyrtim	1492	233	30.02.2001	Fier	Ne shqyrtim	fshati Lumth
326	6/23/2009	Fier	Ne shqyrtim	1755	587	7/2/2012	Fier	Ne shqyrtim	8531	559		Fier	Ne shqyrtim	3143
266	12/29/2009	Fier	Ne shqyrtim	2087	784	9/13/2012	Fier	Ne shqyrtim		577		Fier	Ne shqyrtim	1414
330	12/29/2009	Fier	Ne shqyrtim	8534	940	9/28/2012	Fier	Ne shqyrtim	2286	136		Fier	Ne shqyrtim	
28	3/20/2016	Fier	Ne shqyrtim		968	11/8/2012	Fier	Ne shqyrtim	8534			Fier	Ne shqyrtim	Rerez

	Fier	Ne shqyrtim	3617	3822	11/19/2014	Fier	Praktikë	?	10	12/19/2002	Fier	Ne shqyrtim	1285	
	Fier	Ne shqyrtim	3921	3833	11/19/2014	Fier	Praktikë		23	12/19/2002	Fier	Ne shqyrtim	1295	
1	6/21/1905	Fier	Ne shqyrtim	8571	3926	11/25/2014	Fier	Praktikë	Cak-	14	1/15/2003	Fier	Ne shqyrtim	8572
	Fier	Ne shqyrtim	1984	ran					19	2/7/2003	Fier	Ne shqyrtim	1620	
	Fier	Ne shqyrtim	3172	4043	12/3/2014	Fier	Praktikë	golem	1532	2/12/2003	Fier	Ne shqyrtim	1539	
	Fier	Ne shqyrtim	1382	I madh					498	3/4/2003	Fier	Ne shqyrtim	2265	
	Fier	Ne shqyrtim	1 maji	4212	12/12/2014	Fier	Praktikë	3979	155	3/7/2003	Fier	Ne shqyrtim	8572	
4	6/19/1905	Fier	Ne shqyrtim	8571	4452	12/24/2014	Fier	Praktikë	8571	12	3/13/2003	Fier	Ne shqyrtim	8572
5	6/21/1905	Fier	Ne shqyrtim	1492	5	1/5/2015	Fier	Praktikë	?	28	3/13/2003	Fier	Ne shqyrtim	1596
	Fier	Ne shqyrtim	gadurov	17	1/6/2015	Fier	Praktikë		42	3/27/2003	Fier	Ne shqyrtim	3848	
	Fier	Ne shqyrtim	qeret	626	2/5/2015	Fier	Praktikë	2938	27	3/28/2003	Fier	Ne shqyrtim	2265	
6	6/19/1905	Fier	Ne shqyrtim	8571	791	2/12/2015	Fier	Praktikë		864	4/3/2003	Fier	Ne shqyrtim	1271
7	6/21/1905	Fier	Ne shqyrtim	2001	914	2/18/2015	Fier	Praktikë	2336	156	4/9/2003	Fier	Ne shqyrtim	1422
	Fier	Ne shqyrtim		986	2/23/2015	Fier	Praktikë	Zona	40	4/10/2003	Fier	Ne shqyrtim	1090	
	Fier	Ne shqyrtim	kafaraj	Kadastrale					157	4/22/2003	Fier	Ne shqyrtim	1380	
	Fier	Ne shqyrtim	ngurrez e madhe	1187	3/5/2015	Fier	Praktikë	?	499	4/25/2003	Fier	Ne shqyrtim	2111	
	Fier	Ne shqyrtim	sarave	1257	3/10/2015	Fier	Praktikë	1557	31	5/6/2003	Fier	Ne shqyrtim	1883	
	Fier	Ne shqyrtim	Praktika nr.3692	1626	3/30/2015	Fier	Praktikë		158	5/16/2003	Fier	Ne shqyrtim	3436	
dt.10.11.2014				1885	4/17/2015	Fier	Praktikë	1928	607	5/16/2003	Fier	Ne shqyrtim	2274	
11	6/20/1905	Fier	Ne shqyrtim	8572	2000	4/24/2015	Fier	Praktikë		36	5/25/2003	Fier	Ne shqyrtim	3848
12	6/22/1905	Fier	Ne shqyrtim	8571	2207	5/5/2015	Fier	Praktikë	Zona Kadastrale	41	7/4/2003	Fier	Ne shqyrtim	1857
	Fier	Ne shqyrtim	1001	2663	6/18/2015	Fier	Praktikë	1438	46/1	7/16/2003	Fier	Ne shqyrtim	2087	
	Fier	Ne shqyrtim	Roskovec	2712	6/23/2015	Fier	Praktikë	29	161	7/21/2003	Fier	Ne shqyrtim	1857	
19	6/20/1905	Fier	Ne shqyrtim	1492	nentori				163	9/1/2003	Fier	Ne shqyrtim	2104	
	Fier	Ne shqyrtim	golem	2989	7/10/2015	Fier	Praktikë	?	1536	9/1/2003	Fier	Ne shqyrtim	1635	
	Fier	Ne shqyrtim	Grabjan	3126	7/22/2015	Fier	Praktikë	3031	479	9/9/2003	Fier	Ne shqyrtim	2104	
20	6/20/1905	Fier	Ne shqyrtim	8572	3766	9/30/2015	Fier	Praktikë		40	9/9/2003	Fier	Ne shqyrtim	2076
47	Fier	Ne shqyrtim		578	3/30/2001	Fier	Ne shqyrtim	8571	16	10/2/2003	Fier	Ne shqyrtim	2289	
1569	7/6/2010	Fier	Praktikë	8572	232	3/30/2001	Ne shqyrtim	L.Kongresi I	41	10/15/2003	Fier	Ne shqyrtim	2289	
2911	10/21/2010	Fier	Praktikë		Lushnjes				42	10/24/2003	Fier	Ne shqyrtim	2289	
2942	10/25/2010	Fier	Praktikë	2636	76	3/30/2001	Fier	Ne shqyrtim	1027	502	10/27/2003	Fier	Ne shqyrtim	2289
3426	11/24/2010	Fier	Praktikë	8533	569	3/31/2001	Fier	Ne shqyrtim	8571	44	10/30/2003	Fier	Ne shqyrtim	2289
349	2/2/2011	Fier	Praktikë	?	572	3/31/2001	Fier	Ne shqyrtim	8571	349	11/4/2003	Fier	Ne shqyrtim	2289
702	3/4/2011	Fier	Praktikë	1492	577	3/31/2001	Fier	Ne shqyrtim	1380	601	11/4/2003	Fier	Ne shqyrtim	2289
1755	6/1/2011	Fier	Praktikë	?	1520	4/10/2001	Fier	Ne shqyrtim		165	11/4/2003	Fier	Ne shqyrtim	2289
1797	6/6/2011	Fier	Praktikë	lagjia kabo	325/1	5/14/2001	Fier	Ne shqyrtim		1539	11/20/2003	Fier	Ne shqyrtim	2289
1840	6/8/2011	Fier	Praktikë	Remas	118	6/19/2001	Fier	Ne shqyrtim	1351	350	11/27/2003	Fier	Ne shqyrtim	2289
2031	6/27/2011	Fier	Praktikë	xeng	1507	7/5/2001	Fier	Ne shqyrtim		160	12/3/2003	Fier	Ne shqyrtim	2289
2582	9/8/2011	Fier	Praktikë	Terbuf	492	7/24/2001	Fier	Ne shqyrtim	1143	503	12/4/2003	Fier	Ne shqyrtim	2289
2878	9/28/2011	Fier	Praktikë	3691	330	7/24/2001	Fier	Ne shqyrtim	dukas	270	12/15/2003	Fier	Ne shqyrtim	2289
2876	9/28/2011	Fier	Praktikë	3691	124	8/30/2001	Fier	Ne shqyrtim	1634	347	12/18/2003	Fier	Ne shqyrtim	2289
2877	9/29/2011	Fier	Praktikë	3691	850	9/3/2001	Fier	Ne shqyrtim	Fier	1540	1/23/2004	Fier	Ne shqyrtim	2289
2922	10/3/2011	Fier	Praktikë	?	493	10/15/2001	Fier	Ne shqyrtim	1422	867	4/6/2004	Fier	Ne shqyrtim	2289
3584	11/25/2011	Fier	Praktikë	3031	329	10/15/2001	Fier	Ne shqyrtim	corrush	48	4/6/2004	Fier	Ne shqyrtim	2289
3600	11/30/2011	Fier	Praktikë		863	10/25/2001	Fier	Ne shqyrtim		1542	4/7/2004	Fier	Ne shqyrtim	2289
3965	12/27/2011	Fier	Praktikë		1517	11/9/2001	Fier	Ne shqyrtim	Dermenas	1541	4/14/2004	Fier	Ne shqyrtim	2289
340	1/23/2012	Fier	Praktikë	2891	128	12/3/2001	Fier	Ne shqyrtim	1634	1543	5/18/2004	Fier	Ne shqyrtim	2289
426	2/9/2012	Fier	Praktikë	2594	126	12/6/2001	Fier	Ne shqyrtim	2938	71	6/25/2004	Fier	Ne shqyrtim	2289
595	2/27/2012	Fier	Praktikë	2329	1513	12/6/2001	Fier	Ne shqyrtim	Peshtan	332	6/29/2004	Fier	Ne shqyrtim	2289
1085	4/10/2012	Fier	Praktikë	2700	331	12/12/2001	Fier	Ne shqyrtim	romes	421	7/8/2004	Fier	Ne shqyrtim	2289
1553	5/21/2012	Fier	Praktikë	?	146	2/1/2002	Fier	Ne shqyrtim	2436	28	2/20/2006	Fier	Ne shqyrtim	2289
1854	6/18/2012	Fier	Praktikë	8534	4-1	3/11/2002	Fier	Ne shqyrtim		94	6/12/2006	Fier	Ne shqyrtim	2289
1325	2/12/2013	Fier	Praktikë		853	3/12/2002	Fier	Ne shqyrtim		104	6/16/2006	Fier	Ne shqyrtim	2289
1378	4/13/2013	Fier	Praktikë		856	3/21/2002	Fier	Ne shqyrtim	Fier	19	5/14/2007	Fier	Ne shqyrtim	2289
1973	5/28/2013	Fier	Praktikë	3789	854	3/28/2002	Fier	Ne shqyrtim		45	6/11/2007	Fier	Ne shqyrtim	2289
2015	5/30/2013	Fier	Praktikë		138	4/4/2002	Fier	Ne shqyrtim	2435	49	6/12/2007	Fier	Ne shqyrtim	2289
2283	6/19/2013	Fier	Praktikë	1033	164	4/8/2002	Fier	Ne shqyrtim	1341	67	7/12/2007	Fier	Ne shqyrtim	2289
2140	7/8/2013	Fier	Praktikë	1596	15	4/12/2002	Fier	Ne shqyrtim	8572	76	7/24/2007	Fier	Ne shqyrtim	2289
3040	8/30/2013	Fier	Praktikë		137	4/16/2002	Fier	Ne shqyrtim	2265	79	7/25/2007	Fier	Ne shqyrtim	2289
2706	9/29/2013	Fier	Praktikë	1003	132	4/17/2002	Fier	Ne shqyrtim	2265	86	8/7/2007	Fier	Ne shqyrtim	2289
3268	10/30/2013	Fier	Praktikë	8351	4	4/17/2002	Fier	Ne shqyrtim	3105	3	9/3/2007	Fier	Ne shqyrtim	2289
3759	10/31/2013	Fier	Praktikë		134	4/29/2002	Fier	Ne shqyrtim	2938	124	9/10/2007	Fier	Ne shqyrtim	2289
3993	11/18/2013	Fier	Praktikë	?	148	5/8/2002	Fier	Ne shqyrtim	2265	108	9/10/2007	Fier	Ne shqyrtim	2289
3992	11/18/2013	Fier	Praktikë	8531	4	5/27/2002	Fier	Ne shqyrtim	8571	121	9/10/2007	Fier	Ne shqyrtim	2289
4058	11/21/2013	Fier	Praktikë	1024	139	6/24/2002	Fier	Ne shqyrtim	1351	117	9/10/2007	Fier	Ne shqyrtim	2289
1968/2	12/5/2013	Fier	Praktikë		497	7/9/2002	Fier	Ne shqyrtim	2869	147	9/19/2007	Fier	Ne shqyrtim	2289
8572					339	7/15/2002	Fier	Ne shqyrtim	greshic	poshtme				
4376	12/23/2013	Fier	Praktikë		143	7/17/2002	Fier	Ne shqyrtim	1945	161	9/19/2007	Fier	Ne shqyrtim	2289
2354	4/10/2014	Fier	Praktikë	2265	6	8/20/2002	Fier	Ne shqyrtim	8571	157	9/19/2007	Fier	Ne shqyrtim	2289
1423	4/28/2014	Fier	Praktikë	3358	9	9/11/2002	Fier	Ne shqyrtim	2106	158	9/19/2007	Fier	Ne shqyrtim	2289
1486	4/30/2014	Fier	Praktikë		162	9/12/2002	Fier	Ne shqyrtim	1351	156	9/19/2007	Fier	Ne shqyrtim	2289
2116	6/23/2014	Fier	Praktikë	8572	495	9/18/2002	Fier	Ne shqyrtim	1945	152	9/19/2007	Fier	Ne shqyrtim	2289
2254	7/3/2014	Fier	Praktikë	Corrush	14	10/3/2002	Fier	Ne shqyrtim	8572	163	9/20/2007	Fier	Ne shqyrtim	2289
2267	7/4/2014	Fier	Praktikë	8571	496	10/9/2002	Fier	Ne shqyrtim	1555	182	9/24/2007	Fier	Ne shqyrtim	2289
2768	9/3/2014	Fier	Praktikë	sheq I madh	1525	10/11/2002	Fier	Ne shqyrtim		177	9/24/2007	Fier	Ne shqyrtim	2289
3080	9/29/2014	Fier	Praktikë		152	10/19/2002	Fier	Ne shqyrtim	2802	179	9/24/2007	Fier	Ne shqyrtim	2289
3680	11/7/2014	Fier	Praktikë	1351	860	11/4/2002	Fier	Ne shqyrtim	Fier	175	9/24/2007	Fier	Ne shqyrtim	2289
3775	11/14/2014	Fier	Praktikë		199	11/15/2002	Ne shqyrtim	Lushnje		185	9/25/2007	Fier	Ne shqyrtim	2289
3819	11/18/2014	Fier	Praktikë	2789	7	11/26/2002	Fier	Ne shqyrtim	1295	191	9/25/2007	Fier	Ne shqyrtim	2289

Opinion i Ditës

## 70-vjetori i poetit tonë të madh, Agim Doçi

## Poeti që pranon të kryqëzohet...

Nga PANO HALLKO

Ngarja më e madhe e jetës kulturore artistike më datën 9 maj, ishte padyshim përvorimi i librit me poezi të poetit tonë të mirënjohur, Agim Doçi. Ishte përjetimi i një feste të veçantë, sepse i veçantë ishte personaliteti, i cili ftoi me qindra miq dhe kolegë të tij, më së shumti miq të letërsisë dhe të artit, miq të poezisë.

Bota e letrave shqipe dhe bota intelektuale e vendit, arti ynë më 9 maj festoi.

Ishte më së pari, festa e poezisë shqipe; asaj i lindi edhe një ditë më shumë, një libër i ri me poezi, ndër më të arrirët e saj.

Poeti Agim Doçi, e hap sallorin e librit, duke "gjuajtur me artileri", me poezinë me titull: "Riti i kryqëzimit". Katër vargje, që shpalosin një botë të tërë; botën e poetëve të mëdhenj... "Nëse i bëhet paqe, gjithë botës/Dhe lumturi të gjithë njerëzimit/I gjeni dërrasat dhe gozhdët/Unë pranoj ritin e kryqëzimit!"...

## HOVET DJALOSHARE TË POETIT

Ishte, gjithashtu, e veçantë kjo datëlindje, sepse ai që festonte, u bëri dhuratat të fuarve të shumtë, e nuk llogariti të marrë dhuratat nga ata. Dhe çfarë dhurate u bëri, se! Librin me titull "Rituali i kryqëzimit". Një tufë të madhe me 80 trëndafila, 80 poezi, të cilat mbarin hovet e Agim Doçit, tanimë 70-vjeçar!

Hove, që kurrë nuk kanë ndërmend "të zbuten", apo të ngadalësojnë "trokthin" e tyre.

Kështu u festua edhe datëlindja e 60-të e tij, para 10 vitesh. Me tufën e poezive, që ai na dhuroi atëherë.

Kështu, e me këto hove, do të festohet edhe datëlindja e 80-të e poetit.

Sepse shpirti dhe dora e tij, vazhdojnë të shkruajnë, rregullisht.

Vjen ky libër me poezi, në një kohë të vështirë për poezinë në vendin tonë, e më gjerë.

E vërteta është që poezia historikisht, ka qenë luks për ata që e kanë ndër dhe përjetuar; një luks që nuk mund ta shijonin të gjithë. Por në realitetin shqiptar, jetojmë paradoksin në fushën e letërsisë.

Isim një popull mik i librit, e në tranzicionin e stërzgjatur enkas, djallëzish nga politikanët shqiptarë, u katandisëm populli armik i librit.

Shqipëria, por edhe bota, sot përjeton rrallimin dhe pakësimin e poetëve të mëdhenj.

Po ashtu, te ne, mungon kritika, ky faktor kryesor jetik në përmirësimin dhe përhapjen e poezisë dhe të letërsisë në përgjithësi. Dhe ana tjetër, që është pasojë e gjithë sa thamë më sipër, është sepse për poetët e mëdhenj, jo gjithnjë shkruajnë njerëzit e letrave dhe njohësit e mirë të poezisë.

Në gjitha këto kuptime, kjo buqetë me poezi të pikura, dhe pjesë-marrja e madhe e njerëzve të kulturës dhe të artit, por edhe e shumë njerëzve të thjeshtë, vjen si një rreze shprese, se për poezinë nuk ka vdekje, se miqtë e saj, nuk u zhdukën me gjithsej.

Agim Doçi hyri në poezinë shqipe



me forcë; duke shqyer kornizat administrative të kohës.

Askund në botë nuk ka shkollë për poezinë dhe poetët. Mbi 90% e poetëve të vendit tonë, por edhe të botës, poezisë nuk i kanë ardhur nga shkolla e Gjyhë-Letërsisë.

Ashtu siç mbi 90% e gazetarëve, kurrë nuk ndoqën, e as mbaruan mirëfilli apo si shkollë të parë gazetarinë. Ndodh kështu, sepse ligji i krijimit është i veçantë.

Është një kimi e veçantë, që ose e ka, ose nuk e ka njeriu. Poeti ynë i madh, 70-vjetorin e të cilit festuam më 9 maj, i kreu të gjitha fazat e arsimimit të tij, shkëlqyeshëm.

Madje, edhe Inxhinierinë Elektrike të asaj kohe, e kreu me Medalje Ari. Ai ka marrë shumë medalje e vlerësime në jetë, madje është dekoruar "Mjeshtër i Madh". Por Kurorën e pavdekësisë, ia dha poezia.

Tre brezave shqiptarë, iu ushton në veshë, prezantimi i konferencierëve të Festivaleve të Këngës në Radiotelevizion, ndër vite: Teksti, Agim Doçi! Shumë brezave shqiptarë, u kanë mbetur e do t'iu mbeten në buzë, tekstet e Agim Doçit, muzikuar nga kompozitorët tanë të mëdhenj. Sepse muzika, mbetet në veshët e atyre që e lëvrojnë muzikën.

Kurse fjala, mbetet në buzët e njerëzve, të të gjithë njerëzve, pa përjashtim. Si atëherë kur ajo u flet njerëzve për gëzime, ashtu edhe kur fjala merret me hallet dhe me dhimbjen njerëzore.

Sepse... e para, ishte fjala! Kombi, të tillë poetë, i nxjerr një herë në qaf, në bazë të kushedi se çfarë Kodi, të pazbërthueshëm dot.

Edhe pse ka 50 vjet që lëvron si pak të tjerë poezinë, ai me modesti qysh në faqet e para kërkon prej të gjithëve, gjënë më minimale në botë: "Më bëni pak vend".

"Më bëni pak vend", i drejtohet lexuesve, sepse kërkon vendin në zemrat dhe shpirtin e tyre. Vendin të cilin e ka siguruar, e që kërkon ta ruajë me fanatizëm.

Megjithatë, ai zbaton kodin e stërlashtë të ilirëve, të cilët më parë se sa të prisnin një pemë të madhe, e godisin me fundin e sëpatës, diku mbi rrënjë; "Për t'u larguar xhin-det"-thoshin ata. Ashtu edhe Agim Doçi, aty në nisje të vëllimit të tij poetik, troket me bishtin e penës e me thelbin e zemrës, duke kërkuar "pak vend". "Më bëni pak vend mua, poetit të krisur/ Unë jam mirë, kur gjendem pranë jush!-thotë ai.

Por "pak vend", ai e ka edhe mes më të mëdhenjë poetë tanë. Dhe ja se si shprehet ai: "...Po e vuajnë Rilindësit, në varre ku janë/ Po e vuan Dritëroi, Xhevairi, Moikomi e të tjerë/ Dashurinë për Atshenë, këto halle s'na e vranë/ Ndoshita ne dhe shteti, jemi- Nuse dhe Vjerrë!"...

E vërteta është që Agim Doçi gjithnjë i është drejtuar shtetit të tij, në mënyrën e tij, e jo vetëm poetikisht.

## NËPUNËSI QË KËRKOJN SHTET...

Për 12 vite rresht, ai punoi në

Pensionin është një akt i thjeshtë administrativ. A ka shtet në botë, të nxjerrë në pension Agim Doçin? E realizonte këtë Agimi, sepse shpirti i tij ishte rebel ndër vite, qysh në sistemin e kaluar; kurrë nuk ishte bërë peng, i askujt.

Këtu, tek-të mos qenit peng i askujt, qëndron sekretet i suksesit të tij, në të gjitha fushat, doemos edhe në poezi.

Ky libër poetik që ka në dorë lexuesi sot, në datëlindjen e 70-të të poetit, nderon çdo bibliotekë dhe shtëpi, në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi, kudo ku ka shqiptarë. Libri e bën menjëherë vendin e vet, në çdo familje shqiptare. Sepse në libër, shkruhet për familjen e madhe të poetëve. U këndon të gjithë rilindësve, atyre që ikën tani afër, por edhe të gjallëve tanë të mëdhenj; Moikomiti, Xhevahirin e të tjerëve. I këndon kombit, jo rrallë-buzëplasar.

I këndon Kosovës, që është plaga dhe melhemi i shpirtit të tij. Por aty ai shkruan edhe për familjen emërmirë të tij. Krenohet me atin, e shkruan për nënën e tij-kapedane-siç u mbiquajti ajo, në vitet kur luftonte me armë në dorë kundër nazifashistëve dhe veglave të tyre.

Flitet, shkruhet dhe i këndohet në vargje vajzës, Argitës, krijesës së shenjtë të Agimit, me të cilën ai krenohet veçanërisht.

Flitet për familjen, për bashkëshortin, të mrekullueshmen Yllka, e cila gjendet në libër; si në poezitë që mirëfilli i dedikohen asaj, ashtu edhe nëpër rreshta në poezitë e tjera. Dhe i takon asaj, pasi siç dihet e njihet tanimë në rrang vendi e kombi, është një luks i vështirë, të jetosh e të funksionosh në jetë me Agim. Për ata që i njohin mirë të dy, është e qartë se në atë çift, janë bërë bashkë dy elementë: Realizim femëror i jetës dhe idealizmi i kulluar i poetit. E që për fat, kanë ndërtuar e mbajnë në këmbë një peshore të pagabueshme; peshoren e jetës.

Agimi ka në themel të shpirtit Kodin e vet... "Nëse do të lindja 12 herë/ Si vemje kurrë s'do hiqem zvarrë/ Dhe nëse do vdisja pa u lerë/ Prapë jam krenar, që jam shqiptar!"

Agimi ynë, është tmerrësisht i vërtetë, në një botë tmerrësisht të gënjeshtrë. Ndoshita kjo është arsyeja pse ai vuan kaq shumë. Por kjo është edhe arsyeja, që ai është kaq iri!...

Mos u mërzit, Poeti ynë. Kjo botë nuk është e talentëve, ca më pak e gjenive. Kjo është bota e pizevengëve. Ju keni dhembjet, ata kanë qëjft.

Megjithatë, historia mban shënime, të sakta, e jo ato që shkruajnë historianët partiakë...

Jetëgjatë, e të buroftë pena, poeti ynë!

Po kush tha se ka dalë në pension?



## DIETA USHQIMORE



Mungesa e kaliumit, gjashtë simptoma që nuk duhet t'i injoroni

## EFEKTET E AVOKADOS



Forconi zemrën duke konsumuar këto ushqime

# Ylli Merja:

◆ Mjeku popullor: Ky produkt, rigjenerues natyral biologjik i organizmit të njeriut



## Fuqitë e mrekullueshme të uthullës së hudhrës, ja si ta përgatisni

"Ndihmon në uljen e kolesterolit e përmirësimin e shikimit"

## Ja 10 efektet e mrekullueshme të ujit me limon



Voltiza Duro

Uthulla e mollës një het për efektet e saj të mrekullueshme në përmirësimin e qarkullimit të gjakut, lehtësimin në tretjen e ushqimit dhe jashtëqitjes, si dhe shkrirjen e yndyrave. Por nëse këtij produkti natyral i shtojmë të tjerë përbërës kimike që gjenden në perime ose në fruta të tjerë, vlerat e produktit do të shumëfishohen. Bëhet fjalë që uthullës së mollës t'i shtojmë kripërat e squfurit që gjenden te hudhra, antibiotikët e tjerë që ka hudhra si alicina; proteinat; vitaminat A1, B1, B2, B3; e mineralet. Ndërkohë nëse këtij produkti i shtojmë lëng limoni dhe mjaltë atëherë nuk kemi vetëm një uthull të thjeshtë, por një produkt vital për shëndetin.

**PERGATITJA**

Merrni 250 ml uthull molle dhe 200 gram hudhra të qëruara dhe të shtypura si dhe 2-3 limona të grirë. Vendosini në një kavanoz prej qelqi që mbyllet me kapak dhe nuk futet ajri, por duke lënë një hapësirë prej 4-5 cm nga kapaku i kavanozit e deri te niveli i uthullës me gjithë hudhër që gjendet brenda në kavanoz. Pastaj e mbyllni mirë kapakun dhe vendoseni në frigorifer dhe e lini aty për 10 ditë bashkë me lëvoren e limonit. Pastaj ditën e dhjetë e hapni dhe filtron uthullën, i largoni hudhrat ndërsa lëngun e hidhni përsëri në vazo, e vendoseni në frigorifer dhe e lini për dy ditë të tjera. Në ditën e tretë mund ta konsumoni pasi është gatë për përdorim.

**PERDORIMI**

Ky produkt natyral ndihmon në rigjenerimin e qelizave të trupit tonë. Thjesht mund të hidhni 1-2 lugë gjelle nga kjo uthull në gjelle ose në ujin që pini esëll në mëngjes shtoni një lugë gjelle me uthull hudhre. Përgatitëni dhe përdoreni rregullisht këtë produkt të çmuar natyror dhe do të bindeni në efektet rigjenerues të saj në organizëm.

**DOBITË E UTHULLËS SË HUDHRËS**

Kjo recetë shkrin të gjitha llojet e yndyrave dhe kolesterolin precipitat, përmirëson metabolizmin në trup dhe rrit fleksibilitetin e arterieve dhe venave, duke parandaluar

Thjesht mund të hidhni 1-2 lugë gjelle nga kjo uthull në gjelle ose në ujin që pini esëll në mëngjes shtoni një lugë gjelle me uthull hudhre



Mjeku popullor: Ky produkt, rigjenerues natyral biologjik i organizmit të njeriut

# Ylli Merja:

## Fuqitë e mrekullueshme të uthullës së hudhrës, ja si ta përgatisni

*"Ndihmon në uljen e kolesterolit e përmirësimin e shikimit"*

sëmundjet; hipertensionin infarktin në zemër, trashjen e fibrave të indeve si arteriet, mëlçinë dhe zorrët me sekrecion të brendshëm në sistemin nervor qendror. Gjithashtu, uthulla e hudhrës përmirëson shikimin dhe mbulon çrregullimet e bebëzës së syrit. Nëse e ndiqni rregullisht këtë recetë, rinia e qelizave të trupit përtërihet me shumë se 10 vjet.

Por ky produkt ndërkohë ndihmon edhe në uljen e peshës së trupit pasi lehtëson tretjen dhe jashtëqitjen nëse e pini në mëngjes me 1 gotë ujë të shoqëruar me 1,5 lugë gjelle me uthull hudhre. Sakaq, nëse femija juaj ka kostipacione kapsllëk të vazhdueshëm mund të veproni si kështu: Në një gotë ujë shtoni 1 lugë çaji me fara chia, 1 lugë uthull hudhre e trazojeni çdo 2-3 minuta. Pas 15 minutash jepjani fëmijës ta pijë para buke e pas 20 minutash fëmija mund të ushqehet. Ndërkohë ky produkt mund të përdoret edhe për largimin e parazitëve nga koka e duhet të veproni në këtë mënyrë: Lyeni çdo mbrëmje flokun me uthull hudhre të holluar në raportin 2 ujë edhe 1 uthull. Mbështilleni kokën për 5-6 orë e lyeni flokun. Në këtë mënyrë koka e fëmijës tuaj do të jetë e pastër nga parazitët. Po ashtu uthulla e hudhrës ndihmon ngërçet e stomakut, nxit oksigjenin në organizëm, ndihmon punën e mëlçisë dhe organeve endokrine, rrit imunitetin e organizmit dhe është shumë i preferueshëm që të merret gjatë stinës së dimrit. Ajo këshillohet të merret në masë



Vili Merja

mbi moshën 50 vjeç, sepse kontribuon në mbajtjen e vitalitetit dhe shëndetit të organizmit. Per-

sonat diabetike duhet ta përdorin patjetër këtë uthull, sepse ndihmon shumë në uljen e sheqerit në

gjak. Shumë e dobishme është uthulla e hudhrës edhe për të sëmurët që vuajnë nga astma dhe kolla. Përdorimi i saj në gjellë ka ndihmuar në mjekimin e plagëve të rënda, gjithashtu. Mjekësia moderne ka njohur shumë aftësinë që me anë të hudhrës dhe kurave që e kanë në përbërje atë; të shërojnë sëmundje të ndryshme, siç janë arterie skleroza, tensioni i lartë i gjakut dhe çrregullimet e qarkullimit të gjakut. Dobia e uthullës së hudhrës duhet të shfrytëzohet edhe në drejtim të shpërndarjes së lëkurës së kondilumave. Merrni 1 lugë lëng qepe e përziejini me 1 lugë uthull hudhre, lyeni me të puçrrat, njollat kafe ose vendoseni mbi kondilumave. Përsëriteni 2 herë në ditë e shumë shpejt do të jeni të kënaqur nga efekti i saj.



**N**ëse niveli i kaliumit në trupin tuaj është i ulët, funksionet e rëndësishme të organizmit do të ngadalësohen, puna e tyre do të çrregullohet, por do të sulmohet edhe i tërë shëndeti. Ky mineral është më i rëndësishëm për funksionimin e zemrës dhe të të gjithë muskujve në trup. Pothuajse 98 për qind e kaliumit gjendet në qeliza, që do të thotë që edhe një ndryshim i vogël i nivelit të tij mund të shkaktojë shpejt dukuri negative në muskuj, nerva dhe zemër.

**KËTO GJASHTË SIMPTOMA TËRË-  
GOJNË QË NIVELI I  
KALIUMIT NË TRUPIN  
TUAJ ËSHTË SHUMË I  
ULET:**  
**KAPSLËKU**

Niveli i ulët i kaliumit lë pasojë në funksionimin e tërë trupit, veç tjerash, edhe në metabolizëm. Mungesa e kaliumit mund të shkaktojë ngërçe në stomak dhe kapsllëk.

**FRYRJA**

Kur në trup mungon kaliumi, organizmi nuk mund të rregullojë nivelin e natriumit, gjë që shkakton fryrjen.

**NGËRÇET E KËMBËVE**

Kaliumi i takon kategorisë të elektroliteve dhe në qoftë se ne djersitemi shumë, nivelet e elektroliteve peshojnë dhe kjo mund të na japë ngërçe në këmbë. Kështu që banania vërtet ndihmon, por edhe mund të pini një pije sportive me elektrolite.

**PRESIONI I LARTË I  
GJAKUT**

Kur nivelet e kaliumit bien,



# MUNGESA E KALIUMIT, gjashtë simptoma që nuk duhet t'i injoroni

enët e gjakut shtrëngohen dhe shkaktojnë presion të lartë në gjak. Në këto raste është absolutisht shumë e nevojshme ta mbani nën kontroll ritjen e presionit të gjakut.

**RRAHJET E ZEMRËS**

Hulumtime nga "Harvard Medical School" sugjerojnë se në qoftë se nivelet e kaliumit ulen, rrahjet e zemrës mund të bëhen të parregullta. Një test fizik mund të zbulojë nëse çrregullimet e rrahjeve

të zemrës vijnë nga ndonjë mangësi në valvulat e zemrës, për shkak të tiroideve, ose nga mangësia e kaliumit në organizëm.

**LIGËSHITIA PO  
MARRAMENDJE**

Kur nivelet e kaliumit bien në trup e zemrës ngadalësohen dhe kjo gjë çon në ligështi dhe marramendje.

**KËTA PËRBËRËS, JANË TË PASUR ME KALIUM:**

1. Banania: është fruti, i cili përfaqëson kaliumin. Ajo është burimi natyror më i madh i kaliumit.
2. Frutat tropikale: avokado dhe kokosi janë dy përbërës nga të cilët krijohen parfumet ekzotikë, të cilët kanë sasi të lartë kaliumi.
3. Rrushi: Ky fryt përmban 860 mg kalium në çdo 100 gr.
4. Kajsia: Përveç kaliumit, është një burim i mirë i karrotenit, pararendës i vitaminës A.
5. Patatja: Një patate e mesme, që mund të peshojë rreth 170 gr, mund të përmbajë rreth 900 mg kalium, vlerë, e cila mund t'i jetë ulur për shkak të gatimit.
6. Kungulli: Është një përbërës shumë i mirë, por, gjithashtu, është i pasur me vitamina dhe antioksidantë.
7. Frutat e thata: Përmbajnë një sasi të madhe kaliumi, sidomos fëstëkët, të cilët nuk duhet të mungojnë kurrë në ushqimet tona pasi, gjithashtu, luftojnë edhe kolesterolin e keq.
8. Fasulet e zeza: Të pasura me kalium, por edhe me vitamina dhe kripëra minerale.
9. Thjerrëzat: Përveç kaliumit, thjerrëzat janë të shëndetshme, edhe për faktin se kanë përmbajtje të lartë hekuri.

**Pra, është e rëndësishme që t'i konsumojmë sa më shpesh këto produkte, në mënyrë që të jemi sa më të shëndetshëm.**



# Këshilla



## Ja 10 efektet e mrekullueshme të ujit me limon

**L**imoni përmban vitaminën C, një antioksidant, i cili mbron qelizat kundër efekteve të radikaleve të lira. Këto të fundit janë molekula që prodhohen kur trupi shpërbën ushqimet, ose kur ka ekspozime ndaj ambientit si ndaj duhanit, tymrave dhe rrezatimit. Vitamina C është e rëndësishme për lëkurën, kockat dhe indet lidhëse e madje përshpejton shërimin dhe ndihmon trupin të përthithë hekurin. Atë mund ta gjeni në fruta dhe perime e një burim i mirë janë specat e kuq jo djegës, specat jeshil, qitrot, agrumet, brokoli dhe perimet me gjethë jeshile.

Disa njerëz mund të kenë nevojë për vitaminë C ekstra, si gratë shtatzëna dhe ato që ushqejnë fëmijët me qumësht gjiri, njerëzit që pinë duhan, njerëzit që dalin nga një operacion etj. Limoni është një nga frutat më të rëndësishme pasi mbron nga shumë tipe sëmundjesh dhe përmban bioflavonoid, pektinë, acid folik, vitaminë C, A, B1, B6, kalium, magnez dhe fosfor. Kjo frutë e

shkëlqyer ka efekte shumë të mëdha për zorrët, stomakun, sistemin imunitar dhe për shëndetin kardiovaskular. Nëse konsumoni limona rregullisht, mund të parandaloni sëmundje si laringit, bronkit, grip, artrit, tensionin i lartë i gjakut, infeksione bakteriale dhe gurët në veshka. Sipas kërkimeve të fundit, limoni mund të parandalojë kancerin. Shumë njerëz e përdorin ujin me limon edhe si një zëvendësues të kafesë, ndaj, nëse po përpiqesh t'i largohesh sadopak kafeinës, uji i ngrohtë me limon mund të të ndihmojë në këtë proces. Më poshtë do të lexoni 10 arsye se pse duhet të pini rregullisht ujë me limon përgjatë ditës:



- 1-Reduktohet risku për infarkt në zemër.
- 2-Pastron lëkurën dhe redukton shenjat e plakjes, duke përfshirë edhe eliminimin e rruzhave.
- 3-Përmirëson humorin dhe ekuilibron emocionet.
- 4-Përmirëson shenjat e inflamacionit dhe vepron si një reduktues i dhimbjes së lehtë.
- 5-Lehtëson infeksionet e traktit urinar.
- 6-Parandalon dehidratimin dhe lodhjen e veshkave.
- 7-Parandalon lodhjen e trurit në punë, apo në shkollë.
- 8-Forcon sistemin tuaj imun.
- 9-Pastron organet e brendshme dhe i ndihmon ato të funksionojnë në mënyrë optimale.
- 10-Nxit funksionimin normal të aparatit tretës.



## Forconi zemrën duke konsumuar këto ushqime

**N**ëse keni për qëllim ta keni një zemër të shëndetshme, atëherë keni parasysh se ekziston një numër i madh i ushqimeve të cilat mund t'ju ndihmojnë që në mënyrë natyrale t'i zhbllokoni arteriet, ta ulni shtypjen e gjakut dhe ta zvogëlioni inflamacionin. Shumica prej këtyre ushqimeve të mëposhtme përmbajnë yndyra të shëndetshme, antioksidues dhe përbërës tjerë që nuk janë të mirë vetëm për zemrën, por edhe për lëkurën, flokët dhe prodhimin e hormoneve.

### ASPARAGUSI

Asparagusi është një nga perimet më të mira për pastrimin e arterieve, ndërsa është i mbushur me fibra, minerale, vitaminë K, B1, B2, C dhe E. Asparagusi ndihmon edhe në uljen e shtypjes së gjakut dhe parandalon trashjen e gjakut që mund të shkaktojë probleme serioze kardiovaskulare.

### AVOKADO

Herën e ardhshme kur përgatitni sallatë apo sandviç, konsideroni t'i shtoni edhe disa rriska avokado. Studimet kanë treguar se konsumimi ditor i avokados rezulton në kolesterolin të përmirësuar me zvogëlim të triglicerideve dhe LDL-s për rreth 22% dhe 11% rritje në HDL (që ndryshe njihet si kolesterol i 'mirë').

### BROKOLI

Brokoli është perime tjetër e mbushur me vitaminë K e cila ndihmon në parandalimin e gëlqerëzimit apo forcimit të arterieve.

### FARAT 'CHIA'

Kur përfshihen në ushqim, farat Chia të mbushura me fibra dhe acid alfa-linolenik mund të ndihmojnë në pastrimin e arterieve duke e rregulluar shtypjen e gjakut, duke e zvogëluar kolesterolin e keq, duke i zvogëluar trigliceridet dhe duke e rritur kolesterolin e mirë.

Përveç këtyre ushqimeve, edhe kanella, vaji i kokosit dhe kafja janë të mahnitshme për një zemër të shëndetshme.



# Europa ime: Boll glorifikimit të fashistëve!

Rikthimi politikave të së shkuarës rrezikon të ardhmen

Krsto Lazarevic

Europa ka nevojë për një kulturë të përbashkët kujtesë dhe ajo mund të jetë vetëm antifashiste. Kjo e përjashton të menduarin pozitiv për bashkëpunëtorët e nazistëve në Kroaci, Hungari dhe Letoni, mendon Krsto Lazarevic. Përsëritet hitlerianë, tatuazhe me kryq të thyer dhe simbole fashiste të ustahëve të lidhur me nazistët. Veç kësaj përsëritet "Za dom Spremi" (Për atdheun gati), korresponduesja kroate për "Sieg Heil" - të gjitha këto u zhvilluan të shtunën (12.05) e kaluar, kur 10.000 vetë përkujtuuan bashkëpunëtorët e nazistëve ustahët në Bleiburg të Kärnteni-t. Behet fjalë për majin e vitit 1945, kur ushtria kroate e lidhur me nazistët mori aratinë nga ish-Jugosllavia për në Kärnten, në zonën britanike të pushtimit. Por bashkëpunëtorët e nazistëve, ustahët, britanikët ua dorëzuan atëherë partizanëve jugosllavë, gjë që bëri që mbi 45.000 vetë të vriten nga partizanët e Titos. Në një kohë kur pjesëmarrësit flasin për një "aktivitet përkujtimor", kritikët e quajnë "takimin më të madh fashist të Europës". E gjitha organizohet nga Konferenca Kroate e Ipeshkëve, durohët nga dioqea austriake Gurk. Anëtarë të rangut të lartë të qeverisë kroate janë të pranishëm në aktivitet. Zyrtarisht bëhet fjalë për një aktivitet kishtar. Kancelari austriak Sebastian Kurz reagon për këtë temë në njësoj si reagon kur i drejtohen në mënyrë kritike për koalicionin e tij me FPÖ-në ekstremiste të djathtë: ai përpigjet t'i shmanget temës ose jep përgjigje asgjëthënëse. Hipokrizia del në pah në rrethanën që së fundi u ndërhy në mënyrë energjike kundër



mbledhjeve politike të nacionalistëve turq dhe të ekstremistëve të djathtë në Austri. Por kur mbi 10.000 kryesisht katolikë kroatë krenotojnë një festë të madhe fashiste, atëherë nuk mund të bësh gjë.

## KËSHILLI I EUROPËS ËSHTË I ALARMUAR

Këshilli i Evropës u shpreh i alarmuar për rikthimin në shtet normal të fashizmit në Kroaci, pas orgjisë së fundit të ustahëve në Bleiburg. Kjo tendencë përforcohet edhe përmes një "glorifikimi" të regjimit të ustahëve fashistë, thuhet në një raport të botuar të Komisionit antiracizëm të Këshillit të Europës për gjendjen në Kroaci. Hartuesit e raportit kërkuan nga qeveria e Zagrebit që të

veprojë në mënyrë më energjike kundër tiradave të urrejtjes si dhe sulmeve me motive raciste ndaj minoriteteve. Është e diskutueshme nëse partia në pushtet HDZ do ta marrë seriozisht raportin. Shumë shpesh ajo tërheq vëmendjen që ushqen vetë urrejtjen kundër minoriteteve në Kroaci, veçanërisht kundër serbëve dhe romëve, këto grupe, të cilat u asgjësuan në mënyrë sistematike nën "Shtetin e Pavarur Kroaci" të krijuar nga Hitleri. Komunitetet hebreje të Kroacisë ka vite që i bojkotojnë ceremonitë shtetërore përkujtimore për çlirimin e kampit të asgjësimit Jasenovac. Ata nuk duan që të përkujtojnë së bashku me politikanë, të cilët u referohen në

mënyrë pozitive vrasësve të hebrenjve të regjimit të ustahëve. A mund ta përfytyroni që Angela Merkel të shkojë në Argentinë dhe të tregojë atje përpara minoriteteve gjermane se është mirë që pas Luftës së Dytë Botërore gjermanët gjetën strehim në atë vend? Vrasësit masivë si Adolf Eichmann-i dhe Josef Mengele? Me siguri që jo. Presidentja kroate Kolinda Grabar-Kitarovic e bëri një gjë të tillë. Në një vizitë në Argentinë ajo vlerësoi ata kroatë që arritën pas Luftës së Dytë Botërore të arratisen nga partizanët e Titos në Argentinë. Që këtu bëhet fjalë për komandantë kampesh përgjendrimi, vrasës masivë dhe bashkëpunëtorë të nazistëve, këtë ajo nuk e përmendi.

## KROACIA NUK ËSHTË RAST I VEÇUAR

Shkrimtari Danilo Kis shkroi për nacionalizmin se ai është një "paranojë", një përfytyrim delirant i shoqëruar njëkohësisht nga humbje e individualitetit dhe e sensit të realitetit. Kjo paranojë bazohet në idenë, që kombi yt është diçka e pastër dhe e pafajshme dhe të gjithë ata që i lejojnë vetes të bëjnë kritika janë armiq me motive të ulëta. Prandaj, në përfytyrimin historik të të djathtëve kroatë ustahët duhet të jenë të mirët, sepse që të pranosh se ata kanë vrarë me qindra mijë njerëz të pafajshëm, kjo do ta njoloste për përfytyrimin e kombit vetjak. Si rrjedhojë pjesëmarrësit e ceremonisë në Bleiburg ndihen si viktima, megjithëse janë ata që glorifikojnë një regjim fashist. Ky është një zhvillim, i

cili ndodh edhe në vende të tjera të Europës Lindore: një përfytyrim historik, i cili është i fokusuar në rolin vetjak si viktima nën pushtimin sovjetik ose nën sundimin komunist. Njëkohësisht, bashkëpunimi vetjak me nacionalistët banalizohet, mohohet dhe në rastin më të keq, glorifikohet. Në Riga, çdo vit në 16 mars dalin në rrugë me mijëra vetë, për të përkujtuar në "marshin e pjesëmarrësve të legjioneve" pjesëtarët e ushtarëve SS. Viktor Orbani e vlerësoi bashkëpunëtorin e nazistëve Miklos Horthy si një "burrë shteti të jashtëzakonshëm", megjithëse ai është bashkëpërgjegjës për deportimin e mbi 600.000 hebrenjve në kampet gjermane të asgjësimit. Në Serbi bëhen diskutime, nëse duhet rehabilituar në pikëpamje juridike bashkëpunëtorin i nazistëve Milan Nedic. Që të zhvillohet si një i vetëm, BE ka nevojë jo vetëm për një opinion më të fortë publik evropian, por edhe një kulturë të fortë të kujtesës. Dhe ajo duhet të jetë antifashiste. Kur nuk arrin të biesh dakord as që nazistët genë të këqijtë dhe kur glorifikohen hapur bashkëpunëtorët e disa kryetarëve të shteteve dhe të qeverive, atëherë Europën e pret dëshitimi Krsto Lazarevic ka lindur në Bosnjë-Heregovinë dhe është arritur si fëmijë me familjen e tij në Gjermani. Sot ai jeton në Berlin, punon si gazetar dhe publicist dhe shkruan për medie të ndryshme gjermano-folëse.

Marrë nga Deutsche Welle

## SHKURT



"Ilindenska", Greqia e refuzon, reagon Maqedonia: Nuk ju cenon

Greqia ka refuzuar propozimin e ri të emrit të Maqedonisë, "Republika Ilindenska Makedonija". Një ditë më parë, ky variant u duk shumë pranë miratimit. Por, pasi u konsultua me presidentin e vendit dhe aktorët e tjerë politikë, Kryeministri grek Alexis Tsipras refuzoi këtë propozim. Kryeministri përsëriti përpjekjet e Maqedonisë për gjetjen e një zgjidhje, por edhe ky emërtim nuk është i pranueshëm. Ndërkohë, Shkupi zyrtar reagoi duke thënë se emri i ri i propozuar "Republika Ilindenska Makedonija" është një emër me përcaktim kohor dhe është mundësi reale për kompromis duke kënaqur të dyja palët. Qeveria e Maqedonisë thotë se shpreson ende që ky propozim të rikonsiderohet dhe të pranohet nga Athina zyrtare. "Kryengritja e Ilindenit është luftë e përbashkët e popullit tonë multietnik për të drejtat dhe liritë sociale. Dhe nuk ka aspirata territoriale ndaj asnjë vendi fqinj, duke përfshirë edhe Greqinë. Kjo është lufta e vitit 1903 dhe 1944", thuhet në njoftimin e qeverisë maqedonase.

## Zyrtari gjerman: Serbia e di se Kosovën e ka kusht për anëtarësim në BE

"Anëtarësimi i Serbisë në Bashkimin Europian nuk është i mundur pa normalizim emarrëdhënies me Kosovën. Megjithatë, kjo nuk është e vetmja sfidë që përballë Serbia. Të paktën po aq e rëndësishme është tema e reformave në sundimin e ligjit", tha kryetari i Komisionit për Çështje Evropiane të Bundestagut gjerman, Gunther Krichbaum. Sipas tij Kosova është "problem i të gjitha problemeve", kur bëhet fjalë për integrimin evropian të Serbisë dhe se kjo është pengesa më e madhe për anëtarësimin në Bashkimin Europian. Por, Krichbaum thotë: "Ka ende shumë për t'u bërë edhe në aspektin e pavarësisë së gjyqë-

sorit, lirisë së medias dhe luftën kundër korrupsionit dhe kirit të organizuar. Deri më tani, për shembull, nuk ishte bërë ndonjë gjykim mbi korrupsionin në nivel të lartë", ka thënë ai në një intervistë. Serbia është, tha ai, në rrugë të mirë drejt BE, megjithëse tha, "negociatat mund të zgjasin për disa vite të tjera". Kur u pyetën se cila zgjidhje në dialogun ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, Krichbaum tha se kuadri negociues për bisedimet e BE-së përcaktohet qartë se "marrëdhëniet mes Serbisë dhe Kosovës duhet të normalizohet plotësisht para anëtarësimit në BE". "Është e vetmja mënyrë që të dy vendet mund të realizojnë perspektivën e tyre evropiane. Historikisht, BE-ja është mbi të

gjitha një projekt i paqes. Prandaj, ne nuk duam të importojmë konflikte të pazgjidhura dypalëshe". I pëtvur nëse "normalizimi" nënkupton nënvojhjen e pavarësisë dhe nëse ndarja e Kosovës ishte e pranueshme për Berlinin, Krichbaum tha: "Normalizim, normalizim nuk do të thotë pak", tha ai, duke shtuar se Gjermania do të mbështet të dyja vendet. Ai vuri në dukje se marrëdhëniet "në mes Serbisë dhe Kosovës janë duke u përmirësuar në masë të madhe", por thotë negociatat duhet të vazhdojnë pasi "është larg nga ajo që quhet fqinjësi e mirë". Ai tha, gjithashtu, se BE-ja është partneri i vetëm në Ballkanin Perëndimor që merr parasysh stabilitetin rajonal dhe prosperitetin e njerëzve në këtë rajon.

## Greqi, grushte dhe shqelma bashkiakut të Selanikut

Ditën e djeshme bashkiaku i Selanikut është sulmur nga disa njerëz, me shumë gjasa të ekstremistë të djathtë, gjatë një eventit publik. Yiannis Boutaris, 75 vjeç, që po merrte pjesë në një përkujtimore në kujtim të masakrës së Grekëve në Detin e Zi, në Turqi, gjatë Luftës së Parë Botërore. "Me goditjen nga të gjitha anët, me grushte, shqelma me çtë mundnin", ka thënë ai. Ishte një sulm i tmerrshëm, po fatmirësisht jam mirë". Zyra e kryeministrit Alexis Tsipras theksoi se bëhej fjalë për persona të ekstremistë të djathtë, por pa i specifikuar mirë. Politikani kundër rrymës Boutaris



gjithmonë ka krijuar polemika me deklaratat kontroverze për tema "të ndjeshme", si Maqedonia, Turqia, Izraeli. Ai për shembull e ka quajtur Qemal Atatürk, babain e Turqisë moderne, të urryer nga shumë grekë, një burrë të madh politik.

## ANALIZA

Ndër kundërshtarët më të paepur duket se qenë anashkaluesit shqiptarë të Kursit, që e shpallën “gjuhësinë shqiptare – shkencë të partishme”

# LEDI SHAMKU: A lind me Saussure-in gjuhësia moderne?

Prej dy ditësh në Muzeun Historik Kombëtar, festa e librit ka mbledhur botues, shkrimtarë, përkthyes e studiues. Në kuadrin e Festivalit Ditënetët e Librit, gjuhëtarja Ledi Shamku Shkreli ka përgatitur një analizë mbi gjuhësinë moderne, që “GSh” e boton më poshtë.

Nga Ledi Shamku Shkreli

A i shihte problemet e shkencës me sy të kthjellët prej poeti e vizionari?... Kështu ua përshkroi Ferdinand de Saussure-in studentëve, Antoine Meillet, themeluesi i shkollës sociologjike të gjuhësisë frënge. I njëjti fill vlerësimi, besojmë, u shfaq dekada më pas edhe te Von Wartburgu, kur në një tryezë ndërkombëtare për probleme dhe metoda të gjuhësisë, organizuar nga A. Martinet në vitin 1944, u shpreh se “...pas shfaqjes së fenomenit ‘Saussure’, çdo gjuhëtar i andejmë mund ta përkrahë ose ta kundërshtojë atë, ta duartrokasë apo t’i bjerë ndesh, por kurrsesi s’mund ta shpërfillojë”. Asokohe në botë kishin marrë hov mjaft shkrimet dhe botimet, që u referoheshin teorisë të Saussure-it, duke iu përmbajtur, kundërshtuar apo duke i plotësuar ato. Me këtë ritëm u mbërrit deri në vitin 1963, kur Benveniste, duke u ndalur në rëndësinë historike që pati publikimi i “Kursit të gjuhësisë së përgjithshme”, pohoi me autoritet se “...te Saussure-i merr shkas gjuhësia e ripërtëritë e shek. XX”. “Në fund fitoi Saussure-i”. Me këtë deklaratë nisën të hapeshin mjaft traktate gjuhësore që botoheshin nëpër Europë aty nga vitet ‘60-’70.

Cili qe Ferdinand de Saussure, ky personalitet sa i përfolur, aq edhe i parryfyer, që shpesh thirrej “mësuesi genevas”? Nuk dihet shumë rreth jetës të tij. Ndaj edhe në vitin 1963, me rastin e 50-vjetorit të vdekjes, Benveniste shkroi: “Një mister pëshëjtell jetën personale të atij që shumë herët zgjodhi të strukej te heshtja”. Por sosyriani i frënge Françoise Gadet na informon se “botimi italian i *Kursit*, përkthyer dhe pajisur me shënime nga De Mauro, (f. 319-389), mbetet sot për sot burimi biografik më i plotë që disponojmë për Saussure-in”. Sidoqoftë, emri i tij gjithnjë i ka ndarë gjuhëtarët në përkrahës dhe kundërshtarë. Kështu e përkrahin strukturalistët, të cilët, duke u mbështetur pikërisht mbi *Kursin*, themeluan rrymën gjuhësore që filloi ta analizojë gjuhën si sistem. E përkrahin shumë gju-

hëtarë të disiplinave të tjera, të cilët gjejnë në teoritë e tij arsytimit bazë mbi natyrën dhe funksionimin e organizimit-gjuhë; por e përkrahin edhe ata gjuhëtarë që duke e njohur atë si themelues të gjuhësisë moderne, shtojnë sakaq se Saussure-i tashmë është i tejkaluar; kësajsoj ndodhi me Chomskyn, të cilin i vishet merita se duke iu referuar *Kursit*, i përhapit idetë e Saussure-it edhe në një vend si Shtetet e Bashkuara, ku pakkush kish dëgjuar për të.

E kundërshtojnë fanatikët e gjuhësisë historike që mendojnë se konceptet e gjenevasit e mbajtën peng për do kohë zhvillimin e gjuhësisë. E kundërshtojnë edhe ata, të cilët duan t’i kundërvënë Saussure-it të *Kursit*, Saussure-in tjetër, atë të anagramave, që sipas tyre, më fort se me gjuhën, merrej me “lojërat” gjuhësore të poetikës (duke iu referuar 140 fletoreve, në të cilat ai pat shënuar anagrama të tëra që kish zbuluar e ku sipas tij qëndronte thelbi simbolik i poezisë latine saturniane). Megjithatë, ndër kundërshtarët më të paepur duket se qenë anashkaluesit shqiptarë të *Kursit*, të cilët shpallën qysh në krye të punës, “gjuhësinë shqiptare – shkencë të partishme”. Jo pa qëllim, studentëve u çelëshin seminarët e Hyrjes në Gjuhësi me “Marksizmi dhe çështje të gjuhësisë”. Aty imponohej bindja se “metoda historike krahasuese është më e mirë se analiza formaliste e katër elementeve të N. J. Marr-it (të cilat në fakt s’ishin veçse elementet e përcaktuara nga Saussure), sepse e para të shtyn të punosh, kurse e dyta të shtyn vetëm të shtiesh fall në filxhan rreth misterit të të famshmeve katër elemente”. Përfundimisht kështu kategorikisht postulatit nistor i Saussure-it se “gjuha është formë, jo substancë”, në këtë mënyrë përjashtohej *en bloc* jo vetëm *Kursi*, por i tërë korpusi sosyriar.

Duke lënë mënjanë këta anashkalues, mund të thuhet se në botën shkencore, të gjitha kundërshtitë teorike, pos vullbullës së madhe të debateve që i ka shoqëruar, provojnë se *Kursi i gjuhësisë së përgjithshme* vijon të ushqejë dilemën:

A lind me Saussure-in gjuhësia moderne? Për ta kuptuar më mirë faktin se *Kursi i Saussure-it* ndërroi kursin e studimeve mbi gjuhën, lypet shtyrë përtej shfaqjes së dukurisë “Saussure” në gjuhësinë ndërkombëtare, për faktin se më parë çështjet e filozofisë së ligjëritimit nuk qenë ndarë ende nga çështjet mirëfilli gjuhësore. Shekulli që u përvijua mes sundimit napoleonik dhe Luftës së Parë Botërore, qe periudhë shumë e rëndësishme për zhvillimin e shkencave në përgjithësi e të gjuhësisë në veçanti. Për gjuhësinë mund të thuhet se kjo epokë zhvillimi u çel me danezin Rask dhe gjermanin Bopp. Periudhës pararendëse të këtij shekulli, pra periudhës nga Mesjeta në Klasicizëm, nuk i pati interesuar asfarë zhvillimi historik i gjuhës, d.m.th. nuk i interesonte “si” shndërrohej ligjërimi, por “çfarë” ish ai në vetvete. Sikundër thotë Saussure “interesi historik për gjuhët zuri fill kur u zbulua se ato mund të krahasoheshin me

*“Pavarësisht kontradiktave, vepra vijon të mbetet një përftesë gjenele”*



Ledi Shamku

tyre. Kjo shënoi lindjen e filologjisë krahasuese apo ndryshe të “gramatikës së krahasuar”. Më 1816-n, në një studim të titulluar “Sistemi zgjedhimor i sanskritishtes”, Franz Boppi shqyrtoi lidhjet e sanskritishtes me gjuhët gjermanike, greqishtes, latinishtes etj”. Në fakt, gjuhësia e shek. XIX, me orientimin e saj fund e krye historik, nuk u njohu pararendësve vendin që meritonin në shkencat filologjike dhe ky qe vërtet paradoks, sepse nuk mund të mohohet kontributi i studiuesve si Platoni, Shën Agustini, apo Thoma d’Akuini e më tej Leibnizi, Komeniusi apo shkolla e Port-Royalit. Tash pranohet se përshkrimet apo konkluzionet teorike të skolastikëve dhe racionalistëve janë të epërme ndaj atyre të gjuhësisë historike. Vetë Saussure iu pat referuar Platonit lidhur me arbitraritetin e shenjes, ashtu si dhe Chomskyt më pas u pat mbështetur te Dekarti për të themeluar teorisë e gjenerativizmit gjuhësor. Si përfundim, gjuhësia historike hulumton cila është zanifila e një elementi të dhënë dhe si ka qenë ai në etapën pararendëse. Por problemi mund të shtrohet edhe ndryshe: Çfarë roli luan ky ele-

ment në rrjedhë të ligjëritimit? Si sillet ai në shoqërimet gjuhësore? Ç’vend zë ky element praktikisht në një gjuhë të dhënë e teorikisht në sistemin e përgjithshëm-gjuhë? Këto ndërpyetje të reja që kishin filluar të ngacmonin vëmendjen e studiuesve, nxorën në pamjaftueshmërinë e të ashtuquajturave metoda diakronike, historike apo etimologjike, ose sikundër shprehet Saussure: “kjo shkollë (...) nuk mbërriti dot të themelojë shkencën e vërtetë të gjuhësisë. Ajo s’e çoi kurrë ndër mend të shqyrtonte natyrën e objektit të studimeve të saj. Kësajsoj, pa hedhur këtë hap fillestar, një shkencë e ka të pamundur të përvijojë një metodë të sajën”. Ky ngërc metodologjik mund të zgjidhej duke i pranëvënë gjuhësisë historiko-krahasuese një tjetër gjuhësi, atë sinkronike-përshkruese. Në fakt ky gërshtim metodash u përfutua si zgjidhje vetëm pasi e ofroi Ferdinand de Saussure; e madje, sikundër u ndodh gjithnjë revolucionarëve të mendimit, domosdoshmëria e përfutimit të kësaj zgjidhjeje nisi të ndihej veç një a dy dekada pas tij.

Jakobson-i thotë se “vlerësohen si kryevepra dy lloj kontributësh shkencore:

ment në rrjedhë të ligjëritimit? Si sillet ai në shoqërimet gjuhësore? Ç’vend zë ky element praktikisht në një gjuhë të dhënë e teorikisht në sistemin e përgjithshëm-gjuhë? Këto ndërpyetje të reja që kishin filluar të ngacmonin vëmendjen e studiuesve, nxorën në pamjaftueshmërinë e të ashtuquajturave metoda diakronike, historike apo etimologjike, ose sikundër shprehet Saussure: “kjo shkollë (...) nuk mbërriti dot të themelojë shkencën e vërtetë të gjuhësisë. Ajo s’e çoi kurrë ndër mend të shqyrtonte natyrën e objektit të studimeve të saj. Kësajsoj, pa hedhur këtë hap fillestar, një shkencë e ka të pamundur të përvijojë një metodë të sajën”. Ky ngërc metodologjik mund të zgjidhej duke i pranëvënë gjuhësisë historiko-krahasuese një tjetër gjuhësi, atë sinkronike-përshkruese. Në fakt ky gërshtim metodash u përfutua si zgjidhje vetëm pasi e ofroi Ferdinand de Saussure; e madje, sikundër u ndodh gjithnjë revolucionarëve të mendimit, domosdoshmëria e përfutimit të kësaj zgjidhjeje nisi të ndihej veç një a dy dekada pas tij.

Jakobson-i thotë se “vlerësohen si kryevepra dy lloj kontributësh shkencore:

ment në rrjedhë të ligjëritimit? Si sillet ai në shoqërimet gjuhësore? Ç’vend zë ky element praktikisht në një gjuhë të dhënë e teorikisht në sistemin e përgjithshëm-gjuhë? Këto ndërpyetje të reja që kishin filluar të ngacmonin vëmendjen e studiuesve, nxorën në pamjaftueshmërinë e të ashtuquajturave metoda diakronike, historike apo etimologjike, ose sikundër shprehet Saussure: “kjo shkollë (...) nuk mbërriti dot të themelojë shkencën e vërtetë të gjuhësisë. Ajo s’e çoi kurrë ndër mend të shqyrtonte natyrën e objektit të studimeve të saj. Kësajsoj, pa hedhur këtë hap fillestar, një shkencë e ka të pamundur të përvijojë një metodë të sajën”. Ky ngërc metodologjik mund të zgjidhej duke i pranëvënë gjuhësisë historiko-krahasuese një tjetër gjuhësi, atë sinkronike-përshkruese. Në fakt ky gërshtim metodash u përfutua si zgjidhje vetëm pasi e ofroi Ferdinand de Saussure; e madje, sikundër u ndodh gjithnjë revolucionarëve të mendimit, domosdoshmëria e përfutimit të kësaj zgjidhjeje nisi të ndihej veç një a dy dekada pas tij.

Ato të tipit epilog që, pasi kanë bërë bilancin e hulumtimeve në atë fushë, të rezultateve të arritura, e kurorëzojnë këtë veprimtari me një doktrinë të mirëfilltë dhe ato të tipit prolog, që nuk paraqesin një ndërtesë të përfunduar por fillesat e një ndërtesë të re dhe përparimtare”. “Kursi i gjuhësisë së përgjithshme” i përket tipit të dytë, pasi ai nuk përmban përfundime të nxjerra nga vepra e plotë e autorit dhe e bashkëkohësve të tij. Jo, ai ngrihet i gjithi mbi kurajën dhe përpjekjet e një individi që u mundua të rishikojë e të tjektojë trashëgiminë e shkollës nga e cila ai vetë qe formuar, madje edhe trashëgiminë vetjake kërkimore e shkencore, duke synuar rezultatet të reja. Sërisht Jakobson-i: “ndryshe nga manualët, të cilat përmbledhin rezultatet e përfutara sakaq nga shkencën, Saussure-i nuk u ndal mbi cka qe bërë, por mbi cka duhej bërë”. Ndaj edhe kreu hyrës i *Kursit* të tij mbyllet me fjalët domethënëse: “Ende sot problemet themelore të gjuhësisë së përgjithshme janë duke pritur zgjidhje. Gjithsesi, i duhet mësuar sqarimit se *Kursi* nuk përmban dogma përfundimtare, por hipoteza për punë të mëtejshme, si dhe skica paraprake aq të domosdoshme për zhvillimet e ardhshme të gjuhësisë. Vepra e tij meqë ka lindur mes dy epokash, qëndron në zgrip mes dy këndvështrimesh të ndryshme. Është normale që një veprë e tillë, aq më tepër revolucionarizuese, të mos mund u shmangët kontradiktave në vetvete, madje do të qe e pasaktë nëse *Kursi* merret si një doktrinë e përfunduar.

Pavarësisht kontradiktave, vepra vijon të mbetet një përftesë gjenele, tek e cila jo vetëm idetë e vlerata e të sprovuara tashmë prej më se një shekulli, por dhe pasaktësitë apo kundërshtitë, po bëhen shkas i vazhduar për hulumtime të reja! Dhe në fakt, zhvillimet e sotme gjuhësore dëftojnë sërish për një rikthim të Saussure-i. Pas një periudhë heshtjeje, gjatë së cilës strukturalizmi shpërtheu me energji biblike duke ushtruar lindjen e shumë disiplinave shkencore si: semiotika, semantika, sociolinguistika, etnolinguistika – e madje edhe rrymave që iu shmangën atij, si gramatika gjenerative-transformuese – tash me një trajektore ciklike gjuhësia bashkëkohore po i kthehet sërish “atit” të vet. Përmendim këtu tituj dhe data të disa prej traktateve dhe eseve gjuhësore, që bëhen pasqyri e kahut të sotëm shkencor: Më 1994 J. C. Milner botoi *Retour à Saussure*; më 1997 J. C. Chevalier botoi në periodikun “Quinzaine Littéraire” esenë me titull *De nouveau Saussure*; në qershor

RREFIMI

# Kim Mehmeti mes Dritëroit e Anton Pashkut

2001 në Archamps të Gjenezës u mbajt Kongresi Ndërkombëtar "Saussure après un siècle"; dhe vetëm pak kohë më parë Christian Steter organizoi në Zyrih bashkëbisedimin me temë Am Ende des Chomsky – Paradigmas: zuruck zu Saussure? Ja pra, sikundër dëshmojnë renditje të tilla, jemi përsëri te Saussure-i. Nga sa duket, në shek. XX gjuhësisë i takoi të shndërrohej në distilëri të teorive sosyriane; por edhe në këtë shekull ajo po dëfton të njëjtat gjasa. Është bërë zakon që sa herë përftohet një "produkt" i ri nga kjo distilëri, të thuhet se Saussure-i u tejkalua. Edhe një herë sillet në kujtesë vlerësimi i Jakobson-it për *Kursin*: "kjo vepër nuk paraqet një ndërtesë të përfunduar, por fillesat e një ndërtesë të re dhe përparimtare". Vërtet disa nga përgjithësimet e tij tashmë mund të jenë të tejkaluara, por kuptimi "i tejkaluar" përdoret nga ihtarët ose kundërshtarët e Saussure-it ashtu si kati i parë i një ndërtesë tejkalon themelet dhe kati i dytë... e kështu me radhë. Sa më tepër kate hiqhen (tejkallime), aq më i fortë rezultojnë themelet mbi të cilin ato mbështeten. Një themel i dobët nuk do të kish gjeneruar atë harlisje disiplinash shkencore mbi të cilat gjuhësia bashkëkohore vijon rrugëtimin e saj.

Gjithë ky tharm i veprimtarisë shkencore në Europë edhe mund ta ngjizë në Shqipëri metodën sinkronike-përshkruese. Mungesa e gjatë e kësaj metode, e lidhur pashmangërisht me inercinë e kotë anashkaluese ndaj Saussure-it, ka krijuar një hendek të madh mes gjuhësisë sonë dhe asaj bashkëkohore europiane. Ky hendek paraqitet më i thellë veçanërisht në trajtimin e tri elementeve bazë:

1. Prurjet e shoqërisë në gjuhë;
  2. Veprimi i gjuhës në shoqëri;
  3. Roli i vërtetë të gjuhëtarit.
- Për pasojë, debati gjuhësor bashkëkohor zëvendësohet e rizëvendësohet me bollëkun e studimeve historike – të domosdoshme edhe këto – por duke iu shmangur problematikave të vërteta. Në fakt këto problematika, të shtrura për zgjidhje, i kërkojnë ato jashtë situatave empirike subjektive, pra jashtë gjuhësisë laboratorike. Për të ardhur në zgjidhjet objektive, duhen aplikuar në gjuhësinë shqiptare të gjitha ato disiplina moderne që "kanë si objekt të vërtetë dhe të vetëm gjuhën, të shqyrtuar në vetvete dhe për vetvete". Por këto disiplina nuk kanë si mëkëmben pa u përfutur më parë – shtyja e tyre zanafillore – Saussure me *Kursin* e tij. Së këndejmi pyetja: A bën pjesë gjuhësia shqiptare në gjuhësinë bashkëkohore europiane?

Fatmira Nikolli

Një prej imazheve që shpërndan Elona Agolli, e bija e shkrimtarit që na la vitin e shkuar, shkruan: "Me të madhin shkrimtar Kim Mehmeti, në stendën Dritëro në festivalin 'Ditënetët e librit'. E lumtur dhe e rrethuar nga miq të Dritëroit që askurrëherë nuk kursejnë lëvdata e kujtime që i ndajnë me mua. Ashtu si edhe i bukuri ati im, nuk kursente përgëzime e inkurajime për shkrimtarë e krijues mbarëshqiptarë".

Nis nga ky imazh, një kthim pas në kohë, për të mësuar për një miqsi të hershme që zuri fill nga talenti.

Kur në vitet 1990, Dritëroi Agolli u pyet për tregimin shqiptar të atyre viteve, e përmes tij për letërsinë e kohës, mes emrave që përmendte, ishte Kim Mehmeti. "Tendencat më e ndjeshme e tregimit të botuar në kohën e sotme veçanërisht e të rinjve si Ridvan Dibra, Lazër Stani, Andi Bejtija dhe Kim Mehmeti është prezenca e esesë apo e gjykimit filozofik mbi faktin artistik dhe shpënia apo shtyrja e rrëfimit drejt lakonizmit, drejt shtrëdhjes së portokallit të ngjarjes për të marrë lëngun. Tendencë bashkëkohore dhe moderne. Doemos që tregim pa rrëfim nuk ka, as tregim pa bërthamën e çudirave të përrallës nuk ka", thoshte Dritëroi. Shtonte se puna është tek raportit sa më i përsosur i rrëfimit me gjykimin dhe sintezën. "Ndonjëherë si protestë ndaj status quo-së së tregimit, të rinjtë e prishin fare rrëfimin dhe e kthejnë atë në një ese apo në një traktat filozofik apo poezi. Por kjo kapërçehet. Kështu është me të rinjtë. Ndërsa të vjetrit, apo relativisht të vjetrit, ende janë të hutuar nga autocensura. Kjo autocensurë tani tek të vjetrit nuk është ideologjike, por është artistike. Ata janë mësuar të tregojnë dhe të moralizojnë. Është më e tmerrshme autocensurë! U tremben konflikteve të forta, i tremben pasqyrimin të tragjizmit të jetës, i tremben eksperimentit artistik, druhen për të imituar të

Një kujtim i viteve 1990 dhe rrëfimi për të riun tregimtar



Elona Agolli dhe Kim Mehmeti

rinjtë. Tregimtarët e moshuar po nuk imituan të rinjtë, ta dini se kanë mbaruar qind për qind", shprehej shkrimtari i njohur.

Pothuaj 20 vjet më pas, Kim Mehmeti është një emër i njohur. Ka penën e tij, stilin e tij, ka një sërë veprash, është i angazhuar në çështjet shqiptare, ngre zërin për bashkëkombësit në Maqedoni, ka njohur nga afër Dritëroin dhe ka ndërjet madje humbjen e ndarjen me të përgjithshëm.

Është maj dhe në Muzeun Historik Kombëtar mbahet festivali "Ditënetët e librit" që organizohet nga e bija, Elona Agolli. Kim Mehmeti është mes të ftuarëve dhe nuk ngurron të ndalet në kujtime e në rolin e letërsisë, sikundër edhe në pran-

inë e shkrimtarit e rolin e tij në kohë të ndryshme.

"Na këndonin nënat të bëheshim më të bukurit e botës. Sot të jesh shkrimtar do të thotë të jesh i mallkuar. Unë mendoj se na kanë sot diçka e rrezikshme, se disa pjesë të kulturës që japin anën e bukur të shqiptarisë po na zhduken. Dikur çështja e statusit tënd zgjidhej, sot jo, sepse është e vështirë. Libri nuk matet me faqe. Libri është ai që lexon lexuesi e jo ai që shkruan shkrimtari", -tha Kimi.

Ai shtoi se jetojmë në kohëra të vështira për librin e për shqiptarët.

"Ne na i lexojnë librat ata që ne ua dhurojmë. Por nuk duhet të ankohe mi. Të gjallëshin 'nuk kemi lexues' e kanë nxjerrë shkrimtarët e



Kim Mehmeti

dobët. Në mos asnjë, vepra e ka i lexues të garantuar: vetja jote, e mandej ta lexon gruaje dhe familja".

Kim Mehmeti në takimet letrare të mbajtura në kuadër të Festivalit "Ditënetët e librit", kujtoi se shkrimtari është dyshues në veprën që bën. "Duhet të kesh forcën e të thuasht edhe që nuk vlej të botohen. Unë i kam thënë vetes shkrimtar, vetëm pasi kam takuar Anton Pashkun. Dhe e dini si? Shkova ta takoja në Prishtinë. E kur takimi mbaroi, dolëm nga apartamenti i tij. Ai priste me mua në këmbë që të vinte ashensori. Më erdhi zor, dhe i thashë: ju lutem, kthehuni brenda e mos prisni në këmbë. "Të kam pritur 20 vjet", më tha. Më dha zemër e unë kam shkruar në Shkup si me ra-

ketë atëherë", -kujtoi Mehmeti.

Festivali "Ditënetët e librit", përgjatë pesë ditëve ka mbledhur se bashku 40 botues nga Shqipëria dhe Kosova. Përjetë formës së panairit ai u bë një pikëtakim autorësh e lexuesish shoqëruar me aktivitetet të disallojshme deri në mbrëmje vonë.

Gjatë festivalit, autorja e librit "E vërteta për Nolin", Entela Komnino është vlerësuar me çmimin e mirënjohjes "Dritëro. Vlerësimi për Komninin u dha pas shumë vitesh hulumtues për një emër të madh shqiptar si Fan Noli. Vlerësimi shokoi me motivacionin "Për veprën publicistike dhe punën e rrallë hulumtuese në përcjelljen me mjeshtri të fakteve historike".

## Poezitë e Agollit përmes ilustrimesh



Në kuadër të festivalit të "Ditënetët e librit" është mbajtur një kobkurs i veçantë. Studentët e Universitetit të Arteve kanë marrë në duar poezitë e Dritëroi Agollit për të realizuar mbi to ilustrime që u shkojnë për shtat. Të dielën, dekani Ardiyan Isufi tha se për të sjellë një risi brenda aktiviteteve, është bërë një konkurs i veçantë. "Ne si fakultet kemi zhvilluar një aktivitet që ka të bëjë me ne artin pamor. Sigurisht, elementi që na bashkon në formë simbolike me librin ka qenë letra".

Ardian Isufi foli për pergamenën e letërën si shenjë të kulturës. "Ky konkurs modest që në një atë ardhme po e men-

dojmë të jetë më i madh. Ateheri i grafikës mund të ilustronjë poezitë e Dritëroi Agollit në një libër që do të jetë unik dhe kjo ndoshta do të shërbejë studentëve që të përcillet kapaciteti e talenti i tyre. Pedagogu që e udhëhoqi konkursin është David Kryemadhi. Ai dhe studentët kanë shumë

përkushtim edhe pse në pak kohë. Janë ide artistike, shumë të mira që komisioni që ka në përbërje edhe profesor Gazmend Lekën, u ka bërë një analizë të detajuar. Një prej katër ekspozitave që janë përfshirë në pavjionin tonë, është ekspozita e David Kryemadhi. Ai dhe studentët kanë shumë

sit, me çmim të parë u vlerësua Enxhi Kanina nga programi i studimit grafike master dhe me çmim të dytë u vlerësua Kristi Tasho nga programi i studimit grafike. Kur fjalën e mori Elona Agolli mes emocioneve tha se ka qenë për të shumë i rëndësishëm këndvështrimi i studentëve për poezitë.

"Përgëzoi gjithë studentët, që përgjodhën poezitë e Dritëroit për të përshfaqur talentin e tyre. Uroj t'ia kenë dalë mbanë e të jenë kënaqur me punimet e tija. Jam fatlumë që jam vajza e tij". Elona Agolli, vajza e shkrimtarit është edhe organizatore e festivalit "Ditënetët e librit".

Opinion *i* Ditës

# Punë politikanësh

Nga Julian Zyla

(vijon nga faqja 1)

... nga këngëtarët do të bëhen më të famshëm. Por, për sa kohë do të na mbeten në mendje? Vetëm për kohën që ato do të transmetohen. Ato ikin nga TV dhe radiot tona, ne i heqim nga mendja. Ditët do të kalojnë dhe ne do t'i harrojmë e do të vazhdojmë me jetën tonë. Do të kujtohem se kënga jonë e preferuar është një këngë e disa dekadave më parë, e cila nuk fliste për veten, miqtë apo armiqët e saj, por, për ne. Ajo na njihte, madje na njohu me gjëra që as vetë nuk i kishim menduar.

Po debatit politik i kohëve të fundit në Shqipëri, çfarë përmban, hite apo këngë të preferuara? Ritme të nxehta punësh politikanësh na shoqërojnë në TV dhe radio. Ndonjëherë u mësojmë dhe fjalët. Po ato, a na njohin? A do të jenë kënga jonë e preferuar? A do të jenë këngët që ne do të votonim?

Partia Demokratike ka bërë një punë të mirë duke ngritur zërin për standarde morale. Një tematikë e tillë, e transmetuar në vazhdimësi me volumin deri në fund dhe e kërcyer në sallat më të njohura të emisioneve, krijon përshtypjen se është bërë temë e rëndësishme për shqiptarët. Strofa të përpunuara me kujdes servirin informacione nga më të detajuarat. Shqiptarët ende po presin të mësojnë parfumin që përdor vëllai i Fatmir Xhafajt. (Të gjithë hamendësojnë aromë bimore.) Por, me gjithë statusin prej hiti që ka marrë, kjo është një punë që nuk mund të garantojë vota apo Hollin e Famës për partinë autore.

Çështja e Fatmir Xhafajt nuk është as tema më e rëndësishme e as temë e rëndësishme për shqiptarët. Politika mund të imponojë hite. Por mund të krijojë këngë të preferuara vetëm nëse njeh njerëzit. Për më tepër, protesta për dorëheqjen e Fatmir Xhafajt më datë 26 maj përmban një moment stonimi që në ide nga ana e opozitës: A nuk mundet Xhafajt të japë dorëheqjen përpara datës 26 maj? Çfarë do të bëjë Partia Demokratike në atë rast? Do të anulohet protestën? Apo do të vazhdojë, duke vërtetuar atë që shqiptarët perceptojnë prej shumë kohësh: që synimi i këtyre protestave nuk është çështja që deklarohet, por vetëm largimi i Ramës.

Kur njerëzit të ftohen për të marrë pjesë në protestë, nuk do të kemi politikanë që merren me çështjet apo punët e njerëzve, por do të kemi njerëz që thirren për t'u marrë me punë politikanësh.

Në çdo rast, hitet ekzistojnë dhe ne nuk kemi zgjedhje përveçse të krijojmë një mendim dhe për to. Në rastin konkret, është bërë një punë e mirë në krijimin e refrenit të vëllait të dënuar, edhe pse ishte një melodi e hershme. Ashtu si "Non mi avete fatto niente", pavarësisht refrenit të kënduar më parë, fitoi Sanremo, edhe opozita arriti të tërheqë vëmendjen me



një ripërpunim. Këto kushte e vendosin z. Xhafaj në rolin e ministrit të Brendshëm që sa më shpejt jep dorëheqjen, aq më shpejt i heq opozitës melodinë e saj. Kështu, i jep mundësinë partisë së vet të thotë se ministrat tanë japin dorëheqjen edhe për gjëra që nuk i kanë bërë vetë.

Nëse Partia Socialiste mban z. Xhafaj në detyrë, duhet të përgatisë një hit më të fuqishëm se ai i opozitës. Ose duhet të krijojë një këngë të preferuar. Duke pasur parasysh që hiti i Xhafajt mund të vazhdojë, PS duhet të vazhdojë

të flasë për punët e njerëzve. Njerëzit dëgjojnë, ngrënë volumin dhe pëlqejnë kur politika arrin t'i njohë.

Fushata e Partisë Demokratike do të mund të çojë në zëvendësim ministri. Sa herë që merren me punët e këtij apo atij politikani, PD do të ketë rezultatet që do, brenda zyrave qeveritare. Por, për të depërtuar te njerëzit nuk mjaftojnë punët politikanësh, duhet t'i njohësh. Duhet të flasësh pa pushim për gjërat që i prekin nga afër.

Çfarë na prek më shumë, poli-

tika apo ekonomia? Ata që nuk rrinë pa gumë për politikën, preken më shumë nga ekonomia. Çfarë është më interesante, politika apo ekonomia? Punët e politikanëve janë më interesante. Por, ashtu si hitet, jemi të prirur t'i harrojmë. Atëherë, a duhet të flasim për diçka jo interesante si ekonomia? Jo, nuk është e nevojshme. Duhet të flasim për njerëzit. Ata dhe punët e tyre përmbyajnë ekonominë. Dhe janë interesante, edhe më shumë se politika.

PS duhet të kuptojë që edhe hitet, gjithsesi, kanë efektet e tyre. Ashtu, si pa vetëdije, ne i përtypim, i mësojmë, fillojmë t'i përsërisim. Duhet një strategji koncertesh, përveçse puna për të krijuar këngë të preferuara. Kjo strategji koncertesh, nuk mund të mos marrë parasysh edhe hitet që qarkullojnë, goftë si një nga pjesët e njohjes së njerëzve dhe mjedisit të tyre.

Po afrova vera. Do të fillojmë të dëgjojmë këngë të reja: hite. Hitet do të transmetohen shpesh. Njerëzit shpresojnë që ndonjë prej tyre të lindë jo si dëshirë për t'u bërë i famshëm. Por si dëshirë për të krijuar diçka të mirë.

**HOROSKOPI**

---

**DASHI**

Planifikimi i mirë është shpirti i punës, sidomos kur ju duhet të merrni me çështje praktike, dhe, për t'i përmblodhur, të mërztishme. Vizioni me ngjyra portokalli për të rënë në sy, dhe bëni mirë të shmangni të kuqen: nëse jeni të lodhur, bëheni agresiv.

---

**DEMI**

Hëna e ëmbël ju bën të ndiheni të sigurt, të mbështetur nga Dielli, Saturni dhe Jupiteri. Do të shfaqni prova të mëdha të miqësisë dhe idealit të përbashkëta me të njohurit. Do të tregoni gatishmëri drejt një kolegu, i cili po kalon nëpër një fazë të vështirë. E dini

---

**BINJAKET**

Me mendjen e turbullt, mes fantazive të parralizueshme dhe projekteve të cunguara. Nëse kërkonti gjëra, dhe është mirë që e bëni, mbështetja nuk do t'ju mungojë. Ajo që mungon sot është në veçanti dëshira të hyrë në lojë, duke shfrytëzuar kapacitetit tuaj.

---

**GAFORJA**

Hëna është në harmoni me shenjën tuaj dhe treshen Diell-Merkur-Neptun, me të cilët keni marrëdhënie të mira. Shfrytëzoni pikat tuaja të forta. Me miqtë keni mirëkuptim të përkryer, dhe kur dikush ju këshilloi dëgjoni me kënaqësi.

---

**LUANI**

Hëna lartë në qiell përballë shenjës së juaj është gjithmonë një burim keqkuptimesh dhe dhimbje koke, sidomos për ata që kanë pushtet ose për ata që duan të marrin pushtet. Një marrëdhënie e punë po fillon që t'ju shtrëngojë: keni nevojë për të nxjerrë në pah cilësitë tuaja.

---

**VIRGJERESHA**

Treshja e formuar nga Dielli, Saturni dhe Jupiteri, që janë kundra, zbutet me kalimin e Hënës, dhe kjo është arsyeja pse sot shkoni mirë me partnerin! Gjithashtu, të qetë me miqtë dhe fëmijët, gjeni pak kohë të lirë për të kaluar kohë në natyrë.

---

**PESHORJA**

Do jetë një ditë shumë e qetë dhe paqësore, e dobishme për ata që kanë punë të ngutshme për të bërë ose që duhet të bëjnë punime në shtëpi. Sot është i rëndësishëm edhe kontakti fizik: Me një lehtëmi shprehni të gjithë thellësinë e ndjenjës.

---

**AKREPI**

Hëna nuk ju sheh drejt, por e bën këtë pa të keq, por thjesht për të futur pak xhelozji që i zbut partnerit. Dielli-Saturni-Jupiteri në një treshe të mrekullueshme ju bën të keni frymëzim romantik dhe të flisni e të lexoni për dashurinë.

---

**SHIGJETARI**

Hëna është e zbehtë, ndërsa planetët përreth saj vënë theksin në shtëpi dhe burimet për ta zbuluar atë. Në qendër të mendimeve tuaja keni familjen. Do të gëzoheni ndërsa do të takoni disa kolegë tuaj, ndërsa keni dalë shtëpitë.

---

**BRICJAPI**

Të llastuar nga Plutoni dhe Urani, do të ndiheni të mbrojtur dhe do të keni nxitje për të dhënë më shumë. Do të jeni të frymëzuar me fjalë e dashurie që edhe një poet do t'i kishte zili. Hëna do të bëjë që të jeni të ndjeshëm dhe të qëndrueshëm e të lumtur në çift dhe me fëmijët.

---

**UJORI**

Pozicioni i Hënës do të bëjë që të kërkonti më shumë liri nga familja. Veprime të caktuara janë të tepërta për një shpirt të lirë si i juaji. Hendeku mes brezave, është domethënës dhe i dyfishit, sepse ju, fëmijët e së ardhmes, kështu jeni gatuar.

---

**PESHQIT**

Do të keni një ditë të këndshme të formuar nga treshja Diell, Saturni dhe Jupiteri në shenjën tuaj, dhe ky i fundit përballë Hënës krijuese dhe sensualit. Fjalë romantike, por jo vetëm: në çift do të komunikoni me shikime, përkëdhelje dhe gjeste dashurie.

Çështja e Fatmir Xhafajt nuk është as tema më e rëndësishme e as temë e rëndësishme për shqiptarët. Politika mund të imponojë hite. Por mund të krijojë këngë të preferuara vetëm nëse njeh njerëzit. Për më tepër, protesta për dorëheqjen e Fatmir Xhafajt më datë 26 maj përmban një moment stonimi që në ide nga ana e opozitës: A nuk mundet Xhafajt të japë dorëheqjen përpara datës 26 maj? Çfarë do të bëjë Partia Demokratike në atë rast?

## Katonica

## Pse Shkupi dhe Athina këmbëngulin për emër sllav

(vijon nga faqja 1)

Nga SHABAN MURATI


... në Sofje në kuadër të samitit BE-Balkan Perëndimor, ishte njoftimi se dy kryeministrit gjetën gjuhën e përbashkët për emrin e ri të shtetit të quajtur ndërkombëtarisht FYROM. Gazeta greke "Kathimerini" njoftonte në 18 maj se burime qeveritare në Shkup bëjnë të ditur se kryeministri Zoran Zaev i ka propozuar homologut grek emrin kompozitë "Republika e Maqedonisë së Ilindenit" gjatë bisedimeve me të në kryeqytetin bullgar. Emrin e mësipërm po e lakojnë si gjetje të re të gjitha mediat maqedonase dhe greke. Portali grek "Protothema" shkruante në 18 maj se qeveria e FYROM-it ka propozuar emrin "Republika e Maqedonisë së Ilindenit" dhe pala greke e ka pritur propozimin me një dritë pozitive. Të dy kryeministrit njoftuan se do të takojnë presidentët dhe do të mbledhin liderët e partive politike për të paraqitur propozimin e ri.

Duket se të dy kryeministrit duhet të kenë arritur një shkallë të lartë dakordimi dhe me sa duket janë në prag të deklarimit publik të zgjidhjes, përdërisa Cipras deklaroi se pret zgjidhjen deri muajin tjetër, përpara samitit të qershorit të BE. Kurse kryeministri maqedonas ishte më entuziast, sepse deklaroi se "diskutuam zgjidhjen kreative që pala maqedonase ka paraqitur në fazën e fundit të bisedimeve. Nga sot miqësia midis Maqedonisë dhe Greqisë është më e fuqishme".

Dalja e kryeministrit të Maqedonisë me këtë prononcim entuziast publik në konferencë shtypi tregon se jo vetëm mund të jetë arritur një marrëveshje midis dy kryeministrave, por edhe se të dy ata kanë gjetur një interes të përbashkët edhe dypalësh, edhe rajonal. Kënaqësia diplomatike në të dy kryeqytetet buron nga fakti se të dy kryeministrit janë bashkuar në idenë që FYROM të pagëzohet me një emër sllav dhe konkretisht "Republika e Maqedonisë së Ilindenit". Është një emër fetar sllav "Shën Ilija", që merr referencën nga një kryengritje e popullsisë sllave në vitin 1903 kundër perandorisë osmane dhe që zgjati disa ditë. Dita e Ilindenit përfaqëson një ngjarje historike, të cilën e cilësojnë të veten dhe e festojnë edhe Bullgaria, edhe Maqedonia, ndonëse në atë kohë nuk ekzistonte një entitet politik me emrin "Maqedoni", të cilin e shpiku Serbia. Kaq ngushtësisht është i lidhur emri Ilinden me historinë e Bullgarisë dhe të Maqedonisë, sa që zëvendëskryeministri dhe ministër i Mbrojtjes i Bullgarisë Krasimir Karakaçanov deklaroi në 18 maj lidhur me emrin e ri se "Ne nuk na pengon ky emër. Në 1 gusht të vitit të kaluar nënshkruam Traktatin Bullgari-Maqedoni, që na obligon të festojmë së bashku festat e përbashkëta. Ilinden është dita e kryengritjes më të madhe. Nëse dy vendet bien dakord për emrin "Maqedonia e Ilindenit" për ne nuk ka asnjë problem".

Pra, një datë, që është e përbashkët për historinë e dy shteteve sllave, Bullgarisë dhe Maqedonisë, del si propozim për emër i shtetit të deritashëm FYROM. Pra, kemi një emër ekskluzivisht, tipikisht dhe emocionalisht sllav dhe është e qartë se Shkupi me këtë qëllim ia ka para-

Partitë politike shqiptare dhe faktori shqiptar nuk duhet ta pranojnë as në qeveri dhe as në parlament një emër sllav të shtetit, që u sanksionon atyre statusin e qiraxhiut apo të qytetarit të kategorisë së dytë.



qitur si propozim Athinës. Nuk është e rastit që deri në takimin e Sofjes propozimi më i pranuar nga të dy palët ishte emri sllav "Gorna Makedonija". Pas tij, del në plan të parë prapë një emër sllav "Maqedonia e Ilindenit". Tendenca diplomatike e të dy qeverive është e qartë për sllavizimin publik të shtetit të Shkupit.

Athina e ka pranuar me dëshirë këtë

OKB përkatësia e këtij shteti si pronë vetëm sllave. Ky është edhe çelësi i intrigës diplomatike dypalëshe dhe shpjegimi i faktit përse Shkupi dhe Athina këmbëngulin për emrin sllav të shtetit të FYROM-it.

Për klasën politike maqedonase është e kuptueshme se emri "Republika e Maqedonisë së Ilindenit" e lidh jo vetëm përkatësinë, por edhe me një ngjarje të

Shqipëria duhet të shprehet me forcë kundër çdo emri sllav të Maqedonisë.

propozim të Shkupit, sepse jo vetëm justifikon veten për pengesën 25 vjeçare që i ka bërë emrit të shtetit fqinj të veriut, por edhe sepse Greqia fiton një pozicion dhe epërsi diplomatike me këtë hap të ri. Suksesi grek është se Athina pagëzon ligjërisht shtetin fqinj me një emër sllav dhe e bën atë shtet të jetë në borxh politik dhe diplomatik ndaj Greqisë. Greqia ndihmon të hipotekohet në listën e anëtarëve të

veçantë historike, e cila ka të bëjë vetëm me historinë dhe me popullsinë sllave. Maqedonia merr me këtë emër tapinë sllave dhe kjo mund të cilësohet fitore nacionaliste e kryeministrit Zaev në planin diplomatik dhe në planin e brendshëm politik dhe ndëretnik. Emri sllav sanksionon shtetin njënacional maqedonas dhe popullit shqiptar fshihet nga barazia e pjesëmarrjes dhe e vendimmarrjes së sh-

tetit. Ndaj në mediat greke dhe maqedonase është theksuar ditët e fundit se opozita nacionaliste maqedonase VMRO-DPMNE mund ta pranojë këtë propozim.

Greqia, duke pranuar emrin tipikisht sllav të këtij shteti, me një gur vret tre zogj. Së pari, fiton epërsi dhe pozicion paternalist mbi Maqedoninë, së cilës i dhuron një tapi shumë të vlefshme për Shkupin, por që Athinës nuk i kushton asgjë. Së dyti, merr me të mirë dhe ndërmerr një gjest miqësie ndaj Bullgarisë, së cilës i përfshin një ngjarje historike në emrin e shtetit të Shkupit. Dihet se Bullgaria kishte shprehur zyratarisht kundërshtimin e saj ndaj çdo emri gjeografik të Maqedonisë. Së treti, Athina godet dhe dobëson faktorin shqiptar në Maqedoni, të cilit i heq të drejtën e ligjshme të pronësisë së shtetit afër gjysmës së popullsisë nëpërmjet emrit historik sllav. Greqia fiton, gjithashtu, një pozitë më të fortë diplomatike në bisedimet e saj në zhvillim e sipër me Shqipërinë, sepse zgjidhja me Maqedoninë i jep Athinës një kartë të re presioni mbi Tiranën.

Emri i ri sllav "Republika e Maqedonisë së Ilindenit" është në kundërshtim me karakterin demokratik të një shteti multinacional, multifetar dhe multikulturor. Ai neglizhon praninë, të drejtat dhe interesat e popullit shqiptar në Maqedoni. Nuk ka ende informacion se cili është qëndrimi i partive politike shqiptare, në qeveri ose jo, lidhur me emrin e ri sllav. Është e papranueshme që faktori shqiptar të përjashtohet nga procesi i vendimmarrjes shtetërore lidhur me çështjen e emrit. Mendimi im është se partitë politike shqiptare dhe faktori shqiptar nuk duhet ta pranojnë as në qeveri dhe as në parlament një emër sllav të shtetit, që u sanksionon atyre statusin e qiraxhiut apo të qytetarit të kategorisë së dytë. Faktori shqiptar nuk duhet të hutohet nga disa opinione naive, sipas të cilave Ilinden i u takon edhe shqiptarëve, meqë në kryengritjen e asaj kohe ka pasur edhe disa shqiptarë pjesëmarrës. Ilinden është historia dhe festë bullgare dhe maqedonase. Nuk ka qenë dhe nuk mund të bëhet artificialisht histori shqiptare.

Nuk ka asnjë informacion se cili është qëndrimi zyrtar i Tiranës, e cila nuk mund të vazhdojë me indiferencën ndaj çështjes së emrit sllav të shtetit, i cili cenon direkt interesat jetike të popullit shqiptar në Maqedoni. Tirana nuk mund të përdorë si alibi të heshtjes së saj tezën se rëndësi ka zgjidhja e emrit, sepse hyn Maqedonia në BE dhe në NATO, pavarësisht se po hyn si shtet i maqedonaseve. Në datën 26 mars 2018 në analizën botuar në këtë gazetë, me titull "Emri sllav i Maqedonisë-tapi për pronësinë maqedonase", kam shkruar: "Shqipëria duhet të shprehet me forcë kundër çdo emri sllav të Maqedonisë. Është e pakuqshme përse diplomacia shqiptare gjatë gjithë këtyre dekadave nuk është pronuar kurrë se për çfarë emri është dakord ajo".

Secili shtet duhet të shohë interesin e tij shtetëror dhe kombëtar dhe ky interes shtetëror e kombëtar kërkon që shteti dhe diplomacia shqiptare duhet të jenë në veprim të vazhdueshëm për të kundërshtuar tendencën e sllavizimit të shtetit fqinj dhe të nëpërkëmbjes së të drejtave të popullit shqiptar në Maqedoni.

PËRSHËNDET GJIROKASTRITËT



Lamtumira e Bregut:  
Do jem juaji, përgjithmonë!

Siç tashmë dihet, Dejvi Bregu do të largohet nga Luftëtari, pasi dje ka luajtur ndeshjen e fundit me fanellën blu. Në fakt, kontrata e Bregut e lidh futbollistin me Skënderbeun e Korçës, por e ardhmja pritet që të jetë larg Korçës. Në përfundim të ndeshjes ndaj

Skënderbeut, Bregu u pa me lot në sy dhe pas ndeshjes shpjegoi se ato lot dilnin nga shpirti dhe ishin lot mirënjohjeje. Nëpërmjet një postimi në rrjetin social "Instagram", Dejvi Bregu ka dhënë lamtumirën nga klubi gjirokastrotrite, duke i falënderuar të gjithë për periudhën gjatë së

cilës ai ka luajtur me Luftëtarin. "Jeta është e ndërtuar nga cikle dhe erdhi momenti që cikli im 2-vjeçar e gjysmë të mbaroj në mënyrën më të bukur me. Falënderoj çdo shok të ekipit për ndihmën dhe për sfidat që kemi kaluar, falënderoj çdo trajner që më ka mësuar shumë në këtë

periudhë, falënderoj çdo tifoz që më ka përkrahur dhe që është mirënjohës për atë çfarë kam kontribuar për këtë klub. Ndeshja ime e fundit në Gjirokastër në atë që tashmë quhet shtëpia ime e dytë... faleminderit për duartrokitjet e sotme! Lotët e mi sot janë lot mirënjohjeje që dolën nga shpirti për gjithëka çfarë kam kaluar... I juaji gjithmonë Dejvi Bregu...". shkruhej në postimin e mes-fushorit.

Sulmuesi që aktivizohet Laçi, kanjë çështjet hapur me ish-trajnerin e Vllaznisë

Jeton Selimi

Shtubina, vrer ndaj Gjokës:  
Erdhi si luan, iku si lepur!

Sulmuesi shpreson të luajë në Kupat e Europës

Tre shkodoranët e Laçit, Ndrichim Shtubina, Ansi Nika dhe Abdurrahman Fangaj i dhanë një dorë Vllaznisë, duke mundur rivalen e tyre, Kamzën. Vllaznia ka shanse mbijetese në Superiore, por duhet të fitojë në Korçë dhe Partizani duhet të mundë Kamzën. Ndrichim Shtubina ka dhënë një intervistë për "Shkodra.News", kumes të tjerash akuzon direkt ish-trajnerin Ernest Gjoka për gjendjen që po kalon Vllaznia. Ish-kapiteni kuqeblu shprehet se trajneri kryeqytetaserdhi në Shkodër si "luan", por ikusi "lepur": "Ndaj Kamzës ishte një fitore e rëndësishme për ne dhe besoj se do të shkojmë në Kupat e Europës. Teuta e ka siguruar mbijetesën, por në Laç jemi shumë të fortë dhe besoj se do të bëjmë një mbyllje të bukur kampionatit. Ajo që mund të them është se e kam vazhjtuar shumë këtë ndeshje, sepse na duhej fitorja për shumë arsye. Në radhë të parë për veten tonë, sepse pretendojmë Europën, por dhe një motiv më shumë ishte për Vllazninë. Kjo fitore e jona e mban në lojë edhe Vllazninë. Kemi diskutuar të tre ne shkodoranët me njëri-tjetrin dhe u kam thënë se Shkodra i ka sytë edhe nga ne, si djem shkodoranë që jemi. Duhej të bënim



detyrën. Kush e ka fajin? Këtë gjendje e ka krijuar trajneri Gjoka. Ishai parinë janar që kam folur për të. Në merkaton e janarit ai është pyetur për mua, por e ka anashkalluar emrin tim për rikthimin të Vllaznia. Nuk e harroj

veprimin e tij dhe po i them tani Gjokës se po të isha edhe unë trajneri në Vllaznisë, do ta kisha shpëtuar me kohë. Jam shumë më i madh se Gjoka në çdo aspekt. Ai erdhi si një luan dhe iku si një lepur. Kam besim se Partizani do të

luajë drejt dhe Vllaznia do të shpëtojë edhe këtë sezon. Shpresoj të jetë viti i fundit që luan për mbijetesë. E ardhmja? Në futboll nuk i dihet asnjëherë, në Laç ndihem si mbret, -ka thënë Shtubina mes të tjerash.



Muriño sheh nga Atletiko, pëlqen Sime Vrsaljkon

Pas humbjes në finalen e Kupës së Anglisë ndaj Çelsit, Muriño ka filluar të mendojë për skuadrën e sezonit tjetër, duke hedhur sytë nga futbollistët, të cilët mund të afrohen në "Old Trafford" gjatë merkatos së verës. Si fillim, tekniku portugez mund të bëjë ndryshime në repartin mbrojtës, ku do të ketë disa ndryshime. Emri i parë në listën e afri-meve, është ai i mbrojtësit të Atletikos, Sime Vrsaljko për të cilin "dajtë e kuq" mund të paguajnë 40 milionë euro. Vrsaljko u bashkua me Atletikon në vitin 2016 nga ekipi i Sasulos për vetëm 18 milionë euro dhe pas performancave të mira me fanellën madriline, vlera e mbrojtësit kroat është rritur ndjeshëm.

SUPERLIGA	
JAVA E 35-të	
TË SHTUNËN	
Vllaznia - Kukësi	2-1
Kamza - Laçi	1-2
Teuta - Lushnja	6-2
Luftëtari - Skënderbeu	3-1
Flamurtari - Partizani	1-2
RENDITJA	
SKUADRA	PIKE
Skënderbeu	72
Kukësi	62
Luftëtari	56
Laçi	53
Partizani	53
Teuta	46
Flamurtari	45
Kamza	43
Vllaznia	41
Lushnja	11
JAVA E FUNDIT	
TË MERKURËN	
Skënderbeu - Vllaznia	17:00
Partizani - Kamza	17:00
Kukësi - Flamurtari	17:00
Laçi - Teuta	17:00
Lushnja - Luftëtari	17:00

MIQËSORJA SHQIPËRI-KOSOVË

Rashica: Dua një stadium kuqezi dhe me ngjyrë të kaltër

Pas një aventure në kampionatin holandez me Vitesë, Milot Rashica u transferua në Gjermani ku firmosi me skuadrën e Verder Bremenit. Gjatë ditës së sotme, Rashica ka vendosur që të ndjekë nga afër finalen e kampionatit mes Prishtinës dhe Dritës, ku ka folur edhe për ndeshjen Shqipëri-Kosovë që do të luhet pas disa ditësh. "Kur kam firmosur te Vitesë kam qëndruar edhe 3 muaj në Kosovë dhe kam luajtur kundër Besës së Pejës ku kam fituar 3-2. Kampionati gjerman ka përfunduar dhe jemi disa ditë pushim para se të luajmë me Shqipërinë dhe më pas kemi sërish pushime para se të rikthehem te Verderi. Ndeshja ndaj Shqipërisë? Besoj se do të jetë ndeshje me një atmosferë të mirë pasi shumë shqiptarë jetojnë atje dhe besoj se stadiumi do të jetë kuqezi dhe me ngjyrat tona të kaltra. Gjermania? Diferenca me Holandën është shumë e madhe dhe në muajt e fundit kam pasur shumë minutash dhe kam filluar të ambientohem. Sezioni tjetër besoj se do të jetë më i mirë. Gjithkush ka dëshirë të luajë në një ndeshje si kjo, por unë jam në Bundesligë dhe shpresoj që sot të jetë një ndeshje e mirë pa dëmtime dhe të fitojë skuadra që e meriton. Për mua është kënaqësi që jam sot këtu pasi është

LIVERPULI

Klop do Fekir, gati 68 milionë euro për Lionin


Përf forcime nga Franca për Liverpul. Trajneri i të kuqeve është i përqendruar te ndeshja finale e Championsit me Realin e Madridit, që luhet më 26 maj, por edhe merkatoja ka vëmendjen e duhur prej tij. Jurgen Klop është në kërkim të një lojtari trekuarist, siç quhet në gjuhën teknike, lojtar që luan pas sulmueseve. Dhe duket se e ka gjetur atë. Është Nabil Fekir i Lionit. "Sunday Mirror" shkruan për këtë transferim të mundshëm, që do t'i kushtojë Liverpulit rreth 68 milionë euro, apo 60 milionë paund. Një shumë e konsiderueshme, por Fekir është një lojtar me kualitet të lartë dhe jo më kot kërkohet edhe nga klube të tjera europiane, në Angli dhe në Spanjë.




LEON BEILI

Çmendet Bajerni, 52 milionë euro për një 20-vjeçar

Me mbylljen e kampionateve, skuadrat presin të hapet zyrtarisht merkaton e verës, për të përfunduar skuadrat për sezonin e ardhshëm. Drejtuesit e Bajern Mynihut kanë filluar të mendojnë që tani për merkaton dhe futbollistët i parë që mund të afrohen për trajneri Kovaç, është Leon Beili. Bavarezët janë të gatshëm të ofrojnë plot 52 milionë paund për të siguruar shërbimet e sulmuesit 20-vjeçar, i cili aktivizohet me Bajer Leverkusenin, me të cilët ka shënuar 12 gola në 31 ndeshje. Në fakt, Beili nuk është vetëm një dëshirë e Bajernit, pasi edhe Real Madridi është interesuar më parë për të, por drejtuesit e Bajer Leverkusenin janë shprehur se nuk do ta lejojnë talentin të largohet për më pak se 80 milionë paund.



**Fjalëkryqi (1)**



- 34. Janë gjuhë...veshi.
- 35. Eshhtë numri i dytë tek.
- 36. Triolet shkrintare.
- 37. Kufizojnë takimet.
- 38. Tyler aktore.
- 39. Mbledh baskët separatistë.
- 40. Fillojnë kalimin.
- 41. Inicialet e Delon.
- 43. Lumi i Bernës.
- 44. Eshhtë numri të parit.
- 45. Një thirrje me emra.

- VERTIKAL**
- 1. Flori pa kufij.
  - 2. Një Baba përrallor.
  - 3. Lemper këngëtare gjermane.
  - 4. Rastisin në krye.
  - 5. Ai ekzekutiv u bë bashki.
  - 6. Qendra e drogës.
  - 7. Një tabu islamike
  - 8. Mbyllin një dyqan.
  - 10. Janë si zotime
  - 11. Kryeqyteti i Lichtenstein.
  - 12. Jaë shtyllat për vela
  - 14. Ata të Ferrari-t qëndrojnë në box.
  - 16. Duhën fituar me djersë.
  - 17. Piktura pa kura.
  - 18. Janë dokumente partie.
  - 19. Në fund të vitit.
  - 21. Farkëtoi armët e Akilit.
  - 22. Një është për kërcim.
  - 24. Athinaja e romakëve.
  - 25. Janë kapriçit.
  - 27. Një tis mjegulle.
  - 28. Kërcimi i Fred Astaire.
  - 31. Edëardë regjisor.
  - 33. Parker regjisor.
  - 38. Luan në kufij
  - 39. Inicialet e Rohmer.
  - 42. Fillojnë detyrën.


- HORIZONTAL**
- 1. Pausini këngëtare
  - 5. Më e mira është rekord.
  - 9. Inicialet e Pacino-s.
  - 11. Alessandro i pilës.
  - 12. I ka zyrat në kufij
  - 13. Haan ish-trainer.
  - 14. Gjysmë mizoze.
  - 15. Fillojnë sefte.
  - 16. Ishte shkollë e Aristotelit.
  - 20. Shuhen në qëndër.
  - 22. Bëhen me ambalazh.
  - 23. Janë idhnakë.
  - 25. Fillojnë titujt.
  - 26. Do të bëhen pemë.
  - 27. Ashtu si jeton heremit.
  - 29. Eshhtë dhomë e lartë.
  - 30. Janë spanjollët dhe portugezët.
  - 32. Ishte filozofi që preu damarët.

**Fjalëkryqi (2)**


- HORIZONTAL**
- 1. Matia... që këndojnë Vacanze romane.
  - 5. Janë vendet e lira
  - 11. Parajsa e humbur.
  - 13. Comaneci e famshme e gjimnastikës.
  - 15. Ekstremit në sirtar.
  - 16. Eshhtë nofka.
  - 17. Një treshe në skenë.
  - 19. Një provë inteligjence.
  - 21. Gjysmë tatimi.
  - 23. Gjysmë eolike.
  - 24. Ekstremit në studim.
  - 25. Bëjnë stili të lirë
  - 28. Fillojnë kastile
  - 29. Kalimi në kufij.
  - 30. Një tragjedi... e Dreiser.
  - 33. Grier aktore.
  - 34. Dashi kur mungon ai
  - 36. Eshhtë zanore në filma
  - 38. Kufizohet në kufij
  - 39. Ente Civile Europiane.
  - 40. Janë galeri në hekurudhë.
  - 41. Ramazzotti këngëtar

- 42. Mbyllin një tender.
- 43. Agjenci Formacioni Tiranë.
- 44. Eshhtë pjesë e borxhit që paguhet.
- 46. Gjysmë tandem
- 48. Jessica Parker aktore.
- 49. Inicialet e Presley.
- 50. Shteti i francezëve.
- 51. Janë brinjët në skuadër.
- 52. Qendër fitimi


- VERTIKAL**
- 1. George që qe as i futbolli.
  - 2. Fillon me rruga...
  - 3. Fundi i një faze
  - 4. Janë në skaje
  - 6. Eshhtë vendi aderues
  - 7. Eshhtë emirat.
  - 8. Inicialet e Daudet.
  - 9. Ndërmarrje Industriale Tiranë.
  - 10. Iglitë Lazio.
  - 12. Janë zjarrvënës.
  - 14. Frolich e Marlene Dietrich.
  - 17. Kufizojnë rastet.
  - 18. Shkroi Rinoceronti.
  - 20. Ekstremit në slam.
  - 22. Janë trille.
  - 25. Qytet italian.
  - 26. Jepen për hartim.
  - 27. Fillojë takimet.
  - 29. Kufizojnë kënde.
  - 31. Janë vendet e para.
  - 32. Një greminë.
  - 35. Eshhtë llogarin që qërohet.
  - 36. Ndiqen me ilaçe.
  - 37. Massari aktore italiane.
  - 38. Janë kapot.
  - 40. Numri i oktetit.
  - 41. Kush ka... fërgëllon.
  - 44. Një i fundit mbi të gjithë.
  - 45. Një pjesë e satelitëve.
  - 47. Në mes të një kanali.
  - 48. Derisa janë në fund.
  - 49. Inicialet e Taylor aktore.



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**SUDOKU**

		3		9				8			
2		8				6		7	1		
5	9							6			
		7	5					1			
		9		2				3			
1		4		3							
		5									
		2	6	3						5	
7				8							

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

6	8	9	5	3	4	2	1	7
5	1	2	6	7	9	3	8	4
3	7	4	1	8	2	9	5	6
8	3	6	7	5	1	4	9	2
9	4	7	8	2	3	5	6	1
2	5	1	9	4	6	7	3	8
7	9	3	2	6	8	1	4	5
4	2	8	3	1	5	6	7	9
1	6	5	4	9	7	8	2	3

*Argëtim filozofik*

- Eksperienca është emri që çdokush i vë gabimeve të tij. (Oscar Wilde)
- S'ka gjë më të tmerrshme se sa të shikosh injorancën në veprim. Johann Wolfgang Goethe Shkrimtar (1749-1832)
- Tre janë metodat nga marrim dije: e para, nga reflektimi që është më fisnikja; e dyta, nga imitimi që është më e thjeshta dhe e treta nga eksperienca, që është më e hidhura. (Konfuci)

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**  
Përgjigja e numrit të djeshëm

8	6		8	3	6	4		13	1	16	5	13	
2	5	2	5	7	4			8		6	6	4	
4	4		19	4	11	1	2	3	20	5	2		
12		11	5	6	5	13	5	9	4	7	4	2	
5	12	4	2	5	6	3	2		9	5		5	
		6	4	2	4		1		4	1	5		
5	2	4		3	7		6	3	4	6	1		
13	3	12	3	2	3		4	2	5	13	5		
2	13	16			2	5	A	5	12	2	5		
1	2	4	2	4		19	G	6		2		13	
4	18		7	4	8	4	I	1	12	5	6	4	2
3	13	8	2	6	3	7	M	4	8	2	3	2	

M	E	R	L	U	C	K	A	S	F		
A	M	A	R	A	T	O	N	I	S	T	I
C	A	K	A	N	A	L	E	T	A	J	
E	K	I	N	E	T	I	K	E	F	E	
K	O	M	I	T	E		P	R	E	T	
E	U	I	A	T	A	L	E	A	T		
N	A	H	I	F	A	R	S	A	T		
D	J	A	L	L	P	A	S	T	A		
R	T	K	E	T	T	T	T	A	C		
R	U	D	H	A	I	R	U	F	I		
A	N	J	A	C	K	A	R	I	E	L	
T	I	P	A	R	E	T	T	R	U	R	I

*Thënie të mënçura*

- - Sa më pak të keni , aq më pak duhet të shqetësoheni .
- - Aroma e luleve nuk shkon kundër erës , as i Jaseminut , aroma e të mirëve shkon kundër erës : një njeri i drejtë njihet anë e mbanë .
- - Eshhtë e nevojshme që njeriu t'i afrohet gjithmonë e
- - më shumë të mirës e të
- - përpigjet të ruajë mendjen e tij nga ligësitë
- - Mendja e atij që bën vepra të mira me
- - gjysmë zemre , në fakt , merr kënaqësi në të keqe
- - Dhuna është frut i dëshirës .

**PËRGJIGJET E FJALËKRYEQVE TË NUMRIT TË KALUAR**

G	A	R	R	O	S	A	D	A	P	T	I	M	
U	R	A	I	P	R	I	T	I	A	A			
U	K	R	O	N	I	K	A	E	G	T			
S	F	I	V	A	L	E	N	T	I	N	O		
L	M	I	N	O	T	A	U	R	I	K			
R	E	B	E	D	I	T	A	R	I	T	A	N	
E	T	E	R	I	I	R	O	A	L	A	N		
N	O	T	I	A	E	S	E	N	E	N	T	I	
D	R	A	M	A	T	T	S	H	I	R	I	T	
O	E	A	R	E	A	L	A	N	T	J	E	A	
R	T	A	N	E	V	R	I	K	E	L	G		
E	F	E	R	A	Z	I	M	A	T	T	I	A	
P	A	N	I	K	U	T	A	R	T	A	R	I	
O	R	A	R	N	F	P	R	A	T	I	R		
K	A	K	T	E	S	E	M	I	L	E			
G	A	S	A	R	E	A	L	A	N	T	J	E	A
J	A	T	E	L	E	K	O	M	E	D	I	A	
A	M	A	N	E	T	E	K	R	E				
H	E	R	E	M	I	T	R	O	B	E	R	T	
T	S	R	I	M	A	R	A	T	I				
A	S	G	E	M	E	T	S	A	L	E			
R	I	T	J	A	N	T	S	E	M	I	L	E	
E	R	I	E	T	H	K	A	N	A	N			
T	I	R	A	N	A	A	L	E	T	E			

**FJALËKRYQI (1)**

**FJALËKRYQI (2)**

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

# GAZETA SHQIPTARE

# GSH.AL



- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

# GSH

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)



## Tashmë edhe lundroni!

